



Gender Alliance for Development Center  
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Kingdom of the Netherlands



# Vlerësimi i Mjedisit për Sipërmarrjen e Grave: Një Vëzhgim mbi Sipërmarrjen e Grave në Shqipëri

Tiranë, 2023

Titulli: Vlerësimi i Mjedisit për Sipërmarrjen e Grave: Një Vëzhgim mbi  
Sipërmarrjen e Grave në Shqipëri

© Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Shqipëri (2023)

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Autorë: Prof. Asoc. Dr. Esmeralda Shehaj, Eugena Topi,  
Av. Ardjana Shehi Kalo, Mirela Arqimandriti

Ky studim është përgatitur në kuadër të projektit: “Ajo Drejton – Një projekt kushtuar grave sipërmarrëse shqiptare”, mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shqipëri.

Gjetjet, Opinionet ose Rekomandimet e pranishme në këtë dokument përfaqësojnë pikëpamjet e ekspertëve dhe organizatës “ Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim “ dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pozicionin e partnerëve dhe mbështetësve të projektit në fjalë.

Ky studim mund të gjendet në: [www.gadc.org.al](http://www.gadc.org.al)

**Dhe në adresën:**

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim  
Rr. “Abdyl Frasheri”, Pallati 10/1, shk. 1, ap. 3  
Tiranë, Shqipëri

# Përmbajtja

<b>Falënderime</b> .....	<b>5</b>
<b>Shkurtime</b> .....	<b>8</b>
<b>Përmbledhje Ekzekutive</b> .....	<b>11</b>
<b>Hyrje</b> .....	<b>15</b>
<b>Rishikimi i Literaturës</b> .....	<b>17</b>
<b>Një Perspektivë Akadematike mbi Sipërmarrjen e Grave</b> .....	<b>17</b>
Sipërmarrja e Grave: Çfarë të presim? .....	17
Shqipëria në Raportet Ndërkombëtare.....	23
<b>Një Perspektivë mbi Sipërmarrjen e Grave e Bazuar në të Dhëna</b> ....	<b>25</b>
Karakteristikat e sipërmarrjeve të zotëruara/drejtuar nga gratë në	
Shqipëri .....	28
Faktorët nxitës dhe pengesat me të cilat përballen sipërmarrjet e	
zotëruara/menaxhuara nga gratë.....	32
<b>Kuadri i Kushteve për Barazinë Gjinore dhe Sipërmarrjen e Grave</b> .....	<b>41</b>
<b>Rishikim i Ligjeve mbi të Drejtat dhe Fuqizimin Ekonomik të Grave në</b>	
<b>Shqipëri</b> .....	<b>41</b>
Kushtetuta e Shqipërisë.....	41
Kuadri Ndërkombëtar .....	41
Legjislacioni Shqiptar .....	44
<b>Strategjitë për Sipërmarrjen dhe Fuqizimin Ekonomik të Grave</b> .....	<b>49</b>
Dokumentet strategjike të rëndësishme për fuqizimin ekonomik të	
grave.....	49
Programi i Reformës Ekonomike 2022-2024 .....	51
<b>Rishikim i Shkurtër i Kuadrit Institucional për Sipërmarrjen e Grave</b> <b>52</b>	
<b>Gjetjet e anketës për gratë sipërmarrëse në Shqipëri</b> .....	<b>54</b>
<b>Profili i Grave Sipërmarrëse që morën pjesë në anketë</b> .....	<b>54</b>
Shpërndarja Rajonale.....	54
Demografia .....	55
Arsimimi .....	56
<b>Të qenit sipërmarrëse</b> .....	<b>57</b>
Motivimi për të nisur një biznes .....	57
Kënaqësia nga nisma e ndërmarrë.....	58
Stereotipet .....	58
Koha kushtuar biznesit .....	59
Ekuilibri jetë-punë.....	60
Pavarësia në vendimarrje .....	61

Profili i ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë që u përfshinë në anketë ..61	
Themelimi i ndërmarrjeve .....	61
Forma juridike .....	64
Industritë .....	64
Burimi i Pronësisë .....	65
Kapitali për ngritjen e biznesit.....	65
Statusi i Regjistrimit .....	67
Përmasat e biznesit .....	67
Politikat e Burimeve Njerëzore .....	69
Mundësi të Barabarta Punësimi, Diversitet dhe Gjithëpërfshirja .....	70
Zgjerimi i biznesit.....	70
Menaxhimi Financiar në Ndërmarrje .....	72
Aksesi në financa .....	72
Ndërtimi i kapaciteteve .....	75
Aksesi në tregje.....	77
Tregu Lokal .....	77
Tregjet e huaja.....	77
Panaiet Kombëtare dhe Ndërkombëtare .....	78
Aksesi në Shërbimet IT dhe përdorimi i tyre .....	78
Perceptimet e përfitimeve .....	78
Përdorimi i platformave dixhitale .....	79
Përdorimi i Shërbimeve të tjera Dixhitale për Bizneset .....	79
Tregtia dhe pagesa online.....	80
Përdorimi i Portaleve Qeveritare .....	80
Rrjetet.....	81
Ndikimi i COVID-19 .....	82
Financat e biznesit përkundrejt financave personale .....	83
Njohuritë financiare dhe sipërmarrëse.....	84
<b><i>Raste studimi aktuale nga rajoni i Ballkanit Perëndimor: Aksesi në Financa. 86</i></b>	
<b><i>Përfundimet kryesore .....</i></b>	<b>88</b>
<b><i>Anekset .....</i></b>	<b>91</b>
<b><i>Aneksi 1. Informacion shtesë për të anketuarat.....</i></b>	<b>91</b>
<b><i>Referenca dhe Bibliografi.....</i></b>	<b>95</b>

# Falënderime

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh) dëshiron të shprehë mirënjohje për personat që morën pjesë në këtë studim dhe kontribuan në hartimin e kësaj analize të thelluar mbi Vlerësimin e Mjedisit për Sipërmarrjen e Grave: Një Vëzhgim mbi Sipërmarrjen e Grave në Shqipëri. Gratë në biznes, organizatat përfaqësuese të biznesit dhe institucionet ofruan opinionet dhe kohën e tyre për përgatitjen e këtij raporti. QAGjZh falënderon skuadrën hulumtuese, e cila punoi pa u lodhur për zhvillimin e intervistave me institucionet, kodimin e tyre, analizën statistikore të pyetësorëve të plotësuar online dhe hartimin e kapitujve përkatës të këtij raporti.

Ky botim u bë i mundur falë përpjekjeve të skuadrës hulumtuese shqiptare, kryesuar nga Mirela Arqimandriti (MBA), Drejtore Ekzekutive e QAGjZh-së (studiuuese dhe drejtuese e grupit), Prof. Asoc.Dr. Esmeralda Shehaj për rishikimin e literaturës, Eugena Topi për analizën e detajuar statistikore gjetjet dhe rekomandimet dhe Av. Ardjana Shehi Kalo, për analizën e kuadrit ligjor dhe identifikimin e legjislacionit në fuqi mbështetës për fuqizimin ekonomik të grave nëpërmjet iniciativës private dhe qasjes në biznes.

Falënderojmë stafin mbështetës të QAGjZh-së, Esmeralda Hoxha intervistuese kryesore dhe koduese, Jelena Kojashi, Besjana Hysa si dhe pjesëtarët e tjerë mbështetës.

# Lista e Figurave

Figura 1. Kuadri Konceptual për treguesit e sipërmarrjes .....	27
Figura 2. Sipërmarrjet aktive sipas gjinisë së pronarit/administratorit, 2016-2021 .....	28
Figura 3. Analizë e sipërmarrjeve aktive me pronare/administratore gra ..... sipas madhësisë së firmës .....	29
Figura 4. Sipërmarrjet aktive sipas gjinisë së pronarit/administratorit dhe veprimtarisë ekonomike (%), 2021 .....	31
Figura 5. Format ligjore të bizneseve të drejtuara nga gratë (%), 2016-2021 .....	31
Figura 6. Përqindja e grave depozituese, kredimarrëse, dhe e llogarive të tyre në bankat tregtare .....	36
Figura 7. Gratë përfituese të Skemave të Granteve të AIDA sipas sektorit 2014-2019 .....	37
Figura 8. Vendbanimi i Grave Sipërmarrëse dhe vendi i ushtrimit të biznesit sipas Bashkisë .....	55
Figura 9. Mosha e të anketuarave .....	55
Figura 10 . Niveli arsimor i të anketuarave (%).....	57
Figura 11. Motivimi për të nisur një biznes .....	57
Figura 12. Numri i orëve të shpenzuara në javë në biznes .....	59
Figura 13. Numri mesatar i orëve në javë shpenzuar për administrimin e biznesit ose për të punuar në biznes.....	60
Figura 14. Ekuilibri jetë-punë .....	60
Figura 15. Përgjegjësia e menaxhimit të operacioneve të biznesit .....	61
Figura 16. Regjistrimi i bizneseve të drejtuara nga gratë për dhjetëvjeçarë	61
Figura 17. Viti i themelimit të ndërmarrjeve të anketuara.....	62
Figura 18 . Periudha e regjistrimit të biznesit sipas moshës së të anketuarave.....	62
Figura 19. Periudha e themelimit të ndërmarrjeve sipas aktivitetit ekonomik .	63
Figura 20. Pozicioni i grave sipërmarrëse në kompani .....	64
Figura 21. Industritë ku operojnë ndërmarrjet e drejtuara nga gratë .....	64
Figura 22. Si e kanë fituar të anketuarat pronësinë e biznesit? .....	65
Figura 23. Burimet e financimit për fillimin e biznesit.....	66
Figura 24. Burimi i financimit dhe origjina e pronësisë.....	66
Figura 25. Statusi i regjistrimit të ndërmarrjeve.....	67
Figura 26. Përmasat e bizneseve të drejtuara nga gratë e anketuara .....	67
Figura 27. Të punësuarit me lidhje familjare me pronarin .....	68
Figura 28. Numri i kompanive bazuar në bazë të përbërjes gjinore të të punësuarve të tyre .....	68

Figura 29. Përdorimi dhe mospërdorimi i praktikave të burimeve njerëzore në ndërmarrjet e drejtuara nga gratë.....	69
Figura 30. Faktorët që ndikojnë në zgjerimin e biznesit.....	71
Figura 31. Qasja ndaj analizës periodike financiare.....	72
Figura 32. Të dhëna për aplikimet për kredi nga gratë sipërmarrëse.....	73
Figura 33. Shkalla e kredive të marra nga të anketuarit.....	73
Figura 34. Planet për të ardhshmen dhe mungesa e financimit.....	74
Figura 35. Njohuritë mbi edukimin formal ose informal për ngritjen e një biznesi.....	75
Figura 36. Nevojat për trajnim.....	76
Figura 37. Perceptimi i aksesit në tregje bazuar në aktivitetin ekonomik...	77
Figura 38. Perceptimi i rëndësisë së shërbimeve dixhitale dhe IT.....	78
Figura 39. Përdorimi i mediave sociale dhe platformave për praktikat mësimore.....	79
Figura 40. Pagesat online në ndërmarrjet e drejtuara nga gratë.....	80
Figura 41. Perceptimi për shërbimet dixhitale të ofruara nga qeveria (e-Albania, e-filing, Taksat e mia).....	80
Figura 42. Përvoja e të anketuarave me procesin e fiskalizimit.....	81
Figura 43. Përqindja e përfituesve të masave të marra nga qeveria shqiptare.....	82
Figura 44. Ndarja e financave të biznesit nga ato personale.....	83
Figura 45. Njohuritë mbi treguesit financiarë të biznesit të tyre.....	84
Figura 46. Pjesëmarrja në trajnimet për financat personale dhe të biznesit.....	84
Figura 47. Planet e Biznesit dhe Krijimi i Biznesit.....	85
Figura 48. Moshë e të anketuarve.....	91
Figura 49. Përkatësia etnike e të anketuarave në bazë të vetëdeklarimit....	92
Figura 50. Moshë e grave sipërmarrëse kur nisin një biznes.....	93
Figura 51. Numri total i punonjësve me pagesë që punësojnë bizneset në mënyrë të vazhdueshme.....	94

### Lista e tabelave

Tabela 1. Sipërmarrjet aktive sipas gjinisë së pronarit/administratorit dhe veprimtarisë ekonomike, në (%).....	30
---	----

### Lista e kutive

Kutia 1. Lista e Direktivave kyçe të BE-së në mbështetje të barazisë gjinore.....	43
Kutia 2. Rast Studimi #1: Fuqizimi i Grave dhe Promovimi i Sipërmarrjes në Shqipëri.....	86
Kutia 3. Rast Studimi #2: Programi për Inkurajimin e Zhvillimit të Sipërmarrjes në Serbi.....	86
Kutia 4. Rast Studimi #3: Mbështetja përmes Njësive të Qeverisjes Vendore në Mal të Zi.....	87
Kutia 5. Programi i BERZH-it Gratë në Biznes në Ballkanin Perëndimor...	87
Kutia 6. Sugjerimet për veprim.....	88

# Shkurtime

AFI	Aleanca për Përfshirjen Financiare
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
BE	Bashkimi Evropian
BEEPS	Anketa e Mjedisit të Biznesit dhe Performancës së Sipërmarrjes
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BNj	Burimet Njerëzore
BPO	shërbimet e nën-kontraktuara
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
CEO	Drejtuues Ekzekutiv
COVID-19	Sëmundja e Koronavirusit
EDGE	Projekti “Prova dhe të dhëna për Barazinë Gjinore”
EEO	Mundësitë e Barabarta të Punësimit
GADC	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
HDI	Indeksi i Zhvillimit Njerëzor
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
INSTAT	Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë
IT	Teknologjia e Informacionit
KE	Këshilli i Evropës
MBA	Master në Administrim Biznesi
MZhb	Mbështetja për Zhvillimin e Biznesit
NMVM	Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OJQ	Organizatë Jo-qeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OZhq	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
SZG	Sipërmarrjet e Zotëruara nga Gratë
SZhbI	Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve
ShA	Shoqëri Aksionare
ShPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar



TFEU	Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UN Women	Enti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
UNCTAD	Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Tregtinë dhe Zhvillimin
ZhSG	Zhvillimi i Sipërmarrjes së Grave



# Përmbledhje Ekzekutive

Nuk ka asnjë dyshim mbi rëndësinë e madhe të bizneseve në ekonomi, dhe ka prova gjithnjë e më të forta për rolin e bizneseve të drejtuara nga gratë në ekonomi. Pavarësisht studimeve të pakëta mbi dimensionet gjinore të sipërmarrjes apo mbi pjesëmarrjen e grave në veprimtari sipërmarrëse, ka prova që tregojnë për humbjet ekonomike që shtetet pësojnë nga përfshirja e ulët e grave në botën e sipërmarrjes. Sipas Bankës Botërore, rajoni i Ballkanit Perëndimor humbet 5% të PBB-së së tij vjetore nga pabarazia mes grave dhe burrave në sipërmarrje. Të dhënat globale tregojnë se nga 224 milion biznese me pronare gra në mbarë botën, 112 milion prej tyre punësojnë më shumë se një person, dhe vetëm 12 milion kanë në plan të punësojnë deri në gjashtë persona në dy-tre vitet e ardhshme<sup>1</sup>.

Studime më të hershme kanë krijuar metodologji për të vlerësuar dhe krahasuar sipërmarrjen e grave në botë. Një nga këto metodologji, sipas praktikave të OECD dhe Eurostat, ka krijuar kuadrin EDGE, ku 'faktorët përcaktues', 'rezultatet', dhe 'impaktet' ndërlidhen në formulimin dhe vlerësimin e masave politike.

Një numër analizash të kryera nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe aktorë të tjerë lidhur me sipërmarrjen e grave në Shqipëri dhe rajon, kanë vënë në dukje zhvillime pozitive në kuadrin ligjor dhe rregullator për gratë sipërmarrëse në vend, dhe së fundi ekspertët presin një forcim të qeverisjes së politikave të sipërmarrjes në Shqipëri. Disa palë të interesuara kyçe në shoqërinë civile dhe botën e biznesit, me mbështetjen e donatorëve po bëjnë përpjekje për ta rritur angazhimin e politikëbërësve në sipërmarrjen e grave. Gjithsesi, të gjitha palët e interesuara janë të vetëdijshme për mungesën e të dhënave, sondazheve dhe hulumtimeve në këtë fushë. Për këtë arsye, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim ka kryer një sondazh për gratë sipërmarrëse, në përpjekje për ta pasuruar këtë fushë studimesh, për të ofruar gjetje dhe/ose konkluzione. Gjetjet kryesore të sondazhit janë listuar më poshtë.

## Profili i Grave Sipërmarrëse

- Në përgjithësi, nëntë nga 10 gra sipërmarrëse jetojnë në zona urbane, shumica e tyre në Tiranë, Shkodër, Elbasan dhe Durrës.
- Një në tre gra sipërmarrëse janë midis 30 dhe 39 vjeç.

<sup>1</sup> Monitoruesi Global i Sipërmarrjes

- Edhe moshë kur e hapin biznesin është tek të tridhjetat.
- Pothuajse 3 në 4 gra sipërmarrëse janë të martuara dhe 3 në 4 kanë fëmijë.
- Gratë me numrin më të lartë të fëmijëve e kanë filluar biznesin vetëm në 2 vitet e fundit.
- Një në tre të anketuara kanë mbaruar arsimin e lartë, pra kanë një diplomë Bachelor, Master ose Doktoraturë, kryesisht në fushat e ekonomisë, biznesit dhe financës. Nëntë nga dhjetë gra sipërmarrëse kishin të paktën arsim të mesëm.

### **Të qenit sipërmarrëse**

- Motivimi numër një për të filluar një biznes për dy nga pesë gra është që të mbështesin familjet e tyre me të ardhura shtesë. Arsye kryesore që vijojnë pas kësaj janë, shtimi i të ardhurave, ndjekja e një ëndrre ose pasioni dhe ofrimi i diçkaje që mungon në treg.
- Vetëm një në njëzet gra sipërmarrëse u shprehën plotësisht të kënaqura me punën si pronare e sipërmarrjes. Dy faktorët që do t'i sillnin më shumë kënaqësi nismës së tyre janë më shumë të ardhura nga biznesi dhe më shumë mbështetje nga bashkëshorti, familja dhe komuniteti.
- Një në tetë të anketuara kalojnë mesatarisht 70 orë në javë në administrim ose duke punuar në biznesin e tyre.
- Orët mesatare të punës për një grua sipërmarrëse që nuk ka fëmijë janë 44.7 orë/javë, kurse për gratë me fëmijë mesatarja është 57 orë/javë.
- Gratë sipërmarrëse duket se janë shumë të mira në menaxhimin e balancës punë-jetë. Vetëm një në pesë gra sipërmarrëse e raportojnë menaxhimin e angazhimit në biznes dhe atij në familje si shumë të vështirë.

### **Sipërmarrjet e drejtuara nga gratë**

- Shumica e sipërmarrjeve të anketuara ishin themeluar në periudhën mes viteve 2010-2019. Viti me numrin më të lartë të regjistrimeve/krijimeve të bizneseve nga të anketuarat e këtij studimi është 2021 (10.9%),
- Nuk ka një trend specifik në krijimin e sipërmarrjeve të grave bazuar në aktivitetin ekonomik, por trendi shkon kryesisht në përputhje me ndërtimin e përgjithshëm të ekonomisë. Vihet re se në vitet e fundit ka një shtim të sipërmarrjeve në fushën e komunikimit, financës etj.
- Sipërmarrjet e drejtuara nga gratë operojnë kryesisht në tregtinë me pakicë (19%), shërbimet e mirëqenies (12%), modë (11%) etj.
- 3 në 4 gra sipërmarrëse (76.3%) janë të regjistruara zyrtarisht si person fizik.

- 13.8% janë Drejtore Ekzekutive të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar ose të një shoqërie aksionare. Gratë e regjistruara si aksionare në një shoqëri aksionare kryesisht zotëronin 50%-60% të aksioneve.
- Shtatë nga dhjetë gra sipërmarrëse e kanë themeluar vetë biznesin që drejtojnë sot. Më shumë se një nga dhjetë gra sipërmarrëse e kanë blerë, dhe më pak se një nga dhjetë e kanë trashëguar kompaninë.
- Në përgjithësi, më shumë se gjysma e grave sipërmarrëse (53.9%) kanë përdorur kursimet e familjes si burimin kryesor të financimit për të themeluar, regjistruar apo filluar një biznes. Bankat tregtare ishin burimi kryesor i financimit vetëm për një në dhjetë gra sipërmarrëse.
- 58% e sipërmarrjeve të drejtuara nga gra kanë 1-4 punonjës dhe 26% kanë më shumë se 5 punonjës. 16% e sipërmarrjeve të drejtuara nga gra nuk kanë punonjës të tjerë.
- Një nga pesë gra sipërmarrëse kishin të punësuar të paktën një pjesëtar të familjes në biznesin e tyre.
- Mesatarisht, bizneset e drejtuara nga gratë punësojnë 4 gra të tjera. Mesatarisht, ato punësojnë 50% më shumë gra sesa burra.
- 65.9% e grave sipërmarrëse nuk zbatojnë praktika të burimeve njerëzore në bizneset e tyre. Tek ato që zbatojnë praktika BNj, më e zakonshmeja që njihet dhe praktikohet është mentorimi.
- Më pak se gjysma e të anketuarave kanë një politikë të shanseve të barabarta të punësimit dhe diversitetit e përfshirjes.

### Zgjerimi i Biznesit

- Më shumë se gjysma e grave sipërmarrëse u shprehën se do të donin ta rrisnin biznesin por nuk kanë mundur ende. Gjithashtu, më pak se gjysma e sipërmarrjeve të drejtuara nga gratë kanë plane zgjerimi.
- Vetëm pak më shumë se gjysma e sipërmarrjeve mbajnë kapital rezervë në bizneset e tyre.
- Sipas të anketuarave, faktorët që ndikojnë në zgjerimin e një biznesi në nevojë janë: fuqia blerëse, taksat e larta, kostoja e punësimit të punonjësve të rinj dhe mungesa e stafit të trajnuar.

### Aksesi në Financim

- Shtatë nga dhjetë gra sipërmarrëse nuk kanë aplikuar asnjëherë për kredi bankare për biznesin e tyre. Nga ato që kanë marrë kredi, shumica kanë përdorur pasuri të paluajtshme si kolateral dhe pjesa tjetër kanë përdorur biznesin e tyre.
- Tre nga dhjetë gra sipërmarrëse thanë se nuk punojnë me këshillues biznesi.

## Aksesi në Tregje

- Nëntë nga dhjetë gra sipërmarrëse besojnë se kanë akses të mirë në tregun shqiptar.
- Vetëm tre nga dhjetë gra sipërmarrëse mendojnë se kanë informacion të mjaftueshëm për tregjet e huaja.

## Aksesi dhe përdorimi i Shërbimeve IT

- Pothuajse shtatë nga dhjetë (67.4%) të anketuara mendojnë se digjitalizimi dhe IT rrisin efikasitetin dhe produktivitetin e biznesit të tyre.
- Më shumë se gjysma e këtyre bizneseve kishin një faqe interneti ose profil në platformat sociale.
- Nivelet e angazhimit në përdorimin e software-eve apo teknologjive për qëllimet e biznesit janë shumë të ulëta.
- Më shumë se gjysma e bizneseve kanë akses në aplikacionet bankare, por vetëm tre nga dhjetë biznese ofrojnë mundësinë për pagesa online.

## Zhvillimi i Kapaciteteve

- Tre nga pesë të anketuara deklaruan se nuk kanë dëgjuar për ndonjë kurs formal apo informal për fillimin e një biznesi. Më shumë se gjysma e këtyre bizneseve shprehën dëshirën për të marrë pjesë.
- Arsyeja kryesore e raportuar për mospjesëmarrjen në trajnime ishte se nuk mund të shkëputeshin nga biznesi.
- Nevojat më të shpeshta për trajnim janë për përdorimin e marketingut digjital, planifikimin për të ardhura më të larta dhe të pasurit e një biznesi të qëndrueshëm.
- Vetëm 2 nga 5 të anketuara kanë marrë pjesë në trajnime për përdorimin e kompjuterit dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

## Njohuritë Financiare dhe Sipërmarrëse

- Rreth gjysma e grave sipërmarrëse (46.5) zgjedhin t'i ndajnë financat e biznesit nga ato personale. Vetëm një në pesë gra sipërmarrëse deklarojnë se i kuptojnë plotësisht treguesit financiarë të biznesit të tyre.
- Gjashtë nga dhjetë gra sipërmarrëse nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në një trajnim lidhur me financat e biznesit dhe shtatë nga dhjetë nuk kanë marrë asnjëherë trajnim mbi financat personale.
- Pothuajse çereku i grave sipërmarrëse kishin një plan të detajuar para se ta fillonin biznesin e tyre, të cilin vazhdojnë ta zbatojnë. E njëjta përqindje thonë se nuk kanë pasur plan biznesi kur e kanë nisur biznesin e tyre.

# Hyrje

Politikëbërësit e njohin sipërmarrjen e grave si një komponent të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik të një vendi. Ka të dhëna se pjesëmarrja ekonomike e grave dhe PBB për frymë janë në korrelacion pozitiv<sup>2</sup>. Fatkeqësisht, të dhënat globale tregojnë se vetëm një në tre biznese janë në pronësi të grave; ka ende pengesa dhe burrat ende ua kalojnë grave 3-1 kur bëhet fjalë për pronësinë e bizneseve<sup>3</sup>.

Nëse pjesëmarrja e grave si sipërmarrëse do të ishte e barabartë me atë të burrave, rajoni do të kishte mesatarisht një PBB 5,0 % më të lartë, sipas një studimi të Bankës Botërore dhe punës kërkimore të ekonomistëve të saj<sup>4</sup>. Me shpërthimin e pandemisë ka pasur një numër studimesh kërkimore mbi ndikimin e saj, por nuk ka një ndjekje të mëtejshme të studimit të cituar më sipër.

Vlerësimet e mëparshme të kryera nga Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim tregojnë se ka progres në kuadrin e përgjithshëm që mundëson sipërmarrjen e grave. Në rajon ekzistojnë disa partneritete aktive, zyrtare ose jozyrtare, të sipërmarrjes së grave midis enteve publike dhe private që zbatojnë së bashku programe mbështetëse të natyrave të ndryshme<sup>5</sup>.

Barazia gjimore mbështetet në një bazë të fortë ligjore brenda kuadrin ligjor shqiptar. Diskriminimi me bazë gjimore është i mirë-rregulluar dhe Ligji për Barazinë Gjimore rregullon çështjet themelore, ofron mbrojtje të barabartë dhe qasje të barabartë për gratë dhe burrat në jetën publike dhe në zhvillimet sociale dhe ekonomike.

Ekzistojnë disa strategji dhe politika për barazinë gjimore në Shqipëri. Me kalimin e kohës dhe progresin në fusha të tjera të jetës, fokusi është rritur në fuqizimin ekonomik të grave, por mbetet më i ulët në sipërmarrjen e grave. Ka pasur vetëm një Plan Veprimi për Gratë Sipërmarrëse në periudhën 2014-2020, i cili nuk është ndjekur nga një raport përfundimtar dhe një plan veprimi pasues<sup>6</sup>.

<sup>2</sup> Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. 2021, Përfitimet ekonomike të barazisë gjimore dhe fuqizimit të grave në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

<sup>3</sup> Banka Botërore. 2022. Burime për Sipërmarrjen Femërore.

<sup>4</sup> Banka Botërore. 2019. Shqipëria do të Rrisë Barazinë Gjimore në Aksesin ndaj Mundësive Ekonomike me Mbështetjen e Bankës Botërore. Washington DC.

<sup>5</sup> Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. 2022. Punësimi i Grave në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor.

<sup>6</sup> Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim. (Topi E.). 2021. Rilançimi i Sipërmarrjes së Grave

Gjithashtu, profili i grave sipërmarrëse është eksploruar pak në shoqërinë shqiptare. Sondazhet janë të pakëta dhe datojnë më shumë se 10 vjet më parë në kohë. Ky raport është një përpjekje për të përpiluar një rishikim të literaturës mbi perspektivat kryesore për sipërmarrjen e grave dhe matjen e treguesve kryesorë, si dhe për të ofruar një profil përshkrues të grave sipërmarrëse në Shqipëri, të motivimit dhe sfidave të tyre për të filluar dhe vazhduar një biznes.



# Rishikimi i Literaturës

Ky kapitull prezanton perspektivat kryesore mbi sipërmarrjen e grave, siç diskutohen në punimet kërkimore nga pikëpamja akademike, faktorët që ndikojnë në diversitetin gjinor në udhëheqjen e bizneseve, si dhe jep një përmbledhje të disa prej raporteve kryesore ndërkombëtare për Shqipërinë. Më tej ai paraqet të dhënat më të fundit të disponueshme që përshkruajnë situatën e sipërmarrjes së grave në vend dhe bën një përpjekje për të mbledhur bashkë të gjitha studimet e kryera mbi sipërmarrjen e grave në Shqipëri në vitet e fundit, duke analizuar tiparet kryesore të grave sipërmarrëse, si dhe faktorët nxitës apo pengesat ndaj rritjes së pranisë së grave në botën e biznesit në Shqipëri.

## Një Perspektivë Akademike mbi Sipërmarrjen e Grave

### Sipërmarrja e Grave: Çfarë të presim?

Hulumtimet demonstrojnë rolin që luan faza e zhvillimit ekonomik të një vendi kur vlerësohet ndikimi i sipërmarrjes në rritjen ekonomike, siç tregohet nga Hashi & Krasniqi (2011)<sup>7</sup>, Marcotte (2014)<sup>8</sup>, Van Stel et al. (2005)<sup>9</sup> apo Wong et al., (2005)<sup>10</sup>. Përfundimet mund të ndryshojnë midis ekonomive të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, por megjithatë nuk ka dyshim për rëndësinë e shtuar të sektorit privat në ekonomi. Për këtë arsye, qeveritë e vendeve në zhvillim kanë vlerësuar dhe përqafuar politika që rrisin aktivitetet sipërmarrëse. Zhvillimi i sektorit privat është i lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik të çdo vendi.

Bizneset ekzistuese dhe ato të reja,<sup>11</sup> qofshin të vogla, të mesme apo të mëdha, zënë një peshë të madhe të punësimit, duke përbërë kështu një faktor kritik në mirëqenien e shoqërive. Një sektor i fortë privat krijon punësim dhe rritje të qëndrueshme. Aktualisht ai ofron rreth 90% të vendeve të punës në

<sup>7</sup> Hashi, I., & Krasniqi, B. A. (2011). Sipërmarrja dhe rritja e NVM-ve: Të dhëna nga ekonomi të përparuara dhe ato në tranzicion. Revista Ndërkombëtare e Kërkimit & Sjelljes Sipërmarrëse, 17, 456-487.10.1108/13552551111158817

<sup>8</sup> Marcotte, C. (2014). Sipërmarrja dhe inovacioni në ekonomitë në zhvillim: Çështje konceptuale, metodologjike dhe kontekstuale. Revista Ndërkombëtare e Kërkimit & Sjelljes Sipërmarrëse, 20, 42-65.10.1108/IJEBR-09-2012-0089

<sup>9</sup> Van Stel, A., Carree, M., & Thurik, R. (2005). Ndikimi i veprimtarisë sipërmarrëse në rritjen ekonomike kombëtare. Ekonomia e Biznesit të Vogël, 24, 311-321.10.1007/s11187-005-1996-6

<sup>10</sup> Wong, P. K., Ho, Y. P., & Autio, E. (2005). Sipërmarrja, inovacioni dhe rritja ekonomike: Prova nga të dhënat e GEM. Ekonomia e Biznesit të Vogël, 24, 335-350.10.1007/s11187-005-2000-1

<sup>11</sup> Në këtë raport, termat “biznes”, “sipërmarrje”, “shoqëri” dhe “firmë” përdoren në vend të njëri-tjetrit me të njëjtin kuptim.

vendet në zhvillim dhe si pasojë është një partner thelbësor për qeverinë në luftën kundër varfërisë<sup>12</sup>.

Një analizë e Komisionit Evropian tregon se gratë janë të nënpërfaqësuar në komunitetet e biznesit në vendet në zhvillim. Ky fenomen, megjithëse ka marrë vëmendje të shtuar në dekadën e fundit, nuk mbështetet domosdoshmërisht në studime dhe analiza historike.

Përgjithësisht ka një **mungesë studimesh** lidhur me **dimensionet gjinore të sipërmarrjes, hendeqet gjinore, pjesëmarrjen e grave në veprimtari sipërmarrëse** dhe performancën e tyre. Ç'është më e rëndësishmja, megjithëse shifrat zyrtare janë të pasura me statistika biznesi, nuk ka gjithmonë të dhëna zyrtare të ndara sipas gjinisë. Një përfundim i ngjashëm është arritur nga një studim i kohëve të fundit mbi sipërmarrjen e grave në rajonin e Ballkanit Perëndimor, nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, ku evidentohet nevoja për më shumë të dhëna të ndara sipas gjinisë për sa më sipër dhe sektori publik duhet të përgatisë terrenin për **statistika të forta me bazë gjinore**<sup>13</sup>.

Ndryshimet e mëdha ekonomike dhe sociale në Shqipëri në njëzet vitet e fundit kanë sjellë ndryshime të rëndësishme në pozicionin e gruas brenda familjes dhe shoqërisë. Një nga ndryshimet më të rëndësishme dhe më të dukshme është **pjesëmarrja e gruas në tregun e punës**, gjë që ka forcuar rolin e saj në zhvillimin ekonomik dhe social të familjes dhe shoqërisë.

Zhvillimet e fundit në tregun e punës janë shoqëruar me një shkallë më të ulët pjesëmarrjeje për burrat dhe gratë, por rënia e pjesëmarrjes ishte më e madhe për gratë dhe për rrjedhojë hendequ gjinor i pjesëmarrjes është zgjeruar. Në tremujorin e tretë të vitit 2022, hendequ gjinor në pjesëmarrjen në forcën punëtore është 12.4 pikë përqindjeje më shumë për burrat, ku shkalla e pjesëmarrjes në forcën punëtore për gratë është 67.3%, ndërsa për burrat është 79.7%<sup>14</sup>.

Hulumtimet ndërkombëtare janë përqendruar në gjetjen e shkaqeve pse gratë **nuk ngjiten në postet më të larta të punës** në mjedisin e biznesit. Katër shkaqe kryesore mund të identifikohen në literaturë<sup>15</sup>. Së pari, shpjegimi i “tavanit

<sup>12</sup> Komisioni Evropian. (2014). Një Rol më i Fortë i Sektorit Privat në Rritjen Përfshirëse dhe të Qëndrueshme të Vendeve në Zhvillim, Komunikim nga Komisioni drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetit të Rajoneve. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52014DC0263&qid=1400681732387&from=EN>

<sup>13</sup> Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC). 2023. Analizë Krahasuese: Sipërmarrja e Grave në Ballkanin Perëndimor.

<sup>14</sup> INSTAT. Anketa e Forcave të Punës: Tremujori i Tretë 2022, Njoftim për Shtyp. 2022

<sup>15</sup> Hoobler, J. M., Grace, L., Wayne, S. J. Nënperfaqësimi i grave në postet e menaxhimit të lartë: New insights on a persistent problem. Dinamikat Organizative (2011) 40, 151–156

të qelqtë” fokusohet në diskriminimin për shkak të tendencës për t’i lidhur karakteristikat mashkullore me pozicionet drejtuese. Shpjegimi i dytë lidhet me pjesëmarrjen më të ulët të grave në shkollat juridike dhe programet M.B.A, gjë që mund të shpjegojë praninë e tyre më të ulët në poste drejtuese dhe borde. Sipas këtij shpjegimi, do të vijë koha kur gratë do të marrin poste të larta drejtuese në numër të barabartë me burrat, atëherë kur të ketë mjaftueshëm gra të kualifikuara “në gatishmëri”. Ndërkohë që ka prova që mbështesin shpjegimin e parë, studimet nuk e kanë mbështetur të dytin, veçanërisht duke pasur parasysh shkallën më të lartë të përfundimit të doktoraturës dhe masterit nga gratë në krahasim me burrat në një gamë të gjerë fushash, në të cilat megjithatë duket se ka “rrjedhje” rrugës për në postet e larta.

Shpjegimet e ofruara në kategorinë e tretë bazohen në idenë se gratë dhe burrat janë të ndryshëm dhe e shpjegojnë përfshirjen më të lartë të burrave në menaxhim me preferencat e tyre më të larta për këto poste, ndërkohë që i konsiderojnë gratë si natyra që i shmangen rrezikut. Në këtë këndvështrim, supozohet se me politikat progresive të barazisë gjinore, gratë u përpoqën të arrinin barazinë në karrierë me burrat, por ndërtimi i tyre gjenetik është mbizotërues, kështu që dallimet në arritjet në karrierë janë të natyrshme dhe të paracaktuara.

Shpjegimi i katërt fokusohet në strukturën e punës në ditët e sotme dhe në papajtueshmërinë e mjedisit konkurrues të biznesit me detyrat familjare dhe shtëpiake. Postet e larta të menaxhimit mund t’i detyrojnë gratë të zgjedhin midis punës dhe familjes, veçanërisht në rastin e nënave beqare. Ndërkohë që si gratë ashtu edhe burrat kanë më pak kohë për t’i kushtuar karrierës kur përgjegjësitë e tyre shtëpiake përfshijnë bashkëshortët dhe fëmijët, shumë studime kanë dokumentuar se gratë janë gjithsesi përgjegjëse për shumicën e punëve në familje, dhe për këtë arsye karriera e tyre ndikohet më shumë nga rolet shtëpiake. Megjithatë, këto shpjegime mund t’i mbivendosen njëri-tjetrit dhe nuk përjashtojnë njëri-tjetrin.

Një numër i madh kërkimesh i kushtohet gjithashtu marrëdhënies ndërmjet pranisë së grave në poste drejtuese e borde dhe rezultateve të kompanisë, duke vënë në dukje përfitimet që sjell një përfshirje më e madhe e grave në vendimmarrje, jo vetëm në drejtim të promovimit të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, por edhe në drejtim të përmirësimit të performancës së biznesit. Të dhënat e kërkimeve tregojnë se bordet përfshirëse, të balancuara dhe me diversitet kanë më shumë gjasa të jenë më efektive, më të afta për të kuptuar klientët e tyre dhe palët e interesit, si dhe për të përfituar nga perspektiva të reja, ide të reja, sfida të fuqishme dhe përvoja të gjera, duke çuar kështu në një vendimmarrje më të mirë<sup>16</sup>.

<sup>16</sup> Gratë në Borde, 2011. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. <https://assets.publishing.service>.

Sipas qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, diversiteti gjinor në udhëheqjen e biznesit, veçanërisht diversiteti gjinor në bordet e bizneseve, ka katër dimensione kryesore:

1. Përmirësimi i performancës. **Treguesit e ndryshëm të performancës së biznesit ndikohen pozitivisht nga rritja e nivelit të përfaqësimit të grave në borde dhe pozita të larta drejtuese.** Bordet zakonisht përbëhen nga anëtarë të ngjashëm, me sfonde, arsim dhe rrjete të ngjashme. Prania e grave do të diversifikojë sfondet, përvojat dhe këndvështrimet duke çuar në një vendimmarrje më të mirë. Ato i shtojnë perspektiva dhe zëra të ndryshëm debatit dhe vendimeve<sup>17</sup>. Drejtoret femra pritet të përmirësojnë performancën përmes rritjes së pavarësisë së bordit<sup>18</sup>. Gratë i marrin më seriozisht rolet e tyre drejtuese jo-ekzekutive, duke u përgatitur më me përgjegjësi për mbledhjet. Zelechowski dhe Bilimoria (2004)<sup>19</sup> kanë treguar se nevojiten tre gra për të ndryshuar dinamikën e sallës së bordit duke bërë të mundur që t'u dëgjohet zëri. McKinsey & Company (2007)<sup>20</sup> tregojnë se mjedisi për gratë në poste të larta përmirësohet kur rreth një e treta e drejtuesve në atë nivel janë femra dhe korporatat me të paktën 30% gra në nivelin e lartë të menaxhimit prodhojnë rezultatet më të mira financiare. Bhogaita (2011)<sup>21</sup> zbuloi se performanca operationale dhe e çmimeve të aksioneve rritet në mënyrë të konsiderueshme për kompanitë ku gratë përbëjnë mbi 20% të anëtarëve të bordit, krahasuar me kompanitë me përfaqësim më të ulët të grave. Një studim tjetër ka treguar se të pasurit të paktën një drejtore femër në bord duket se zvogëlon shanset e falimentimit të një kompanie me 20% dhe se të pasurit dy ose tre drejtore gra ul edhe më tej shanset për falimentim<sup>22</sup>. Megjithatë, kjo nuk duhet të konsiderohet si një lojë shifrash gjinore. Një faktor kyç që nxit bordet është fitimi dhe të ardhurat për aksionerët. Ka një numër studimesh që ilustrojnë ndikimin pozitiv që kontributi i grave në sallën e bordit mund të sjellë në totalin e financave të kompanisë dhe që lidhin pozitivisht bordet me diversitetin gjinor me përmirësimin e performancës, siç u përmend më sipër.

[gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/31480/11-745-women-on-boards.pdf](http://gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/31480/11-745-women-on-boards.pdf)

<sup>17</sup> Zelechowski, D. dhe Bilimoria, D. (2004). Karakteristikat e grave dhe burrave drejtorë të brendshëm të korporatave në SHBA, Qeverisja e Korporatave: Një Analizë Ndërkombëtare, 12(3): 337-42

<sup>18</sup> Fondas, N. dhe S. Sallalos (2000). "Një Zë Ndryshe në Sallën e Bordit: Si Ndikon Prania e Drejtoreve Gra në Influencën e Bordit mbi Menaxhimin." Fokus Global, 12: 13-22.

<sup>19</sup> Zelechowski, D. dhe Bilimoria, D. (2004). Karakteristikat e grave dhe burrave drejtorë të brendshëm të korporatave në SHBA, Qeverisja e Korporatave: Një Analizë Ndërkombëtare, 12(3): 337-42

<sup>20</sup> "Gratë Kanë Rëndësi: diversiteti gjinor, një faktor nxitës i performancës së korporatës", McKinsey & Company, 2007

<sup>21</sup> 'Kompanitë me një historik më të mirë të promovimit të grave kanë performancë më të mirë në investime', Bhogaita M, New Model Advisor, 2011

<sup>22</sup> Gratë në sallën e bordit i ndihmojnë kompanitë të kenë sukses – artikull i Times, 19 mars 2009 – Profesor Nick Wilson LUBS

UN Global Compact dhe UN Women kanë zhvilluar së fundmi **Parimet e Fuqizimit të Grave**, një grup Parimesh që ofrojnë udhëzime për bizneset se si të promovojnë barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në vendin e punës, treg dhe komunitet<sup>23</sup>. Këto Parime nënshkruhen në mënyrë të pavarur dhe publike nga kompani ndërkombëtare dhe lokale në mbarë globin. Këto shtatë parime janë një grup angazhimesh me shtrirje të gjerë, që nga krijimi i një lidhshipi të nivelit të lartë në korporatë për barazinë gjinore apo trajtimin e drejtë dhe të barabartë në punë, deri te promovimi i barazisë nëpërmjet nismave komunitare dhe advokimit apo matja dhe raportimi publik mbi progresin drejt arritjes së barazisë gjinore. **Deri në fund të vitit 2022, vetëm 38 kompani në Shqipëri** i kanë nënshkruar këto Parime apo kanë lëshuar një deklaratë në mbështetje të tyre<sup>24</sup>.

2. Qasja në një fond sa më të gjerë talentesh – shfrytëzimi i aftësive të të gjithëve. Gratë përbëjnë një grup të madh të të diplomuarve nga universitetet. Në Shqipëri raporti i grave ndaj burrave të diplomuar në arsimin e lartë është 1.49<sup>25</sup>. Mos-shfrytëzimi i talenteve të të gjithëve do të rezultojë në performancë më të ulët jo vetëm për bizneset, por edhe për ekonominë. Për këtë arsye, është jetike që kompanitë të përdorin fondin e pashfrytëzuar të talenteve femra në nivel bordi në mënyrë që të ruajnë aftësinë konkurruese dhe t'u përgjigjen pritshmërive dhe kërkesave të tregut që ndryshojnë me shpejtësi.

3. Të qenit më reagues ndaj tregut. Gratë përbëjnë afërsisht gjysmën e popullsisë së vendit dhe 52.6% të forcës punëtore<sup>26</sup>. Ato janë gjithashtu përgjegjëse për shumicën e vendimeve blerëse të familjes. Përfshirja e grave në borde mund të shihet si një përfaqësim i përdoruesve përfundimtarë dhe konsumatorëve të produkteve të kompanive. Kjo mund të ndihmojë për të kuptuar më mirë nevojat e konsumatorëve, duke çuar në një vendimarrje më të informuar.

4. Arritja e një qeverisjeje më të mirë të korporatës. Bordet më të balancuara nga ana gjinore kanë më shumë gjasa të identifikojnë kriteret për matjen e strategjisë, të monitorojnë zbatimin e saj, të ndjekin udhëzimet për konfliktet e interesit dhe t'i përmbahen një kodi sjelljeje. Gratë gjithashtu kanë më shumë gjasa të sigurojnë komunikim më të mirë dhe të përqendrohen në masa të tjera jofinanciare të performancës, të tilla si kënaqësia e punonjësve dhe konsumatorëve, diversiteti dhe përgjegjësia sociale e korporatës. Këto pritshmëri janë konfirmuar në hulumtime të kohëve të fundit<sup>27</sup>.

<sup>23</sup> Parimet e Fuqizimit të Grave. Faqja ueb: <https://www.WEPs.org/>

<sup>24</sup> Parimet e Fuqizimit të Grave (WEP). Uebfaqja. Harta Interaktive e Nënshkruesve të WEP. Shqipëria. Aksuar më 12 dhjetor 2022

<sup>25</sup> INSTAT. 2021. Gratë dhe Burrat 2021. Tiranë, Shqipëri

<sup>26</sup> INSTAT. 2022. Seti Minimal i Treguesve Gjinorë. Tiranë, Shqipëri.

<sup>27</sup> Brown, D., Brown, D. dhe Anastasopoulos, V. (2002) Gratë në Borde: Jo Thjesht Gjëja e

Ndërkohë që ekziston një konsensus i gjerë mbi përfitimet që sjell diversiteti gjinor në menaxhimin e aktiviteteve ekonomike, një nga arsyet kryesore pse nuk është studiuar mjaftueshëm sipërmarrja nga perspektiva gjinore është mungesa e masave dhe metodave standarde për mbledhjen e të dhënave. Literatura në këtë fushë është duke u pasuruar me prova për rëndësinë që fuqizimi ekonomik i grave dhe veçanërisht pjesëmarrja e tyre në aktivitetet sipërmarrëse ka në rritjen ekonomike, uljen e varfërisë, krijimin e vendeve të punës dhe punësimin e grave<sup>28</sup>. Gratë sipërmarrëse përbëjnë një burim të rëndësishëm kontributi në ekonominë e vendit. Ndërmarrjet e tyre jo vetëm që kontribuojnë në rritjen e punësimin, por gjithashtu zgjerojnë tregtinë rajonale, shpenzojnë një sasi më të madhe të të ardhurave për përmirësimin e mirëqenies së familjeve të tyre, investojnë shuma më të larta për shëndetin dhe edukimin e fëmijëve, si dhe kujdesin për prindërit e tyre të moshuar, duke çuar në një zhvillim më të mirë ekonomik dhe social të shoqërisë. Ka prova gjithnjë e më të forta se bizneset e drejtuara nga gratë kanë norma më të larta inovacioni të produkteve dhe shërbimeve, diversifikim më të lartë në menaxhim, në prodhim dhe në praktikat e marketingut.

Literatura mbi sipërmarrjen e grave në Shqipëri është e kufizuar. Ka shumë pak studime apo sondazhe të kryera gjatë viteve mbi sipërmarrjen e grave. Disa prej tyre janë shumë të hershme, si për shembull një studim i kryer nga Bezhani, M. (2001) për ILO<sup>29</sup>, ose Ramadani, V. (2015)<sup>30</sup>. Sipas këtyre studimeve, **një nga faktorët kryesorë që ndikon në sipërmarrjen e grave në Shqipëri është edukimi sipërmarrës**<sup>31</sup>, një fenomen i vërejtur edhe në studime të mëparshme ku gratë sipërmarrëse në Shqipëri ishin të arsimuara ose me arsim të lartë<sup>32</sup>. Sipas studimeve të OECD-së në rajon, Shqipëria është përmirësuar në dimensionet e të mësuarit sipërmarrës dhe të sipërmarrjes së grave, në kuadër të Indeksit të Politikave të NVM-ve për vitin 2022<sup>33</sup>.

Është treguar se faktorët nxitës dhe barrierat që hasin burrat dhe gratë sipërmarrëse janë të ndryshme, kryesisht për shkak të roleve të ndryshme që

Duhur . . . Por Gjēja “e Shkëlqyer”, Raport, 341-02: Bordi i Konferencave i Kanadasë, Otava.  
<sup>28</sup> Banka Botërore 2014. Mbështetja e grave sipërmarrëse me potencial të lartë rritjeje. Dokument mbi politikën e inovacionit, teknologjisë dhe sipërmarrjes; nr. 5. Uashington, DC: Grupi i Bankës Botërore

<sup>29</sup> Organizata Ndërkombëtare e Punës, Gratë Sipërmarrëse në Shqipëri, Bezhani. M. Gjenevë, Organizata Ndërkombëtare e Punës, 2001

<sup>30</sup> Ramadani V. 2015. Gruaja Sipërmarrëse në Shqipëri: Një Studim Eksplorues mbi Motivimin, Problemet dhe Faktorët e Suksesit. Revista e Studimeve mbi Ballkanin dhe Lindjen e Afërt.

<sup>31</sup> Rica R. 2021. Kuadri i sipërmarrjes së grave në Shqipëri. Revista e Ekonomisë dhe Biznesit. Universiteti i Mostar

<sup>32</sup> Ramadani V. 2015. Gruaja Sipërmarrëse në Shqipëri: Një Studim Eksplorues mbi Motivimin, Problemet dhe Faktorët e Suksesit. Revista e Studimeve mbi Ballkanin dhe Lindjen e Afërt.

<sup>33</sup> OECD. 2022. “Shqipëria: Profili i Ekonomisë”, në Indeksi i Politikave të NVM-ve: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2022: Vlerësim i Zbatimit të Aktit të Biznesit të Vogël për Evropën, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/d22fdb37-en>.

shoqëria pret nga burrat dhe nga gratë, si dhe të mjedisit që nxit sipërmarrjen. Studimet janë të kufizuara për sa i përket vështirësive shtesë që familja dhe kujdesi për fëmijët krijon për gratë sipërmarrëse shqiptare, veçanërisht në fillim të fazës së konceptimit të biznesit<sup>34</sup>. Gjetjet se gratë fillojnë biznesin më vonë në jetë, dhe jo herët kur janë të reja, mund të shpjegohen me rolet e shumëfishta dhe të njëkohshme që gratë mbajnë brenda shoqërisë<sup>35</sup>. Një grua ka më shumë gjasa të përballlet me përgjegjësi të dyfishta në familje, mungesë kolaterali për shkak të kufizimit të të drejtave të pronësisë, të qenit fituese e vetme e të ardhurave në familje, si dhe pengesa të tjera kontekstuale që kufizojnë aftësinë e saj për të fituar. Është raportuar se shtimi i të ardhurave për veten ose familjen është arsyeja numër një e krijimit të një biznesi nga një grua<sup>36</sup>, krahas arsyeve të tjera kyçe si liria dhe kontrolli në vendimmarrje<sup>37</sup>. Prandaj, është e nevojshme të eksploroher rëndësia e sigurimeve, masave mbrojtëse, kursimeve dhe investimeve, si faktorë të rëndësishëm mbështetjeje për gratë sipërmarrëse.

### Shqipëria në Raportet Ndërkombëtare

- **Raporti Global i Hendekut Gjinator 2022**, nga Forumi Ekonomik Botëror, e rendit Shqipërinë në vendin e 18-të mes 142 vendeve, për sa i përket dallimeve gjinore në pjesëmarrjen dhe mundësitë e grave. Shqipëria është përmirësuar me njëzet pozicione në krahasim me vitin 2006 dhe me tetëmbëdhjetë pozicione nga viti 2020, duke u bërë kështu një nga vendet me progresin më të lartë në Evropë. Megjithatë, në vitin 2022, Shqipëria renditej në vendin e 76-të për sa i përket pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, me një rritje prej gjashtëmbëdhjetë vendesh krahasuar me vitin 2013. Vendi ka shënuar përmirësim të konsiderueshëm për sa i përket mbylljes së hendekut në fuqizimin politik, duke u renditur në vendin e 25-të dhe duke shfaqur një përmirësim të konsiderueshëm krahasuar me vitin 2006 kur renditej në vendin e 105-të. Shqipëria renditet në vendin e parë për gratë në poste ministrore në qeveri. Po ky raport e rendit Shqipërinë në vendin e parë për regjistrimin e grave në arsimin e lartë<sup>38</sup> dhe në vendin e 76-të për sa i përket angazhimit të grave si ligjvënëse, zyrtare të larta dhe drejtuese. Këto shifra tregojnë se gratë performojnë

34 AFD. Si ndikon fertiliteti në punësimin e grave? Të dhëna nga Shqipëria. Dokumente Kërkimore. 2022

35 Together for Life. 2020. Klima e përgjithshme e biznesit dhe ndikimi i tërmeteve të vjeshtës 2019 e pandemisë COVID-19 te gratë sipërmarrëse. Tiranë. Shqipëri.

36 Bezhani. M. 2001. Gratë Sipërmarrëse në Shqipëri, Gjenevë, Organizata Ndërkombëtare e Punës.

37 Ramadani V. 2015. Gruaja Sipërmarrëse në Shqipëri: Një Studim Eksplorues mbi Motivimin, Problemet dhe Faktorët e Suksesit. Revista e Studimeve mbi Ballkanin dhe Lindjen e Afërt.

38 Forumi Ekonomik Botëror. Raporti Global i Hendekut Gjinator 2022. 13 korrik 2022



më mirë se burrat në arsim, por **menaxhimi i korporatave, lidershipi dhe sipërmarrja janë ende një “zonë burrash” në Shqipëri.**

- **Raportet e Zhvillimit Njerëzor** paraqesin metrika që vlerësojnë hendeqet gjinore, pabarazinë, presionet planetare dhe varfërinë. Indeksi i Zhvillimit Gjinor dhe Indeksi i Pabarazisë Gjinore janë dy nga indekset pjesë e këtyre raporteve. Shqipëria ka 1.007 pikë në Indeksin e Zhvillimit Gjinor, i cili llogaritet si raport i Indeksit të Zhvillimit Njerëzor (HDI) për gratë ndaj atij të burrave (vlera e HDI-së për Shqipërinë është 0,799 për gratë në krahasim me 0,794 për burrat). Kjo e vendos Shqipërinë në vendet e grupit të parë, krahas vendeve më të zhvilluara<sup>39</sup>. Indeksi i Pabarazisë Gjinore e rendit Shqipërinë në vendin e 39-të nga 170 vende në vitin 2021<sup>40</sup>. Indeksi ka një vlerë prej 0.144 dhe mat pabarazitë gjinore (humbjet në zhvillimin njerëzor për shkak të pabarazisë ndërmjet arritjeve të femrave dhe meshkujve) në tre dimensione kyçe – shëndeti riprodhues, fuqizimi dhe tregu i punës.
- **Indeksi i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2022** e rendit Shqipërinë në vendin e 61-të nga 163 vende të listuara në renditje<sup>41</sup>, me një rezultat të përgjithshëm prej 71.63. Raporti vlerëson gjithashtu Indeksin e Ndikimit në Vendet e Tjera (Spillover Index) në tre dimensione: ndikimet mjedisore dhe sociale të mishëruara në tregti, ekonomia dhe financa, si dhe siguria. Shqipëria ka notën 93.63 dhe si e tillë njihet si një vend me efekt ‘spillover’ të lartë dhe pozitiv. Vlerësimi për OZhQ 5: Barazia Gjinore vë në dukje një përmirësim të moderuar, por të pamjaftueshëm për të arritur qëllimin, me sfida të konsiderueshme që mbeten ende.
- Një krahasim i shpejtë i gjetjeve nga **Anketa e Mjedisit të Biznesit dhe Performancës së Sipërmarrjes (BEEPS) 2013 dhe 2019**, e kryer nga BERZH në bashkëpunim me Bankën Botërore, tregon se gratë në Shqipëri ishin aksionere në 12.3 dhe 20.7 për qind të bizneseve, në 2013 dhe 2019 përkatësisht. Pavarësisht rritjes, pjesëmarrja e grave në pronësi është e ulët krahasuar me vendet evropiane dhe të Azisë Qendrore (33,9% në 2019). Për sa i përket pronësisë me shumicë aksionesh të grave, të dhënat e BEEPS tregojnë se vetëm 16.9 për qind e bizneseve i kanë shumicën e aksioneve të zotëruara nga një grua, ndërsa INSTAT raporton se gratë zinin 32.1 për qind të pozicioneve menaxheriale në 2015 dhe 34.7 për

<sup>39</sup> Raportet e Zhvillimit Njerëzor. 2022. Të Dhënat mbi Shqipërinë – Indeksi i Zhvillimit Gjinor.

<sup>40</sup> Raportet e Zhvillimit Njerëzor. 2022. Të Dhënat mbi Shqipërinë – Indeksi i Pabarazisë Gjinore.

<sup>41</sup> Sachs et al. 2022: Nga Kriza në Zhvillimin e Qëndrueshëm: OZhQ-të si Udhërrëfyes drejt 2030-ës dhe më tej. Raporti i Zhvillimit të Qëndrueshëm 2022. Cambridge: Cambridge University Press.



qind në 2019<sup>42</sup>. 18.1 për qind e kompanive kanë një grua menaxhere, shifër që është shumë afër mesatares së vendeve evropiane dhe të Azisë Qendrore, prej 18.3%<sup>43</sup>.

- **Studimi “Gratë, Biznesi dhe Ligji” i Bankës Botërore** vlerëson rregulloret që mundësojnë shanse të barabarta për gratë dhe burrat në 190 ekonomi. Në vitin 2022 Shqipëria konsiderohet e qëndrueshme në arritjen e barazisë mes burrave dhe grave. Indeksi për Shqipërinë në këtë raport është 91.3.
- Vlerësimi më i fundit i **Aktit të Biznesit të Vogël për Evropën në Indeksin e Politikave të NVM-ve për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë**<sup>44</sup>, e rendit Shqipërinë nën mesataren e rajonit për nëndimensionin e të mësuarit sipërmarrës dhe sipërmarrjes së grave. Këto të fundit janë dy nëndimensionet e komponentit, të vlerësuara me një qasje procesi përmes planifikimit dhe hartimit, zbatimit dhe monitorimit e vlerësimit. Nëndimensioni i sipërmarrjes së grave performon më mirë për sa i përket planifikimit dhe hartimit të politikave e masave. Ka përmirësime të dukshme.

## Një Perspektivë mbi Sipërmarrjen e Grave e Bazuar në të Dhëna

### Matja e dimensionit gjinor në sipërmarrje

Një nga arritjet më të rëndësishme për adresimin e çështjeve të metodologjisë dhe të dhënave lidhur me gjininë në sipërmarrje ishte projekti “Prova dhe të dhëna për Barazinë Gjinore” (EDGE - Evidence and Data for Gender Equality), i cili zhvilloi dhe pilotoi metodologji për të integruar një dimension gjinor në të dhënat zyrtare të sipërmarrjes. Projekti identifikoi konceptet, përkufizimet dhe metodat statistikore të nevojshme për të mbushur boshllëkun e informacionit për gratë dhe burrat sipërmarrës në nivel kombëtar dhe për të përmirësuar krahasueshmërinë e të dhënave në nivel ndërkombëtar (OKB, 2018).<sup>45</sup> Bazuar në kuadrin e Programit të Treguesve të Sipërmarrjes nga OECD-Eurostat, ekspertët e projektit EDGE hartuan një kuadër të ri konceptual që i përcakton objektivat e mbledhjes së të dhënave për matjen e sipërmarrjes nga perspektiva gjinore si dy grupe kryesore rezultatesh, pjesëmarrja sipërmarrëse dhe performanca sipërmarrëse, të ndara sipas gjinisë siç ilustrohet në Figurën 1.

<sup>42</sup> INSTAT. 2020. Statistikat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: OZhQ 5 – Barazia Gjinore.

<sup>43</sup> Grupi i Bankës Botërore. 2019. Anketat e Sipërmarrjes. Profili i Shqipërisë 2019. Uashington DC.

<sup>44</sup> OECD et al. 2019, Indeksi i Politikave të NVM-ve: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2022: Vlerësim i Zbatimit të Aktit të Biznesit të Vogël për Evropën, Indeksi i Politikave të NVM-ve, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/g2g9fa9a-en>.

<sup>45</sup> Organizata e Kombeve të Bashkuara, 2018. Matja e Sipërmarrjes nga Perspektiva Gjinore: Mësimet e Nxjerra nga Projekti EDGE

**“Faktorët përcaktues”, “rezultatet” dhe “impaktet” janë flukse të ndër-lidhura dhe të rëndësishme në formulimin dhe vlerësimin e masave politike.**

“Faktorët përcaktues” pasqyrojnë faktorët kyç që ndikojnë te sipërmarrja. “Rezultatet” pasqyrojnë treguesit që mund të përdoren nga politikëbërësit për të vlerësuar dhe monitoruar rezultatet e politikave të tyre. Ndërsa “Impaktet” pasqyrojnë kontributet në ekonomi. Ekspertët rekomanduan gjithashtu vlerësimin e mjedisit mundësues, duke përfshirë vlerësimin e ligjeve dhe/ose politikave ekzistuese që japin stimuj për gratë sipërmarrëse, gjatë përshtatjes së kuadrit EDGE me kontekstet specifike të vendeve.

Për sa i përket treguesve, ata janë përzgjedhur duke u bazuar në këndvështrimin se hendeqet gjinore vërehen në numrin e ulët të grave sipërmarrëse ose në madhësinë më të ulët të bizneseve në pronësi të grave. Prandaj, variablat kryesore të rezultateve përshkruajnë hendeqet gjinore në pjesëmarrjen dhe performancën sipërmarrëse. Faktorët përcaktues të hendeqeve gjinore janë kategorizuar në faktorë motivimi dhe aspirimi, si dhe disponueshmëria e pabarabartë nga ana gjinore e burimeve sipërmarrëse dhe kufizimeve, të tilla si aksesit në trajnim dhe kredi.


Në këtë kuadër, impaktet e mundshme të reduktimit të hendeqeve gjinore në sipërmarrje përfshijnë, jo në mënyrë shteruese, krijimin e vendeve të punës, mundësi më të mira punësimi për shtresat vulnerabël, sipërmarrësit mikro, rritjen ekonomike në mbështetje të të varfërve, fuqizimin e grave. Ndërlidhja e këtyre tre blloqeve është një karakteristikë kyçe e këtij kuadri konceptual, pasi shumë nga elementët e impaktit mund të shihen edhe si faktorë përcaktues dhe anasjelltas.

Edhe pse ka vështirësi në matjen e sipërmarrjes dhe analizimin e hendequt gjinor të saj, ekzistojnë prova se arsyt kryesore për pjesëmarrjen dhe performancën sipërmarrëse të pabarabartë nga ana gjinore e kanë bazën në politikat ekzistuese. Gratë përballen me një sërë pengesash në lidhje me pjesëmarrjen, të tilla si qasja në financim, rregulloret e biznesit të pafavorshme, barrierat kulturore, përqendrimi në lloje dhe sektorë të caktuar biznesi, hendeqet në informacion dhe trajnim, mungesa e qasjes në rrjete shoqërore dhe mbështetëse, segregacioni arsimor dhe profesional, normat sociale e kulturore në lidhje me pritshmëritë për rolin e gruas në familje si dhe paragjykimet për gratë në biznes<sup>46</sup>. Në nivel global, 5.3% e grave sipërmarrëse, krahasuar me 8% të burrave, marrin para hua për të filluar ose zgjeruar një fermë apo biznes<sup>47</sup>.

<sup>46</sup> Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE), 2016. Gjinia në Sipërmarrje.

<sup>47</sup> A. Demircuc-Kunt et al. 2018. Databaza Globale Findex 2017: Matja e Përfshirjes Financiare dhe Revolucionit të Teknologjisë Financiare. Uashington, D.C., Grupi i Bankës Botërore

Figura 1. Kuadri Konceptual për treguesit e sipërmarrjes



Burimi: OKB, 2018.

Ka prova të konsiderueshme që gratë janë ende të nënpërfaqësuar në mesin e sipërmarrësve në shumë vende<sup>48</sup>. Nënpërfaqësimi i grave në sipërmarrje është një fakt i evidentuar gjerësisht, edhe në vendet ku pjesëmarrja e grave në forcën punëtore ka qenë vazhdimisht në rritje. Ka disa të dhëna që mbështesin pikëpamjen se pjesëmarrja e grave në sipërmarrje është më e lartë në vendet me të ardhura të ulëta për frymë, e cila shpesh quhet «sipërmarrje nga nevoja», sepse gratë që fillojnë bizneset e tyre e konsiderojnë këtë si të vetmen mundësi për të siguruar jetesën. Nga ana tjetër, gratë në vende më të pasura kanë përqindje më të ulëta të pjesëmarrjes në sipërmarrje dhe kjo shpesh quhet «sipërmarrje e mundësive»<sup>49</sup>.

Përqindjet e sipërmarrjes **pritet gjithashtu të jenë më të larta tek gratë që njohin personalisht një sipërmarrës** dhe do të vepronin si model. Brenda bizneseve familjare, gratë shpesh luajnë një rol dytësor dhe në vendet ku tradita mbizotëron, kjo shoqërohet me përqindje më të ulëta pjesëmarrjeje. Vendet që **japin stimuj për pjesëmarrjen e grave në aktivitete sipërmarrëse shpesh kanë përqindje më të larta** të grave pronare vetëm në letër.

<sup>48</sup> OECD (2013). Perspektiva dhe Situata e Shkencës, Teknologjisë dhe Industrisë.

<sup>49</sup> Allen, I.E., Elam, N., Langowitz, N. dhe Dean, M. (2007), Raporti i Monitoruesit Global të Sipërmarrjes mbi Gratë dhe Sipërmarrjen, Babson College, Babson Park, MA dhe London Business School, Londër


## Karakteristikat e sipërmarrjeve të zotëruara/drejtuar nga gratë në Shqipëri

Situata në Shqipëri pasqyron pritshmëritë e projektuara në rishikimin e literaturës. Pjesëmarrja e grave në aktivitete sipërmarrëse zakonisht matet me përqindjen e bizneseve që zotërohen ose menaxhohen nga gratë. Instituti Shqiptar i Statistikave i prodhon këto statistika prej disa vitesh. Tabela 1 paraqet shifrat për periudhën 2013-2019.

Siç pritej, **numri i bizneseve të zotëruara/menaxhuara prej burrave është më i lartë**. Ai është rreth tre herë më i lartë se numri i bizneseve të zotëruara/menaxhuara nga gratë. Përqindja e bizneseve të zotëruara/menaxhuara nga gratë është luhatur gjatë kësaj periudhe dhe së fundmi ka shënuar një kurbë zbritëse, duke rënë nga kulmi prej 29.7% në 2017-ën, në 25.5% në 2020-ën.

Numri i përgjithshëm i bizneseve ka vetëm një luhatje të lehtë. Fakti që numri i bizneseve të regjistruara është rritur me më shumë se 14,000 që nga viti 2015, por numri i bizneseve të zotëruara/menaxhuara nga gratë ka mbetur në vend rreth shifrës 2,000, përforcon konstatimin se pjesëmarrja e grave në sipërmarrje ka përjetuar një amulli vitet e fundit.

Figura 2. Sipërmarrjet aktive sipas gjinisë së pronarit/administratorit, 2016-2021



Burimi: INSTAT, 2022


Hulumtimet mbi shkaqet rrënjësore të kësaj amullie janë të pakëta dhe nuk është bërë publik asnjë studim bazë i strukturuar apo monitorim dhe vlerësim, siç parashikohet në dokumentet kryesore të politikave<sup>50</sup>.

Siç argumentohet në shumicën e studimeve në këtë fushë, klasifikimi i sipërmarrësve sipas gjinisë, madhësisë së firmës dhe aktiviteteve sipërmarrëse është i dobishëm, sepse ka dallime midis strukturave të bizneseve në pronësi të grave dhe atyre të burrave.

**Bizneset në pronësi të grave piren të jenë më të vogla në madhësi sesa ato të burrave.** Madhësia e firmës zakonisht përcaktohet nga numri mesatar i punonjësve gjatë një viti. Shifrat në tabelën e mëposhtme tregojnë se gjatë viteve 2013-2021 gratë pronare/menaxhere janë të përqendruara në ndërmarrje mikro me 1 – 4 punonjës.

Mesatarisht, gratë zotëronin/menaxhonin 28.4% të këtyre firmave për periudhën gjashtëvjeçare. Shifra më e lartë është shënuar në vitin 2015 me 32.7%, ndërsa në vitin 2017 shifrat janë ulur për firmat mikro. Në dy vitet e fundit, rënia në përqindjen e firmave mikro të zotëruara/menaxhuara nga gra është shoqëruar me një rritje të bizneseve më të mëdha.

*Figura 3. Analizë e sipërmarrjeve aktive me pronare/administratore gra sipas madhësisë së firmës*



Burimi: INSTAT, 2022

Shifrat për vitin 2021 nuk janë të ndryshme nga ato që u diskutuan. Gratë pronare/administratore përbëjnë rreth 22,78% të bizneseve me 10-49 punonjës dhe 23,69% të bizneseve me më shumë se 50 punonjës. Pavarësisht paqëndrueshmërisë së serisë në përgjithësi, duket se rritja në dy përqindjet e fundit është pasojë e një tendence të qartë e të vazhdueshme rritëse të bizneseve të zotëruara/menaxhuara nga gratë midis bizneseve më të mëdha gjatë periudhës në shqyrtim.

<sup>50</sup> Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim. (Topi E.). 2021. Ri-lançimi i Sipërmarrjes së Grave në Shqipëri – Vlerësim i Shpejtë i Zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Sipërmarrjen e Grave. Tiranë. Shqipëri

Ekzistojnë prova se jo vetëm që bizneset e zotëruara/menaxhuara nga gratë janë më të vogla se bizneset në pronësi të burrave, por ato gjithashtu kanë **më shumë gjasa të përqendrohen në sektorë të caktuar, zakonisht në sektorët me më pak kapital** dhe në sektorët ku kushton më pak të hysh, të tillë si shitja dhe tregtia me pakicë.

Një shpjegim i mundshëm për madhësinë më të ulët të biznesit është aksesimi i kufizuar në kapital dhe nivelet më të ulëta të kapitalit ekzistues (financiar dhe fizik). Një formë informaliteti pritet gjithashtu të jetë më e lartë se në bizneset e drejtuara nga burrat. Ndërkohë që nuk ka të dhëna për informalitetin në tregun shqiptar, të dhënat e paraqitura më poshtë tregojnë disa statistika të rëndësishme që lidhen me aktivitetin ekonomik të bizneseve të zotëruara/menaxhuara nga gratë.

Numri i grave pronare/menaxhere (ose administratore) është më i lartë në Sektorin e Shërbimeve sesa në Sektorin e Prodhimit, përkatësisht 33.7% dhe 12.6%. Shifrat në tabelë konfirmojnë gjithashtu se tregtia është një nga sektorët në të cilin është përqendruar një pjesë e madhe e bizneseve në pronësi/menaxhim të grave. Përqindja ka rënë nga 39.2% në 2017 në 34.8% në 2019; është rritur shumë pak në vitin 2020, duke arritur në 35 për qind.


*Tabela 1. Sipërmarrjet aktive sipas gjinisë së pronarit/administratorit dhe veprimtarisë ekonomike, në (%)*

Viti	2017		2018		2019		2020	
	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra
<b>Totali</b>	<b>70.3</b>	<b>29.7</b>	<b>74.3</b>	<b>25.7</b>	<b>74.6</b>	<b>25.4</b>	<b>74.5</b>	<b>12.6</b>
<b>Prodhues të mirash</b>	<b>83.9</b>	<b>16.1</b>	<b>88.2</b>	<b>11.8</b>	<b>88.1</b>	<b>11.9</b>	<b>87.4</b>	<b>12.6</b>
<i>Bujqësi, pylltari dhe peshkim</i>	86.1	13.9	89.9	10.1	89.4	10.6	82.3	17.7
<i>Industri</i>	75.2	24.8	80.4	19.6	80.8	19.2	79.4	20.6
<i>Ndërtim</i>	86.4	13.6	90.4	9.6	90.2	9.8	90.2	9.8
<b>Prodhues shërbimesh</b>	<b>63.7</b>	<b>36.3</b>	<b>66.8</b>	<b>33.2</b>	<b>66.7</b>	<b>33.3</b>	<b>66.3</b>	<b>33.7</b>
<i>Tregti</i>	60.8	39.2	64.6	35.4	65.2	34.8	65.0	35.0
<i>Transport dhe magazinim</i>	89.5	10.5	94.5	5.5	94.2	5.8	93.4	6.6
<i>Akomodim dhe shërbim ushqimesh</i>	68.7	31.3	71.7	28.3	71.2	28.8	71.0	29.0
<i>Informacion dhe komunikim</i>	74.1	25.9	77.3	22.7	75.8	24.2	75.1	24.9
<i>Shërbime të tjera</i>	58.6	41.4	60.8	39.2	60.2	39.8	59.4	40.6

Burimi: Regjistrat e Biznesit, INSTAT, 2022

Në përgjithësi, bizneset e zotëruara/menaxhuara nga gratë janë më të përqendruara në sektorët e shërbimeve. Edhe shërbimet ushqimore dhe ambientet e akomodimit përbëjnë një sektor të rëndësishëm, pesha e të cilit është e konsiderueshme me rreth 29% në dy vitet e fundit. Është interesante se një pjesë e madhe e bizneseve në sektorin e Informacionit dhe Komunikimit zotërohen/menaxhohen nga gra (rreth një e katërta e tyre).


Figura 4. Sipërmarrjet aktive sipas gjinisë së pronarit/administratorit dhe veprimtarisë ekonomike (%), 2021<sup>51</sup>



Burimi: Regjistrat e Biznesit, INSTAT, 2022

Struktura sektoriale e pranisë së grave në sipërmarrje ndryshon pak në afat kohor të shkurtër. E njëjta gjë është evidentuar për periudha të mëparshme në studime të tjera si Bezhani (2015)<sup>52</sup>. Të dhënat tregojnë se tendencat e sipërmarrjes së grave ndikohen nga zhvillimet e përgjithshme të botës së biznesit, pasi brenda një periudhe 20-vjeçare, sipërmarrja e grave është zhvendosur paksa në drejtim të tregtisë, shërbimeve, industrisë dhe agrobiznesit,<sup>53</sup> si dhe drejt informacionit e komunikimit dhe shërbimeve të tjera.

Figura 5. Format ligjore të bizneseve të drejtuara nga gratë (%), 2016-2021



Burimi: Regjistrat e Biznesit, INSTAT, 2022

<sup>51</sup> Këto të dhëna nuk përfshijnë të dhënat për fermerët.

<sup>52</sup> Gratë Sipërmarrëse në Shqipëri, Bezhani. M. Gjenezë, Organizata Ndërkombëtare e Punës, 2001

<sup>53</sup> Ibid.

Bizneset në pronësi të grave gjithashtu janë të organizuara me status të ndryshëm pronësie në krahasim me bizneset në pronësi të burrave. Ato kanë më shumë gjasa t'i regjistrojnë bizneset e tyre si biznese me një pronar të vetëm dhe jo si korporata. Të dhënat e mbështesin qartë një pohim të tillë.

**Në 6 vitet e fundit, 3 nga 4 biznese të drejtuara nga gra janë regjistruar si person fizik.** Ka një tendencë në rënie të fenomenit, nga 81,5% në vitin 2016, në 68,9% në vitin 2021, me një diferencë prej 12,6 pikë përqindjeje.

Instituti i Statistikave **nuk ka një dritare të dedikuar për sipërmarrjen e grave**, apo të dhëna publike që do të lejonin një profilizim të popullsisë së grave sipërmarrëse në Shqipëri. Ky fakt përbën një kufizim për këtë studim dhe për studime të tjera të kryera. Një raport me ndjeshmëri gjinore i fokusuar në sipërmarrjen ose një raport më specifik mbi sipërmarrjen e grave dhe karakteristikat e tyre demografike, arsimore ose profesionale, do t'u shërbente politikëbërësve dhe studiuesve.

### **Faktorët nxitës dhe pengesat me të cilat përballen sipërmarrjet e zotëruara/menaxhuara nga gratë**

Pavarësisht se “gratë në sipërmarrje” janë një fill i ri në literaturën e barazisë gjinore, ka disa studime që janë kryer duke u fokusuar në aspekte të ndryshme të gjinisë në sipërmarrje dhe në dallimet midis vendeve. Pothuajse të gjitha studimet në terren përdorin pyetësorët si mjete për mbledhjen e të dhënave.

UNCTAD (2014)<sup>54</sup> ka kryer një sondazh mbi faktorët nxitës dhe pengesat ndaj sipërmarrjes dhe inovacionit nga perspektiva gjinore, si në ekonomitë e zhvilluara ashtu edhe në ato në zhvillim, për të parë nëse zhvillimi ekonomik lidhet me dallimet në faktorët nxitës dhe pengesat. Përveç kësaj, studimi kishte për qëllim të analizonte variacionin gjinor në pengesat ndaj sipërmarrjes dhe inovacionit dhe të ofronte rekomandime për inovacion më të lartë në ndërmarrjet e zotëruara nga gratë. Të dhënat për studimin u mbledhën përmes një kampioni prej 456 sipërmarrësish meshkuj dhe femra në Brazil, Jordani dhe Ugandë (vendet në zhvillim) dhe Suedi, Zvicër, Shtetet e Bashkuara (vendet e zhvilluara).

Përfundimet u grupuan në tre tema kryesore: motivimet sipërmarrëse dhe faktorët nxitës të inovacionit, praktikat inovative dhe pengesat ndaj inovacionit. Rezultatet tregojnë se ekzistojnë dallime të rëndësishme gjinore në faktorët nxitës të sipërmarrjes dhe inovacionit, në motivimet sipërmarrëse dhe motivimet e inovacionit. Dallime të konsiderueshme u gjetën edhe në strukturat menaxhuese, ku bizneset në pronësi të grave ishin më të prirura për kohezion dhe bashkëpunim në menaxhim. Megjithatë, nuk u gjetën prova për

<sup>54</sup> UNCTAD, 2014. Një sondazh mbi sipërmarrjen e grave dhe inovacionin.



qasjen ndaj inovacionit, megjithëse gratë sipërmarrëse priren t'i përqendrojnë përpjekjet e tyre për inovacion më shumë në organizimin e biznesit sesa në produkte dhe procese.

Në vende si Egjipti, Mjanmari apo Moldavia, Organizata Ndërkombëtare e Punës dhe studiues të tjerë kanë kryer vlerësime kornizë mbi mjedisin që mbështet ose pengon Zhvillimin e Sipërmarrjes së Grave (ZhSG). Qëllimi i këtij vlerësimi ishte të identifikonte mangësitë kryesore në gjashtë kushte kornizë që ndikojnë në shfaqjen e grave sipërmarrëse dhe në aftësinë e sipërmarrjeve ekzistuese të zotëruara nga gratë (SZG) për të aksesuar burimet dhe mbështetjen e nevojshme për qëndrueshmëri dhe rritje mbi bazën e mundësive të barabarta.

Këto kushte kornizë përfshijnë:

1. Një sistem ligjor dhe rregullator me ndjeshmëri gjinore i cili çon përpara fuqizimin ekonomik të grave
2. Udhëheqje dhe koordinim efektiv i politikave për promovimin e ZhSG
3. Qasja në shërbime financiare me ndjeshmëri gjinore
4. Qasja në shërbime të mbështetjes për zhvillimin e biznesit (MZhB), të cilat të kenë ndjeshmëri gjinore
5. Qasja në tregje dhe teknologji
6. Përfaqësimi i grave sipërmarrëse dhe pjesëmarrja në dialogun për politikatat

Egjipti e kreu vlerësimin ZhSG në 2016-ën<sup>55</sup>, duke arritur në përfundimin se bizneset në pronësi të grave janë kryesisht **të madhësisë mikro dhe kanë shumë gjasa të operojnë në sektorin informal**. Ndonëse ka një ndërgjegjësim në rritje për përfitimet që sjellin gratë si pronare biznesi për ekonominë e Egjiptit, nuk ekziston asnjë kuadër strategjik kombëtar për zhvillimin e sipërmarrjes së grave. Rezultatet e ZhSG tregojnë se 200 gra sipërmarrëse kanë krijuar 2796 vende pune. Sa i përket gjashtë kushteve kornizë të ZhSG, Egjipti vlerësohet si më i fortë në sistemin ligjor të ndjeshëm ndaj gjinisë dhe në shërbimet MZhB me ndjeshmëri gjinore. Sfidat kryesore vërehen në fushat që lidhen me udhëheqjen efektive të politikave për ZhSG, aksesin në financim, aksesin në tregje dhe teknologji, si dhe pjesëmarrjen e grave sipërmarrëse në dialogun për politikatat. Mjanmari pati një performancë të ngjashme me Egjiptin<sup>56</sup>.

ILO (2020)<sup>57</sup> ka publikuar një hulumtim mbi sfidat kryesore me të cilat janë përballur bizneset e zotëruara/menaxhuara nga gratë në Egjipt gjatë

<sup>55</sup> ILO (2016). Vlerësimi i Zhvillimit të Sipërmarrjes së Grave. Egjipt

<sup>56</sup> ILO. 2020. Vlerësimi i Zhvillimit të Sipërmarrjes së Grave. Mjanmar

<sup>57</sup> ILO. 2020. Sondazh mbi Gratë që Drejtojnë Biznese Mikro, të Vogla dhe të Mesme lidhur me Sfidat Kryesore që Hasin si Rezultat i Krizës së Koronavirusit

pandemisë të koronavirusit. Për të arritur objektivat e studimit u hartua një pyetësor i përbërë nga 26 pyetje. Nga anketa online u mbledhën 440 përgjigje, shumica e të cilave ishin të përqendruara në kryeqytet dhe 91% e të cilave u përkisnin ndërmarrjeve mikro (më pak se 10 punëtorë).

Rezultatet e anketës treguan se rreth 79% e NMVM-ve pjesëmarrëse në pronësi të grave kishin përjetuar një ndikim negativ në bizneset e tyre, duke përfshirë mbylljen e plotë, rënien e të ardhurave, heqjen nga puna të punonjësve dhe pamundësinë për të paguar rrogat. Biznese të tjera ulën çmimet e shërbimeve dhe produkteve, si dhe rinegociuan kontratat ekzistuese për të siguruar mbijetesën.

Shumica e pjesëmarrësve theksuan nevojën për mbështetje nga qeveria dhe subjektet e tjera mbështetëse, duke përfshirë mbështetjen për marketingun/promovimin (68%) dhe mbështetjen financiare (67%), si dhe në veçanti trajnime për marketingun elektronik, trajnime për menaxhimin e krizave financiare (42%), trajnime dhe mbështetje në lidhje me tregtinë elektronike (37%), zhvillimin e produkteve/shërbimeve të reja (36%), mentorim dhe trajnim (36%), kredi të reja dhe shtyrje e pagesës së kësteve (12%). Studimi gjithashtu arrin në përfundimin se praktikrat e biznesit që synohen të përdoren në të ardhmen janë të ndryshme nga modeli operacional i bizneseve aktuale.

Një studim nga Chakava et al (2017)<sup>58</sup> synoi të përcaktonte barrierat që i pengojnë bizneset e drejtuara nga gratë të rriten nga mikro dhe të vogla në të mesme dhe të mëdha. Studimi gjithashtu mbledh informacion mbi burimet e kapitalit të përdorur nga gratë për të filluar dhe rritur bizneset e tyre, sfidat e ardhshme dhe mbështetjen e nevojshme për të kapërcyer këto pengesa. Sondazhi u krye në internet dhe rezultatet u nxorën duke përdorur 664 pjesëmarrës nga Afrika Lindore.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se gratë sipërmarrëse janë të reja e të mirë-arsimuara dhe se rreth 71% e tyre e kanë filluar biznesin duke përdorur kursimet e veta, me shumica modeste nga 1000 deri në 5000 dollarë amerikanë. Aksesi në financim mund të mos konsiderohet i kufizuar, por shpesh mendojnë se nuk i plotësojnë kërkesat e bankave, ose për shkak të paparashikueshmërisë së flukseve monetare të biznesit. Siç pritej, bizneset e grave janë të vogla, por megjithatë janë fitimprurëse. Ndryshe nga pritshmëritë, bizneset e tyre operojnë në sektorë të ndryshëm dhe u shërbejnë më shumë sesa thjesht tregjeve lokale. Potenciali i rritjes u vlerësua si veçanërisht i lartë, në shifrën 91%.

<sup>58</sup> Chakava, A. L., Mworira, M., Moshe, M., Mbinya, J., Magaga, S., Gachoki, L., 2017. Sondazh për të eksploruar barrierat ndaj rritjes me të cilat përballen sipërmarrëset femra në Afrikën Lindore, Rrjeti i Trustit Graça Machel.

Një gjetje interesante e studimit është se 48% e grave sipërmarrëse ofrojnë produkte dhe shërbime të synuara për gra, dhe e njëjta përqindje krijon produkte dhe shërbime për një bazë klientësh që përmban mbi 50% gra. Më shumë se gjysma e firmave punësonin të paktën 50% gra. Këto shifra përforcojnë pritshmëritë e formuluar në fillim të këtij seksioni për potencialin e lartë që kanë bizneset e zotëruara nga gratë lidhur me uljen e varfërisë dhe fuqizimin ekonomik të grave.

Ramadani (2015) kreu një studim për të kuptuar më mirë motivet, problemet dhe perspektivat aktuale të grave shqiptare në sipërmarrje, duke përfshirë një sondazh të zhvilluar në periudhën maj-qershor 2014 për të plotësuar burimet dytësore. Të anketuarat u pyetën për motivet që i kishin shtyrë të fillonin një biznes, madhësinë e biznesit që drejtonin, të ardhurat, statusin e tyre familjar, problemet e menaxhimit dhe aftësitë e nevojshme siç perceptohen prej tyre.


Rezultatet tregojnë se një grua sipërmarrëse tipike në Shqipëri ka arsim universitar, menaxhon një sipërmarrje mikro, është nën moshën 30 vjeç dhe vazhdon të jetë e pranishme në botën e biznesit për 10-15 vjet. Arsyet për krijimin dhe mbajtjen e një biznesi fokusohen në fitimin e konsiderueshëm, dëshirën për të punuar ekskluzivisht për llogari të vetes dhe synimin për të pasur arritje të rëndësishme në karrierë. Këto gra janë normalisht të martuara, kanë një ose më shumë fëmijë; megjithatë ato i kushtojnë një pjesë të konsiderueshme të kohës së tyre punës (më shumë se 10 orë në ditë).

Ndër barrierat dhe sfidat ndaj rritjes dy-shifrore të biznesit, më shumë se gjysma e të anketuarave renditën aksesin në financim dhe aksesin në tregje, ku arsyet kryesore ishin kërkesat e kolateralit dhe normat e larta të interesit. Gratë sipërmarrëse përballen me barriera në marrjen e kredive me norma interesi të drejta, duke rritur kështu rrezikun e falimentimit për firmat e drejtuara nga gratë<sup>59</sup>. Qasja në financim, marketingu dhe qasja në tregje konsiderohen si barrierat kryesore ndaj rritjes së biznesit. Mbështetja jofinanciare rezulton gjithashtu e kufizuar pasi rreth dy të tretat e pronareve të bizneseve nuk kanë një mentor të industrisë së biznesit apo një bord drejtorësh/këshilltarësh. Pjesëmarrja në trajnime është gjithashtu një pengesë për rritjen dhe shumica e grave e marrin informacionin nëpërmjet internetit. Rrjetet dhe organizatat e grave, qofshin ato zyrtare apo jozyrtare, janë burim mbështetjeje për më shumë se gjysmën e të anketuarave, duke përfshirë mbështetjen financiare<sup>60</sup>.

<sup>59</sup> R.M. Prasad. 2009. "Pengesat e Kredive: A Diskriminojnë Bankat ndaj Grave Sipërmarrëse?", në *Akademia e Perspektivave të Menaxhimit* (2009, Vol. 23, Nr. 4, Nëntor), fq. 91–93; dhe N. Wellalage and S. Locke: "Qasja në kredi nga NVM-të në Azinë Jugore: a përballen gratë sipërmarrëse me diskriminim?". në Organizata Ndërkombëtare e Punës. 2020. Dokument Politikash. Përgjigjja ndaj COVID-19: Të kuptojmë saktë barazinë gjinore për një të ardhme më të mirë për gratë në punë. Maj 2020

<sup>60</sup> INSTAT. 2021. Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2021. Tiranë. Shqipëri

Figura 6. Përqindja e grave depozituese, kredimarrëse, dhe e llogarive të tyre në bankat tregtare




Burimi: INSTAT, 2021 dhe llogaritjet e autores

Në Shqipëri, qasja në financim në shifra duket se është pothuajse e barabartë mes burrave dhe grave. Të dhënat e kohëve të fundit mbi numrin e depozituesve, kredimarrësve, llogarive të depozitave dhe atyre të kredive, pasqyrojnë dallime të vogla midis burrave dhe grave gjatë periudhës 2016-2020. Në vitin 2020, numri i kredimarrësve në bankat e nivelit të dytë ishte 338,871, nga të cilët 56,8 % ishin burra dhe 43,2 % gra. Gjatë periudhës 2017-2020, numri i grave kredimarrëse, edhe pse më i ulët se ai i burrave, është rritur. Numri i depozituesve në bankat tregtare në vitin 2020 ishte 2,512,365, nga të cilët 56,5 % janë burra dhe 43,5 % janë gra.

Në vitin 2019, përqindja e grave përfituese të skemave të mbështetjes të ofruara nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve zbriti nga 46,0% në 43,6%. Në Fondin e Ekonomisë Kreative dhe Fondin për Start-Ups, përqindja e grave që përfitojnë nga skemat mbështetëse është më e lartë sesa e burrave, përkatësisht 80,0% dhe 78,9%. Gjatë vitit të pandemisë, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve nuk ka aplikuar investime apo skema mbështetëse.

**Tre industritë kryesore të sipërmarrjeve të drejtuara nga gra që përfitojnë nga skema e mbështetjes janë artizanati (54%), industria ushqimore (15.3%) dhe industria tekstile (11.7%).**

Figura 7. Gratë përfituese të Skemave të Granteve të AIDA sipas sektorit 2014-2019



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2020

Aleanca për Përfshirjen Financiare (AFI) (2017)<sup>61</sup> kreu një sondazh me gra sipërmarrëse në institucionet anëtare të Grupit të Punës për Financimin e NVM-ve, me qëllimin për të zbuluar nëse politikat dhe rregulloret aktuale promovojnë aksesin në financim për NMVM-të në pronësi të grave dhe për gratë sipërmarrëse, si dhe për të parë nëse në vendet pjesëmarrëse mbledhen statistika të ndara sipas gjinisë. Në sondazh morën pjesë një numër vendesh anëtare si Bangladeshi, Kosta Rika, Tonga, Fixhi, Gana, Taxhikistani, Indonezia, Meksika, Palestina dhe Samoa. Zbatimi i projektit dhe në veçanti procesi i mbledhjes së të dhënave në vendet e ndryshme u përball me disa vështirësi një pjesë e të cilave ishin parashikuar. Këto lidheshin kryesisht me mungesën e përkufizimeve për konceptet ose me përdorimin e përkufizimeve të ndryshme në vende të ndryshme. Edhe në vendet ku kishte përkufizime të qarta, të anketuarit hasën vështirësi në dhënien e përgjigjeve për pyetje të caktuara dhe në dhënien e statistikave, sidomos në raportimin e statistikave të ndara sipas gjinisë. **Ky problem nxjerr në pah nevojën për krijimin e një grupi të përbashkët treguesish dhe përkufizimesh në këtë fushë, që do të mundësonte krahasime midis vendeve të ndryshme.**

Në sondazh, dhjetë vende deklaruan se kishin financime specifike nga qeveria për NMVM-të në përgjithësi, por vetëm Bangladeshi, Kosta Rika, Gana, Indonezia, Meksika dhe Tonga raportuan se kishin ndërhyrje specifike financimi për NMVM-të në pronësi të grave dhe për gratë sipërmarrëse. Gjetje të tjera treguan se **mungesa e kolateralit të grave sipërmarrëse është sfida më e madhe për rritjen e aksesit në financim**, ndjekur nga **njohuritë financiare, mjedisi**

<sup>61</sup> AFI, 2017. Raport i sondazhit mbi politikat e financimit të NVM-ve për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në pronësi të grave dhe për gratë sipërmarrëse.

**socio-kulturor dhe mungesa e produkteve financiare të personalizuar ose pikave të aksesit.** Gjetjet konfirmuan gjithashtu se punësimi i grave është i përqendruar në sektorin informal, me katër vende që raportuan një përqindje më të lartë të grave të punësuar në sektorin informal sesa në sektorin formal. Gjetjet varionin sipas vendeve, por në përgjithësi mund të konkludohet se vetëm një numër i vogël vendesh e kishin bërë prioritet aksesin në financim për NMVM-të në pronësi të grave dhe për gratë sipërmarrëse, duke e përfshirë atë në strategjitë e tyre kombëtare të përfshirjes financiare apo në strategji të tjera kombëtare specifike për NMVM-të.

Aliyeva dhe Zeynalova (2016)<sup>62</sup> kryen një studim në Azerbajxhan me qëllimin për të identifikuar situatën dhe tendencat e grave sipërmarrëse, sfidat dhe shqetësimet e tyre, për të shqyrtuar legjislacionin aktual në lidhje me biznesin e vogël, për të vlerësuar rolin e organizatave mbështetëse që ndihmojnë gratë sipërmarrëse, si dhe për të shqyrtuar pjesëmarrjen e grave në biznes dhe në organizatat qytetare. Gruaja sipërmarrëse tipike në këtë studim është **e moshës së mesme ose më e madhe, e martuar dhe me fëmijë të rritur, si dhe e arsimuar më mirë se popullata e përgjithshme e grave.** Shumica e tyre flasin dy gjuhë ose tre gjuhë, kanë aftësi dixhitale dhe njëfarë eksperience pune, megjithëse kjo e fundit nuk ka lidhje me biznesin që drejtojnë. Ato kanë arsye të ndryshme pse e kanë filluar biznesin dhe familjet e tyre janë mjaft mbështetëse; punësojnë mesatarisht 5 anëtarë stafi të përhershëm me kohë të plotë, kryesisht gra. Gjetjet konfirmojnë pritshmërinë që bizneset e drejtuara nga gratë kanë më shumë gjasa të operojnë në sektorin informal. **Mungesa e kolateralit, mungesa e kapitalit fillestar,** normat e larta të interesit për kredi dhe kompleksiteti i procedurave të kredive janë **barrierat kryesore** ndaj zgjerimit të biznesit. Trajnime kishin bërë vetëm një e treta e pronareve të bizneseve, megjithëse nevoja për trajnime është e lartë, veçanërisht në çështjet tatimore, ligjore dhe të dokumentacionit. Barrierat kryesore të raportuara janë konkurrenca e pandershme dhe vështirësia për të tërhequr klientë të rinj, megjithëse rolet gjinore, zakonet dhe traditat e kufizojnë rritjen e tyre duke paraqitur një pengesë në ndërveprimin me burrat në drejtimin e biznesit.

Hulumtimet mbi dimensionin gjinor të sipërmarrjes në vendet e Ballkanit Perëndimor janë të pakta. Në vitin 2017, Riinvest publikoi një analizë mbi sipërmarrjen e grave në Kosovë<sup>63</sup>, me qëllim që të vlerësonte bizneset në pronësi të grave në Kosovë nga perspektiva e karakteristikave të biznesit, performancës, barrierave ndaj bërjes së biznesit, financimit, çështjeve socio-

<sup>62</sup> Aliyeva, Y., dhe Zeynalova, B., 2016. Vlerësim i politikave për sipërmarrjen e grave dhe sondazh mbi gratë sipërmarrëse.

<sup>63</sup> Riinvest, 2017. Sipërmarrja e grave. Një analizë mbi të bërit biznes në Kosovë. [https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2017/November/10/Womens\\_Entrepreneurship1510307815.pdf](https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2017/November/10/Womens_Entrepreneurship1510307815.pdf)

ekonomike dhe mundësive për rritje të grave sipërmarrëse. Në sondazh morën pjesë 313 gra sipërmarrëse të përzgjedhura në mënyrë rastësore dhe të shtresuara sipas komunave dhe sektorëve të ekonomisë.

Gjetjet tregojnë se bizneset e zotëruara/menaxhuara nga gratë kanë një qarkullim relativisht të ulët, janë të përqendruara në sektorë me vlerë të shtuar të ulët dhe punësojnë një numër të vogël punëtorësh. Megjithatë, shumica e grave e kanë filluar vetë biznesin e tyre, duke u mbështetur në kapitalin e vet, të motivuara kryesisht nga të ardhurat që do t'u sillte një sipërmarrje e tillë dhe pavarësisht sfidave që hasin, ato tregojnë vendosmëri në avancimin e biznesit të tyre. Gratë investojnë pothuajse dy herë më shumë se burrat në kapital njerëzor dhe përdorin më shumë kriteret standarde kur punësojnë staf, të tilla si përvoja e punës dhe aftësitë, megjithëse kanë qëndrime të ngjashme me burrat sipërmarrës ndaj mjedisit institucional. Gratë i konsiderojnë me intensitet më të ulët të gjitha barrierat. Taksat dhe tregjet e vogla konsiderohen si barriera kryesore, ndërsa korrupsioni renditet si një nga barrierat më të ulëta të konsideruara në sondazh.

Deloitte Albania ka kryer një sondazh me drejtues biznesesh në Shqipëri duke u fokusuar te roli i grave në udhëheqje, si dhe sfidat me të cilat përballen ato. 500 kompanitë më të mëdha ndërkombëtare dhe vendase që operojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë në Shqipëri u ftuan të merrnin pjesë në sondazh, me synimin për të hetuar barrierat që gratë duhet të kapërcejnë në mjedisin e biznesit për të arritur funksione më të larta në shkallën hierarkike. Në sondazh morën pjesë 207 persona të nivelit drejtues. Anketimi u krye në dy faza; e para ishte një pyetësor online dhe e dyta fokusohej në intervista individuale me përfaqësues të bizneseve. 59.6% e të anketuarve të fazës së parë ishin gra dhe 40.4% ishin burra.

Studimi arrin në përfundimin se rreth **66,4 % e të anketuarve i perceptojnë gratë në pozicione drejtuese në biznesin e tyre si shumë profesionale**, 40 % besojnë se gratë kanë aftësi të mira analitike, 40,5 % e perceptojnë ndershmërinë si karakteristikë kryesore. Ato marrin më pak pikë në fushën e vendimmarrjes (13,6 %) vetëbesimit (23,6 %) dhe aftësive të planifikimit strategjik (20,2 %). Vetëm një e treta e të anketuarve mendojnë se gratë kanë aftësi udhëheqëse. Gjetjet tregojnë gjithashtu se **gratë investojnë më shumë në njohuri dhe ekspertizë profesionale (47%), performancë profesionale (36%) dhe janë më të afta në ruajtjen e një ekuilibri punë-jetë (62%)**. Për më tepër, 47% e të anketuarve mendojnë se burrat kanë një përgjigje më efektive ndaj sfidave të biznesit, si vendimmarrja nën stres (46%) dhe lufta për pozicionin e kompanisë në kushte konkurruese (41%). Megjithatë, vërehet një hendek i ulët sa i përket shitjeve, fitimit dhe zbatimit të zhvillimit strategjik. Për sa i përket nevojës për ndryshime legislative për pjesëmarrjen e grave në

biznes, të anketuarit sugjeruan futjen e një rregulloreje të ngjashme me atë të disa vendeve të Evropës Perëndimore që vendosin kuota për pjesëmarrjen e grave në bordet e kompanive. Këto ndryshime pritet t'u shërbejnë bizneseve dhe shoqërisë duke rritur diversitetin dhe kontributin nga të dyja gjinitë bazuar në talent dhe meritokraci<sup>64</sup>.

Në përgjithësi, sa i përket faktorëve të përdorur për vlerësimin e sipërmarrjes së grave, mund të konkludohet se faktorët kryesorë të konsideruar janë **motivimi, arsimimi dhe aftësitë, një mjedis mbështetës biznesi, duke përfshirë aksesin në financim, zgjidhjet për zhvillimin e biznesit, informacionin, teknologjinë, tregjet**. Gratë përballen me një mori sfidash kur fillojnë dhe drejtojnë një biznes. Këto sfida janë veçanërisht të theksuara në vendet ku rritja ekonomike është e ngadaltë dhe jo plotësisht përfshirëse dhe ku mjedisi i biznesit është i pafavorshëm, si dhe në vendet me qëndrime të forta shoqërore dhe paragjykime ndaj roleve gjinore.

---

<sup>64</sup> Deloitte. 2014. SheXO: Gratë në Biznes – Duke Fituar Pushtet. Tiranë. Shqipëri



# Kuadri i Kushteve për Barazinë Gjinore dhe Sipërmarrjen e Grave

Ky kapitull paraqet një rishikim të kuadrit ekzistues në shoqërinë shqiptare për sa i përket kuadrit normativ, politik dhe institucional që mundëson ose dekurajon sipërmarrjen e grave në Shqipëri. Fillimisht ai përmbledh dhe prezanton kuadrin kyç legjislativ dhe rregullator për barazinë gjinore dhe sipërmarrjen. Më pas vijon me një analizë të dokumenteve kyçe strategjike të përdorura aktualisht në vend dhe mbyllet me rishikimin e kuadrit institucional.

## Rishikim i Ligjeve mbi të Drejtat dhe Fuqizimin Ekonomik të Grave në Shqipëri

### Kushtetuta e Shqipërisë

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë prezanton parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit për burrat dhe gratë në vend.

“Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”<sup>65</sup>.

Kushtetuta u siguron grave të drejtën e mbrojtjes së veçantë kur janë shtatzëna ose nëna të reja<sup>66</sup>. Një kuadër kushtetues dhe ligjor që garanton të drejtat e njeriut dhe mundësi të barabarta ekonomike ofron një bazë të shëndoshë për ngritjen e aktiviteteve ekonomike dhe sipërmarrëse, nga gratë ose burrat.

### Kuadri Ndërkombëtar

Shqipëria ka ratifikuar ose nënshkruar disa konventa dhe deklarata në mbështetje të të drejtave të grave, ndër të cilat disa nga më të rëndësishmet janë: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit dhe protokollit i saj shtesë.

<sup>65</sup> Neni 18 i Kushtetutës së Shqipërisë

<sup>66</sup> Neni 54 i Kushtetutës së Shqipërisë

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në vitin 1996<sup>67</sup> dhe është pjesë thelbësore e legjisllacionit shqiptar, duke përfshirë parimet e saj kyçe që të drejtat e përcaktuara me ligj të sigurohen pa diskriminim mbi asnjë bazë, përfshirë gjininë.

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave përcakton se diskriminimi ndaj grave shkel parimet e të drejtave të barabarta dhe respektimit të dinjitetit njerëzor, pengon pjesëmarrjen e grave, në njëjtat kushte si burrat, në jetën politike, sociale, ekonomike dhe kulturore të vendit të tyre. Konventa është ratifikuar në vitin 1993<sup>68</sup> dhe protokollin e saj shtesë në vitin 2003<sup>69</sup>. Gjithashtu, Konventa deklaron se diskriminimi ndaj grave pengon përmirësimin e mirëqenies së shoqërisë dhe familjes dhe e bën më të vështirë zhvillimin e potencialit të grave në shërbim të vendeve të tyre dhe njerëzimit.

Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit është një axhendë që synon të fuqizojë gratë dhe të përshpejtojë zbatimin e Strategjive të Ardhshme të Nairobiit për Avancimin e Grave<sup>70</sup>. Platforma për Veprim është një instrument për të mundësuar pjesëmarrjen aktive të grave në të gjithë jetën publike dhe private, përmes një ndarjeje të plotë dhe të barabartë të vendimmarrjes ekonomike, sociale, kulturore dhe politike. Një veprim strategjik kyç është rritja e aksesit të grave të disavantazuara nga zonat rurale, të largëta dhe urbane, në shërbimet financiare duke forcuar lidhjet midis bankave zyrtare dhe organizatave ndërmjetëse kreditore, duke përfshirë mbështetjen legjisllative, trajnimet për gratë dhe fuqizimin institucional të institucioneve ndërmjetëse në mënyrë që të mobilizohet kapitali për këto institucione dhe të rritet sasia e kredive në dispozicion të grave. Literatura e njeh aksesin në financim si një nga mundësuesit kyç të sipërmarrjes për gratë, kështu që mbështetja për këtë veprim kontribuon direkt në sipërmarrjen e grave dhe fuqizimin ekonomik të tyre. Legjisllacioni shqiptar gjatë viteve ka pësuar ndryshime dhe përmirësime duke prekur pothuajse të gjitha fushat me rëndësi për Platformën për Veprim të Pekinit<sup>71</sup>.

Së fundmi, Shqipëria ka ratifikuar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me BE-në në vitin 2006, mbi bazën e së cilës rritja e bashkëpunimit do të synojë vendosjen e një ekonomie tregu plotësisht funksionale dhe harmonizimin e

<sup>67</sup> Ligji nr. 8137, datë 31.07.1996

<sup>68</sup> Ligji nr. 1769, datë 9.11.1993

<sup>69</sup> Ligji nr. 9052, datë 17.04.2003

<sup>70</sup> Organizata e Kombeve të Bashkuara. 1985. Strategjite e Ardhshme të Nairobiit për Përparimin e Grave. Gjetet në: <https://www.un.org/womenwatch/confer/nfls/Nairobi1985report.txt>

<sup>71</sup> Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. 2019. Raporti Kombëtar për Zbatimin e Platformës për Veprim Pekin+25. Tiranë. Shqipëri

ligjeve të vendit me ato të BE-së. Bazuar në Traktatin për Funkionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), Bashkimi Evropian duhet të ndërmarrë veprimet e duhura për të luftuar diskriminimin në bazë të gjinisë, origjinës racore apo etnike, fesë apo besimit, aftësisë së kufizuar, moshës apo orientimit seksual. Kjo kompetencë ka çuar në miratimin e disa direktivave me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e grave në Evropë, siç është e ashtuquajtura Direktiva e Riformuluar (2006/54/EC) për mundësi të barabarta dhe trajtim të barabartë të grave dhe burrave në punësim dhe profesion, e cila ka mbledhur bashkë disa direktiva më të vjetra dhe kërkon ndalimin e ngacmimit seksual dhe diskriminimit të drejtpërdrejtë e të tërthortë gjinor në pagë, (qasje në) punësim, si dhe në skemat e sigurimeve shoqërore. Më tej gjatë viteve, miratimi i Direktivës për Barazi Racore dhe Direktivës për Barazi në Punësim nisi një lëvizje në mbarë Evropën, në Shtetet Anëtare të BE-së dhe më gjerë, për miratimin e legjislacioneve kombëtare kundër diskriminimit që transpozojnë dispozitat e direktivave<sup>72</sup>. Direktiva e fundit e BE-së që prek barazinë gjinore, por edhe gratë në botën e biznesit, u miratua në nëntor 2022 dhe njihet edhe si Direktiva për Gratë në Borde, me qëllim përmirësimin e balancës gjinore mes drejtorëve të kompanive të listuara. Një listë e shkurtër e direktivave kryesore është paraqitur në kutinë e mëposhtme.

*Kutia 1. Lista e Direktivave kyçe të BE-së në mbështetje të barazisë gjinore*

Mos-diskriminimi në skemat statutoare të sigurimeve shoqërore (Direktiva 79/7/EEC)  
 Direktiva për Shtatzëninë (92/85/EEC)  
 Direktiva për Punën me Kohë të Pjesëshme (97/81/EC)  
 Direktiva për Barazinë Racore (2000/43/EC)  
 Qasje e barabartë në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve (Direktiva 2004/113/EC)  
 Direktiva e Riformuluar (2006/54/EC)  
 Direktiva për Vetëpunësimin (Direktiva 2010/41/EU)  
 Direktiva për Lejen Prindërore (2010/18/EU) ose  
 Direktiva për Barazinë në Punësim (2000/78/EC)  
 Direktiva për Gratë në Borde (BE) 2022/2381

Organizatrat e Shoqërisë Civile në Shqipëri e kanë diskutuar që herët rëndësinë e barazisë gjinore si një parakusht për integrimin evropian<sup>73</sup>. Qeveria e Shqipërisë miraton Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, versioni më i

<sup>72</sup> Rrjeti Evropian i Ekspertëve Ligjorë për Barazinë Gjinore dhe Mos-diskriminimin. 2023. Direktivat kyçe të BE për barazinë gjinore dhe mos-diskriminimin

<sup>73</sup> Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim. 2008. Barazia Gjinore, kusht për integrimin evropian. Tiranë. Shqipëri

fundit i të cilit është PKIE 2022 – 2024, ku përfshihet një listë legjislacionesh kyçe për t'u përafuar me Direktivat e BE-së<sup>74</sup>.

### Legjislacioni Shqiptar

Strategjitë më të fundit Kombëtare për Barazinë Gjinore pasqyrojnë përpjekjen për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe institucional për barazinë gjinore si një prioritet i Qeverisë së Shqipërisë prej vitesh tashmë. Në fakt, gjatë viteve janë ndërmarrë disa nisma, që nga miratimi i një ligji të dedikuar për Barazinë Gjinore në 2008, deri te ndryshimet më të fundit ligjore që promovojnë në mënyrë më aktive fuqizimin e grave, përfshirë fuqizimin ekonomik, duke synuar harmonizimin e këtij kuadri kombëtar me atë ndërkombëtar<sup>75</sup>.

Ka disa raporte që përmbledhin kuadrin ligjor për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin, nga të cilët raporti më i fundit është i UN Women në 2020, për mbrojtjen nga dhuna ndaj grave në zgjedhje. Analizat mbi ndjeshmërinë gjinore të legjislacionit që mundëson sipërmarrjen e gruas mungojnë ose janë shumë të kufizuara. Një analizë e fundit e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim ka identifikuar disa nga ligjet kryesore që lidhin fuqizimin ekonomik të grave me nismat ekonomike private, duke përfshirë Ligjin nr. 9970 datë 28.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, i ndryshuar; Ligjin nr. 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar; Ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin 22/2018 “Për strehimin social”; Ligjin 110/2018 “Për Noterinë”, Ligjin 111/2018 “Për Kadastrën”; Ligjin 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” etj.<sup>76</sup>

Për më tepër, kuadri për qeverisjen e korporatave në Shqipëri përbëhet në thelb nga ligjet e mëposhtme<sup>77</sup>:

- Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare (nr. 9901, datë 14.4.2008)
- Ligji për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar (nr. 10091, datë 5.03.2009)
- Ligji për Bankat (nr. 9662, datë 18.12.2006)

Këto ligje dhe/ose ato që vijnë përbëjnë legjislacionin e rëndësishëm aktual që lidhet me zhvillimin e sipërmarrjes së grave në Shqipëri ose e mundëson atë.

<sup>74</sup> Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. 2022. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian. Gjendet në: <https://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/en/anetaresimi-ne-be/plani-kombetar-i-integrim-it-pkie/>

<sup>75</sup> Qeveria e Shqipërisë. 2021. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030. Tiranë. Shqipëri

<sup>76</sup> Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim. 2021. Analizë e Legjislacionit Shqiptar në mbështetje të fuqizimit ekonomik të grave përmes përfshirjes në nisma ekonomike private. Av. A. Kalo. Tiranë. Shqipëri

<sup>77</sup> Deloitte Albania. 2022. Të Bërit Biznes në Shqipëri: Një Udhërrëfyes Krahasues.

*Ligji për Barazinë Gjinore në shoqëri*

Ky ligj është themeli i një kuadri të qartë legjislativ për barazinë gjinore. Ligji jep një përkufizim për konceptin e barazisë dhe synon të sigurojë mbrojtje efektive nga të gjitha format e diskriminimit me bazë gjinore, përcakton masat për garantimin e mundësive të barabarta midis grave dhe burrave, si dhe përgjegjësitë e institucioneve për të hartuar dhe zbatuar një kuadër ligjor dhe politika që mbështesin zhvillimin dhe promovimin e barazisë gjinore në shoqëri. Ky ligj shërben si një nga aktet më të rëndësishme të legjislacionit për të arritur barazinë gjinore, fuqizimin ekonomik të gruas dhe sigurisht sipërmarrjen e grave. Sipas përkufizimit në këtë ligj, *“Barazi gjinore” është pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe e meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozita e barabartë ndërmjet tyre, mundësi e shanse të barabarta, për të gëzuar të drejtat dhe për të përmbushur detyrimet në shoqëri, duke përfituar njëlloj nga arritjet e zhvillimit të saj*<sup>78</sup>.

*Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*

Në parim, një biznes në Shqipëri mund të krijohet nga një sipërmarrës i vetëm, si degë ose zyrë përfaqësuese e një kompanie ndërkombëtare ose si një kompani vendase. Neni 3 i ligjit parashikon se shoqëritë tregtare mund të krijohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, të cilët bien dakord të arrijnë objektiva të përbashkëta ekonomike, duke kontribuar në shoqërinë e krijuar, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Personat juridikë (shoqëritë) mund të organizohen në një nga llojet e mëposhtme:

- Shoqëri kolektive nga të paktën dy ortakë, me përgjegjësi të pakufizuar ndaj kreditorëve.
- Shoqëria komandite, kur përgjegjësia ligjore e të paktën njërit ortak është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij (ortaku i kufizuar), ndërsa përgjegjësia ligjore e ortakëve të tjerë nuk është e kufizuar (ortakët shoqërisë kolektive).
- Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK) e krijuar nga një ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, përgjegjësia ligjore e së cilës është e kufizuar deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.
- Shoqëria Aksionare (SHA) kapitali i së cilës ndahet në aksione të nënshkruara nga themeluesit e saj.
- Sipërmarrje e përbashkët, e rregulluar në dispozitat e Kodit Civil Shqiptar.

Neni 10 parashikon që themeluesit i japin kontributet e tyre shoqërisë, në të holla ose në natyrë, sipas metodave dhe afateve të parashikuara në statut dhe kryejnë formalitetet e themelimit sipas kërkesave të këtij ligji dhe ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

<sup>78</sup> Neni 4. Ligji 9970, datë 24.7.2008 “Për Barazinë Gjinore në shoqëri”

Të gjitha sa më sipër krijojnë një kornizë ligjore për burrat dhe gratë për të krijuar një kompani tregtare dhe për t'u bërë sipërmarrës. Gratë mund të hyjnë në botën e biznesit, përmes ligjeve dhe rregullatorëve neutralë ndaj gjinisë.

#### *Ligji për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve në Shqipëri*

Ky ligj është miratuar së fundmi në Shqipëri dhe synon të mundësojë një kuadër të favorshëm rregullator dhe institucional për ngritjen dhe zhvillimin e start-up-eve dhe mbështetjen e ekosistemit të tyre, për nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve inovative, si dhe modeleve, produkteve dhe proceseve të reja, të cilat sjellin risi në çdo fushë për zhvillimin ekonomik<sup>79</sup>. Ligji parashikon mbështetjen e start-up-eve dhe lehtësuesve të start-up-eve përmes granteve dhe masave mbështetëse. Për këtë qëllim, një nga objektivat kryesore të kësaj mbështetjeje është fuqizimi i vajzave dhe grave sipërmarrëse<sup>80</sup>.

#### *Ligji për Qendrën Kombëtare të Biznesit*

Ky ligj përcakton procedurat që duhen ndjekur për ngritjen e një biznesi në Shqipëri. Kjo procedurë aktualisht kërkon 24 orë për t'u finalizuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Qendra Kombëtare e Biznesit funksionon si zyrë me një ndalesë, duke mundësuar regjistrimin e njëkohshëm të shoqërisë së re pranë autoriteteve të tjera përkatëse, siç është organi tatimor kompetent. Duke filluar nga janari 2021, një biznes mund të regjistrohet vetëm online, pa i dhënë përparësi me bazë gjinore pronarit apo administratorit. Paanshmëria gjinore është e pranishme në çdo hap të procesit të mëposhtëm. Për sa i përket procedurës së sapopërmendur online, Bashkia e Tiranës ka ofruar asistencë të dedikuar për gratë sipërmarrëse të reja ose ekzistuese, që interesoheshin për të marrë shërbime nga Zyra Bashkiake e të Ardhurave të Brendshme<sup>81</sup>.

Përtej këtyre procedurave të përditësuara, ligji nuk parashikon asnjë detyrim për personin juridik (bashkëshorten ose bashkëshortin) për të marrë një autorizim nga partneri, që ka rënë dakord për krijimin e një shoqërie tregtare, kur kapitali është pjesë e pasurisë bashkëshortore.

Ligjet e renditura më sipër nuk garantojnë zbatimin dhe ekzekutimin e së drejtës së bashkëpronësisë tregtare të bashkëshortit jopjesëmarrës, edhe në rastet e zgjidhjes së martesës/regjimit pasuror jokontraktor, pavarësisht se kuadri ligjor nënkupton dhe praktika gjyqësore ka vërtetuar zyrtarisht me vendime gjyqësore të drejtën e bashkëshortit/es jopjesëmarrës/e si

<sup>79</sup> Ligji 25/2022 “PËR MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E STARTUP-EVE”, Neni 1.

<sup>80</sup> Ligji 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, Neni 14.

<sup>81</sup> Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC). 2023. Analizë Krahasuese: Sipërmarrja e Grave në Ballkanin Perëndimor. (e papublikuar)

bashkëpronar/e në kuotat ose aksionet e krijuara ose të blera me pasurinë juridike bashkëshortore jokontraktore<sup>82</sup>.

#### *Ligji “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”*

Qeveria e Shqipërisë ka miratuar një ligj të ri për NMVM-të, i parashikuar fillimisht të miratohej në vitin 2021. Ligji mundëson krijimin e një kuadri të plotë ligjor dhe institucional për zhvillimin e sipërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Ligji është një përafrim me Rekomandimin e KE-së maj 6, 2003<sup>83</sup>, për mbledhjen e të dhënave dhe metodat në llogaritjet për kategorizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe zbatimin e metodologjisë për përdorim nga ana e bizneseve. Ligji krijon një kuadër të përmirësuar për mbështetjen e sipërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, në përputhje me rregullat e ndihmës shtetërore; përcakton natyrën e mbështetjes dhe origjinën si mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, nga partnerë zhvillimi vendas apo të huaj, garancitë e huave shtetërore etj.

#### *Ligji për Falimentimin*

Mungesa e kuotave të njohura në sipërmarrjet/bizneset në pronësi të bashkëshortes apo bashkëshortit, e kufizojnë partnerin tjetër nga aksesimi në vendimmarrje. Duke qenë se në Shqipëri pjesa më e madhe e sipërmarrësve janë burra, ky është një fenomen i cili prek më së shumti gratë, të cilat mbajnë përgjegjësi civile si ortakë/aksionere por nuk janë pjesëmarrëse zyrtare me të drejtë vote në shoqërinë tregtare. Në kuadër të ligjit të falimentimit, vendimi për shpalljen e falimentimit të një biznesi në të cilin vetëm njëri bashkëshort është zyrtarisht pronar, sjell pasoja financiare ndaj bashkëshortit/es tjetër, i cili pa dijeni dhe pa të drejtë vendimmarrëse përballet me detyrimet ndaj procedurave të falimentimit. Këto dispozita ligjore nuk parashikojnë garanci për bashkëshortin/en në rastet kur shpërndahet masa e falimentimit dhe një shoqëri tregtare po i nënshtrohet falimentimit.

#### *Ligji për Bankat në Republikën e Shqipërisë*

Në Shqipëri gratë dhe burrat kanë të drejtë të aplikojnë për një kredi në kushte të barabarta. Megjithatë, kreditë hipotekare kërkojnë kolateral, thënë ndryshe një pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër të individit në Zyrën e Kadastrës. Statusi ligjor i huamarrësit konfirmohet gjatë procedurës së marrjes së kredisë, e mbështetur me dokumentacion zyrtar. Në rastet kur huamarrësi është i martuar duhet dorëzuar një certifikatë personale e bashkëshortit, duke i dhënë kështu bashkëshortit johuamarrës kompetencë vendimmarrëse

<sup>82</sup> Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim. 2021. Analizë e Legjislacionit Shqiptar në mbështetje të fuqizimit ekonomik të grave përmes përfshirjes në nisma ekonomike private. Av. A. Kalo. Tiranë. Shqipëri

<sup>83</sup> Qeveria e Shqipërisë. 2022. Programi i Reformës Ekonomike 2022-2024. Tiranë. Shqipëri

në lidhje me kërkesën për kredi. Kjo shtesë është mundësuar nëpërmjet nxjerrjes së një urdhri të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë në vitin 2015. Si rrjedhojë gratë kanë akses pa kufizime në financim duke respektuar njësoj regjimin pasuror martesor (pavarësisht nëse është ligjor apo kontraktual) gjatë formalizimit të kredisë dhe sigurimit të kolateralit. Megjithatë, qasja e grave në huamarrje nga bankat dhe institucionet financiare jobankare, asistencë hipotekore dhe forma të tjera të kredisë financiare është ende e ulët. Rolet gjinore në vend përbëjnë një problem, pasi burrat ende veprojnë si kryefamiljarë dhe kufizojnë aksesin e grave në financa. Aksesin në financa dhe veçanërisht në kredi hipotekore, lidhet me praktikën afatgjatë të regjistrimit të pronës kryesisht në emër të burrave të familjes. Në zonat rurale, vështirësitë shumëfishohen, pasi gratë shihen ende si 'gruaja e fermerit'.

### *Ligji për Kadastrën*

Ky ligj rregullon regjistrimin e pasurisë së ligjshme të bashkëpronësisë dhe rastet e tjera të përfitimeve pronësore, duke pohuar se, nëse bashkëshortit i kalohet një pasuri e fituar gjatë martesës, në përputhje me nenin 76 të Kodit të Familjes, ajo është pronë e përbashkët e të dy bashkëshortëve dhe duhet të regjistrohet në të dy emrat. Ligji për Kadastrën ka paraprirë korrigjimin dhe përditësimin e pasurisë së paluajtshme të fituar gjatë martesës para hyrjes në fuqi të këtij ligji, duke iu kushtëzuar të dy bashkëshortëve të jenë të regjistruar në pronësi të përbashkët.

Dispozita të tilla rregullojnë dhe vendosin një standard në legjislacionin shqiptar për kalimin e pronësisë në favor të të dy bashkëshortëve dhe procedurat që duhen ndjekur për të siguruar që kjo pasuri të pasqyrohet në regjistrat kadastrale të Republikës së Shqipërisë. Këto dispozita sigurojnë një kuadër ligjor, i cili u siguron grave akses më të madh në pasuri, si një mundësi tjetër kyçe apo instrument potencial për sipërmarrjen e grave. Veprime shtesë janë parashikuar në dokumentet strategjike kombëtare, veçanërisht për të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore ku informacioni është i nevojshëm, dhe për forcimin e kapaciteteve të profesionistëve për të mundësuar ushtrimin e këtyre të drejtave.

### *Ligji për Noterinë*

Neni 127/1 i Ligjit për Noterinë parashikon dispozita për regjistrimin e përbashkët në rastet e kalimit ose përfitimit të një pasurie të paluajtshme për pasuritë e fituara gjatë martesës, përveç rasteve kur ato i nënshtrohen një regjimi të veçantë martesor. Procedura e bazuar në ligj kërkon paraqitjen dhe bashkëngjitjen e një certifikate familjare dhe/ose martese të palës blerëse në kontratën përkatëse. Noteri bën përshkrimin përkatës në kontratë, duke përmendur si blerës/bashkëpronar bashkëshortin që mungon, në përputhje



me përcaktimet e Kodit të Familjes. Një procedurë e tillë është një mundësi kyçe për rritjen e aksesit të grave në të drejtat pronësore, pasi në parim, nëse supozimi i bashkëpronësisë së aseteve të krijuara në martesë nuk zbatohet de jure, vlefshmëria e veprimit juridik do të ishte zero.

### *Ligji për Ndhmën Shtetërore*

Ky ligj parashikon kuadrin për ndihmën shtetërore që jepet në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, duke përfshirë mbështetjen e drejtpërdrejtë të sipërmarrjeve private. Ndjeshmëria gjinore e këtij ligji është më e lartë në krahasim me legjislacionet e tjera të sektorit privat, pasi specifikon kategorinë e grave sipërmarrëse si përfituese të mundshme që mund të marrin një mbështetje të tillë nga shteti. Ky ligj lejon ndihmën shtetërore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për kategori të tilla si ndihma për investime; asistencë për ndërmarrjet e vogla të krijuara rishtazi nga gratë sipërmarrëse; asistencë këshillimore etj. Sipas dispozitave përkatëse, gratë sipërmarrëse mund të kenë akses në ndihmën shtetërore nëse plotësojnë kriteret dhe ndjekin procedurat përkatëse. Kushtet, kriteret, intensiteti i ndihmës dhe procedurat për dhënien dhe autorizimin e ndihmës shtetërore për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## **Strategjitë për Sipërmarrjen dhe Fuqizimin Ekonomik të Grave**

Kuadri rregullator për zhvillimin e sipërmarrjes së grave përfshin një mori dokumentesh strategjike kyçe krahas planeve të veprimit të hartuara dhe zbatuara me qëllim arritjen e objektivave strategjike. Këto dokumente strategjike përfshijnë Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit, Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive etj.

## **Dokumentet strategjike të rëndësishme për fuqizimin ekonomik të grave**

### *Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030*

Strategjia e re e miratuar në vitin 2021 bazohet në Strategjinë Kombëtare 2014-2020 dhe përbën një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku grave dhe burrave u jepen mundësi të barabarta për të zhvilluar potencialet e tyre; të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrje politike dhe publike; të ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe të mbështeten për t'u zhvilluar nga ana sociale dhe ekonomike; dhe ku grupeve vulnerabël u jepet përparësi dhe mbështetje derisa të fuqizohen dhe të gëzojnë të drejta

dhe mundësi të barabarta<sup>84</sup>. Fuqizimi ekonomik i grave është një nga shtyllat kryesore të strategjisë dhe parashikon një sërë veprimesh dhe rezultatesh të pritshme, duke përfshirë nxitjen e sipërmarrjes së grave.

Raporti i fundit i Komisionit Evropian për Shqipërinë e konsideron Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 dhe planin e saj të veprimit të përafuar me Planin III të Veprimit Gjinor të BE-së<sup>85</sup>. Raporti konsideron se strategjia është më mbështetëse në adresimin e të drejtave të të gjitha grave dhe burrave, duke u fokusuar te njerëzit që përballen me forma të ndërthurura të diskriminimit dhe cenueshmërisë<sup>86</sup>. Strategjia përafuron barazinë gjinore me objektivat kyçe zhvillimore brenda ekonomisë, duke e konsideruar si thelbësore përmbushjen e të drejtave ekonomike dhe sociale të grave, krahas një ekonomie të qëndrueshme si edhe pjesëmarrjen e barabartë në procesin e dixhitalizimit.

### *Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve*

Strategjia SZhBI 2021-2027 është kuadri strategjik për sipërmarrjen dhe politikën industriale të Shqipërisë dhe aktualisht është kuadri kyç mundësues për sipërmarrjen e grave. Ai siguron orientimin strategjik kyç për zhvillimin e aftësive të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, inovacionit, rritjes së qëndrueshme dhe kushteve për tërheqjen e investimeve të huaja. Strategjia e mëparshme 2014-2020 u shoqërua me një plan veprimi specifik për sipërmarrjen e grave. Ky dokument ka adoptuar një qasje ndryshe, duke vendosur objektiva specifike/tregues kyç të performancës në kuadër të veprimeve jodiskriminuese për të gjithë sipërmarrësit. Këto instrumente të ndërgjegjësimit gjinor janë të njohura për ekspertët gjinorë dhe zbatohen në ekonomitë me një integrim më të lartë të grave në jetën politike dhe ekonomike<sup>87</sup>.

### *Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi*

Strategjia e fundit Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022 ishte një zgjatje e strategjisë 2014-2020, duke synuar që të plotësonte objektivat strategjike të përcaktuar në dokument. Kjo e fundit e njohu sipërmarrjen e grave si një parakusht për përmirësimin e punësimit si dhe për një ekonomi konkurruese dhe të orientuar drejt rritjes<sup>88</sup>. Të dy dokumentet kishin në fokus promovimin e të mësuarit për sipërmarrjen dhe sipërmarrjen e grave si një

<sup>84</sup> Hyrja e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030

<sup>85</sup> Komisioni Evropian. 2022. Raporti për Shqipërinë 2022. Bruksel. Belgjikë

<sup>86</sup> Ibid.

<sup>87</sup> Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC). 2023. Analizë Krahasuese: Sipërmarrja e Grave në Ballkanin Perëndimor. (e papublikuar)

<sup>88</sup> Qeveria e Shqipërisë. 2014. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020.

kompetencë kyçe, si dhe promovimin e sipërmarrjes sociale (ekonomia sociale dhe vendet e punës në sektorin e tretë) dhe fuqizimin ekonomik të grave. Në draft-strategjinë e re të nisur për konsultim publik në nëntor të vitit 2022, sipërmarrja e grave nuk është pjesë në asnjë nga objektivat strategjike duke krijuar kështu një boshllëk politikash në mbështetje të sipërmarrjes së grave.

### Programi i Reformës Ekonomike 2022-2024

Duke lënë mënjanë progresin, kuadri aktual rregullator kërkon më shumë përpjekje në mbështetje të grave sipërmarrëse, pasi sfidat me të cilat përballen gratë janë të shumta në krahasim me ato me të cilat përballen burrat sipërmarrës<sup>89</sup>.

Një nga Udhëzimet e Politikave të Programit të Reformës Ekonomike 2022-2024 është *ofrimi i shërbimeve të zgjeruara të mbështetjes së biznesit për të përmirësuar aksesin në financim dhe njohuritë e sipërmarrjes*. Sipas këtij udhëzimi politikash, aktivitetet që lidhen me sipërmarrjen e grave janë pjesë e objektivit të forcimit të ekosistemit “start-up”. Aktivitetet e planifikuara për vitin 2023 përfshijnë funksionimin e Këshillit të start-ups, fillimin e zbatimit të ligjit për start-ups me fokus në masat mbështetëse dhe funksionimin e portalit online për vetëregjistrimin online të start-ups dhe lehtësuesve. Rezultatet e pritshme përfshijnë mbështetjen për gratë dhe vajzat sipërmarrëse. Megjithatë, nuk ka tregues me bazë gjinore për të vlerësuar efektivitetin e një mbështetjeje të tillë.

Një tjetër prioritet është miratimi i ligjit të ri për zhvillimin e sipërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, i paraqitur si një instrument i rëndësishëm për sipërmarrjen e grave dhe fuqizimin ekonomik të tyre, falë edhe prezantimit të instrumenteve të reja financiare për fillimin e një biznesi dhe zhvillimin e NVM-ve<sup>90</sup>. Edhe kësaj mase i mungojnë treguesit me bazë gjinore.

Për sa kohë që ka dallime thelbësore në jetën e grave dhe burrave në shumicën e fushave të një shoqërie, politikat publike të cilat konsiderohen neutrale nga perspektiva gjinore kanë një ndikim të ndryshëm tek gratë dhe tek burrat. Këto dallime thelbësore janë shkak që këto politika në dukje neutrale të shërbejnë si mjete që thellojnë pabarazitë ekzistuese<sup>91</sup>.

Siç sugjerohet nga Raporti i fundit i BE-së për Shqipërinë, Programi i Reformës Ekonomike duhet të ndjekë një proces më të plotë konsultimi

<sup>89</sup> Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC). 2023. Sipërmarrja e Grave në Shqipëri. (e papublikuar)

<sup>90</sup> Qeveria e Shqipërisë. 2022. Programi i Reformës Ekonomike 2022-2024. Tiranë. Shqipëri

<sup>91</sup> Drumea I. 2013. Vlerësim i mjedisit për sipërmarrjen e grave në Republikën e Moldavisë. Confederația Națională a Patronatului din Rep. Moldova. Chișinău; S. n., 2013 (Tipogr. „Sofart Studio”).48 p

publik<sup>92</sup>. Një konsultim i tillë publik gjithëpërfshirës i Programit të Reformës Ekonomike mund të ofrojë komente shtesë në lidhje me gjininë për politika më të ndjeshme gjinore dhe procese të ndërgjegjësimit të politikave gjinore.

## Rishikim i Shkurtër i Kuadrit Institucional për Sipërmarrjen e Grave

Në përgjithësi, një mjedis mund të konsiderohet si mundësues për sipërmarrjen, kur ka koordinim ndërmjet lidhësve institucional/politik dhe aktorëve kryesorë të fuqizuar për të zhvilluar kuadrin ligjor dhe atë të politikave për veprimtarinë sipërmarrëse<sup>93</sup>.

Në Shqipëri, asnjë institucion i veçantë nuk është krijuar apo fuqizuar për të zhvilluar dhe zbatuar kuadrin rregullator dhe të politikave për mundësitë e barabarta për burrat dhe gratë. Institucioneve të qeverisë qendrore, përkatësisht ministrive të linjës, u jepen fusha të funksionimit në mbështetje të barazisë gjinore, në përputhje me funksionet e tyre.

Aktualisht, institucionet e qeverisë qendrore të lidhura drejtpërdrejt me qeverisjen e sipërmarrjes së grave në Shqipëri janë:

- Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve.

Këto institucione janë institucionet kyçe për zhvillimin e sipërmarrjes në përgjithësi dhe jo të sipërmarrjes së grave në veçanti.

**Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes** synon të ndihmojë dhe mbrojë sipërmarrjet private që operojnë në Shqipëri, duke nxitur bashkëpunimin ndërinstitucional për përmirësimin e shërbimeve publike për bizneset<sup>94</sup>. Ministria është parashikuar si përfaqësuese e komunitetit të biznesit në organet qeveritare, duke mbajtur kanale të qëndrueshme komunikimi me bizneset, përfshirë investitorët strategjikë dhe të huaj. Së fundmi ajo administron mbështetjen për start-up-et inovative dhe lehtësuesit e start-up-eve, duke menaxhuar fondin e dedikuar.

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë** brenda fushës së saj të përgjegjësisë menaxhon promovimin e sipërmarrjes, përgatitjen dhe zbatimin e politikave

<sup>92</sup> Komisioni Evropian. 2022. Raporti për Shqipërinë 2022. Bruksel. Belgjikë

<sup>93</sup> Drumea I. 2013. Vlerësim i mjedisit për sipërmarrjen e grave në Republikën e Moldavisë. Confederația Naț. a Patronatului din Rep. Moldova. Chișinău; S. n., 2013 (Tipogr. „Sofart Studio”).48 p

<sup>94</sup> Qeveria e Shqipërisë, Vendim i Këshillit të Ministrave, 20.10.2021, “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”

për një klimë pozitive biznesi dhe promovon një dialog intensiv publik-privat. Në strukturën e sapomiratur të Ministrisë është zgjeruar struktura që punon në fushën e nxitjes së biznesit dhe sipërmarrjes. Ndërsa deri në vitin 2022, struktura përfshinte vetëm një njësi, struktura e re e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë parashikon një Drejtori të Përgjithshme për Zhvillim Ekonomik, Nxitjen e Biznesit dhe Tregtisë. Kjo do të çonte në ringritjen e një drejtorie të fokusuar në promovimin e biznesit, e ngjashme me strukturën e krijuar para vitit 2017. Ajo do të mbulonte fusha të tilla si zhvillimi i NVM-ve, nxitja e biznesit, vlerësimi dhe zhvillimi i politikave sektoriale, promovimi i tregut të brendshëm, politikat që rrisin konkurrencën dhe produktivitetin. Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse për zbatimin e veprimeve që nxisin sipërmarrjen e grave, bazuar në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030. Për periudhën 2014-2020 ajo ishte përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit për Gratë Sipërmarrëse në Shqipëri.

**Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)** është një institucion pjesë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me fokus rritjen e konkurrencës së sektorit privat, forcimin e potencialit eksportues të vendit dhe nxitjen/mbështetjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri, si dhe promovimin e potencialit turistik të vendit. AIDA shërben si një ndërmjetës midis qeverisë dhe sektorit privat, duke vepruar si një “Zyrë me një ndalesë”, duke mbështetur investitorët si dhe duke ofruar akses në informacione të përditësuara etj. AIDA është gjithashtu agjencia përgjegjëse për ekzekutimin e skemave të granteve në mbështetje të bizneseve, siç parashikohet në dokumentet strategjike dhe të politikave, informon sektorin privat mbi mundësitë e financimit të zbatuara nga institucionet qendrore dhe angazhohet veçanërisht me sektorët strategjikë si turizmi, energjia, TIK dhe BPO (shërbimet e nën-kontraktuara), prodhimi, bujqësia etj.

# Gjetjet e anketës për gratë sipërmarrëse në Shqipëri

Në këtë kapitull paraqiten gjetjet e sondazhit të kryer nga Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim (GADC) nëpërmjet një pyetësi të vënë në dispozicion online për sipërmarrjen e grave që operojnë në Shqipëri. Pyetësi kishte për qëllim të bënte një vëzhgim të grave sipërmarrëse përmes një grupi prej 91 pyetjesh, në përpjekje për të identifikuar nevojat e grave në procesin e zhvillimit ose zgjerimit të bizneseve të tyre, si dhe të dilte me disa rekomandime.


## Profili i Grave Sipërmarrëse që morën pjesë në anketë

Pjesëmarrëset në këtë anketë ishin gra sipërmarrëse që jetojnë kryesisht në zonat urbane dhe që e fokusojnë aktivitetin e tyre në bashkitë Tiranë, Shkodër, Elbasan etj.

## Shpërndarja Rajonale

88.6% e këtyre grave sipërmarrëse jetojnë në zonat urbane, ndërsa 13.4% e tyre jetojnë në zonat rurale. Në analizimin e të gjithë dokumentacionit, theksuam rritjen e barrierave për sipërmarrjen e grave në zonat rurale, veçanërisht në Shqipëri; duke pritur kështu një rezultat të ngjashëm. Pjesa më e madhe e të anketuarve, ose 24,2% e tyre, jetonin në qytetin e Tiranës, pasuar nga Shkodra me 18,5%, Elbasani dhe Durrësi, përkatësisht me 16,4% dhe 7,7%. Edhe ndarja e aktiviteteve të biznesit sipas vendndodhjes është pak a shumë njësoj, pasi pjesa më e madhe e tyre, 23,9% e kanë përqendruar ushtrimin e veprimtarisë së subjektit të tyre në kryeqytet, rreth 17,4% në qytetin e Shkodrës, 16,4% në qytetin e Elbasanit, 7,7% në qytetin e Korçës dhe 7% në qytetin e Durrësit.


Figura 8. Vendbanimi i Grave Sipërmarrëse dhe vendi i ushtrimit të biznesit sipas Bashkisë



### Demografia

Mosha e të anketuarave varion nga gratë e lindura në vitin 1951 deri tek ato që kanë lindur në 2004-ën, pra nga mosha 71 vjeç deri në moshën 18 vjeç.

Figura 9. Mosha e të anketuarave



Një ndër tre gra sipërmarrëse i përkiste grupmoshës 30-39 vjeç. Grupmoshat e tjera më relevante ishin 40 - 49 dhe 50-59 vjeçe, përkatësisht 26% dhe 22%. Vetëm 0,4% e të anketuarave janë nën 20 vjeçe dhe vetëm 8,1% janë mbi 60 vjeçe. Mosha që dominonte më shumë ndër të anketuarat ishte mosha 48 vjeç (44 të anketuara), 35 vjeç (43 të anketuara) dhe 32 vjeç (44 të anketuara). **Mosha mesatare e grave sipërmarrëse shqiptare sot është 43 vjeç.**

Pothuajse 3 në çdo 4 gra sipërmarrëse janë të martuara dhe 3 nga 4 prej tyre janë nëna me fëmijë. Nga 86,7% e grave sipërmarrëse që kishin qenë të martuara, 8% ishin divorcuar, kurse 4,7% kishin mbetur të veja. Ndërsa të

anketuarat që janë përgjigjur se nuk kanë fëmijë, janë kryesisht të pamartuara, 35.5% të martuara me vetëm 6,5% të divorcuara. 39% e grave sipërmarrëse që kanë fëmijë janë përgjigjur se nuk kanë fëmijë nën 18 vjeç, 18.9% kanë vetëm 1 fëmijë nën 18 vjeç, kurse 14,3% kanë 2 fëmijë nën 18 vjeç.

**Gratë me numrin më të madh të fëmijëve e kanë nisur biznesin vetëm në 2 vitet e fundit, duke shpjeguar kështu edhe arsyetimin se ka qenë pikërisht rritja e përgjegjësive dhe shtimi i punës së kujdesit të papaguar që e ka vonuar edhe futjen e tyre në botën e sipërmarrjes.** 64,3% e atyre që kanë gjithsej “3 fëmijë nën 18 vjeç” e kanë regjistruar biznesin e tyre për herë të parë në vitin 2020. Vetëm 3 gra me “4 fëmijë nën 18 vjeç” e kishin regjistruar gjithashtu biznesin për herë të parë në vitin 2020.

Nga të anketuarat me fëmijë, 71 prej tyre ose 9,6% e kanë regjistruar biznesin e vet për herë të parë në vitin 2015. 15.3% ose 29 gra nga 189 gjithsej me “1 fëmijë nën moshën 18 vjeç”, e kanë regjistruar biznesin për herë të parë në vitin 2021. 9.2% ose 36 gra nga 390 që kanë gjithsej “0 fëmijë nën 18 vjeç”, e kanë regjistruar biznesin për herë të parë në vitin 2015. 12.6% ose 18 gra nga 143 që kanë gjithsej “2 fëmijë nën 18 vjeç” e kanë regjistruar biznesin për herë të parë në vitin 2014.


### Arsimimi

Një ndër tre të anketuara kanë përfunduar arsimin e lartë, pra ose kanë një diplomë Bachelor, Master ose doktoraturë. Gjithashtu, një ndër tre të anketuara kanë përfunduar arsimin e mesëm, arsimin e përgjithshëm ose atë profesional). Përqindja e grave sipërmarrëse me arsim 9-vjeçar ose me arsim të mesëm është dhjetë herë më e madhe se ajo me doktoraturë.

Duke qenë se ka një përqindje të lartë subjektsh të drejtuar nga gratë që janë regjistruar si persona fizikë, sa më sipër mund të lidhet me vetëpunësimin. Të dhënat për gratë e vetëpunësuarat tregojnë se gratë sipërmarrëse me nivel të ulët arsimor kanë më shumë gjasa të jenë të vetëpunësuarat, veçanërisht në moshën 55-64 vjeç. Megjithatë, në përgjithësi 89,4% e grave kishin të paktën arsimin e mesëm të lartë, në përputhje me studimet e mëparshme që paraqesin një profil me arsim të lartë të grave sipërmarrëse shqiptare.



Figura 10 . Niveli arsimor i të anketuarave (%)




Shumica e të anketuarave me arsim të lartë kanë studiuar ekonomik, biznes ose financë në nivelin më të lartë të arsimit të tyre, pasuar nga mjekësia dhe fusha të ngjashme si shkencat sociale dhe pedagogjike.

### Të qenit sipërmarrëse

#### Motivimi për të nisur një biznes

Rezultatet e anketës tregojnë se motivimi kryesor i të anketuarave për të nisur një biznes janë të ardhurat shtesë.

Figura 11. Motivimi për të nisur një biznes



Arsyet kryesore pse gratë e pyetura kishin nisur një biznes të vetin ishin:

- Për të plotësuar të ardhurat e familjes, në 44,6% të rasteve;
- Për të fituar më shumë para në 36.6% të rasteve;

- Për të përmbushur një ëndërr, për të realizuar një pasion në 26.3% të rasteve;
- Për të plotësuar një nevojë që nuk plotësohej nga tregu në 22.9% të rasteve, etj.
- 15.9% janë përgjigjur se e kanë nisur biznesin si ndërmarrje familjare dhe 10.3% për të dhënë një kontribut pozitiv në jetën e komunitetit.

### Kënaqësia nga nisma e ndërmarrë

Vetëm një ndër njëzet gra sipërmarrëse u shprehën se ishin plotësisht të kënaqura me punën e tyre si pronare biznesi. Pjesa tjetër, të pyetura për faktorët që do t'i bënin ato më të lumtura dhe më të kënaqura si sipërmarrëse, u përgjigjën se **“më shumë para në fund të muajit për ato vetë dhe për familjet e tyre”** do të ishte faktori kryesor në masën **62.4%**, kurse faktori i dytë i përmendur si faktori që do t'i bënte më të lumtura ishte **“nëse do të kishin më shumë mbështetje nga bashkëshorti/partneri/familja dhe komuniteti”**. Një ndër pesë sipërmarrëse besojnë se të kaluarit e një kohe më të madhe me familjen do ua rriste lumturinë (21.5% të rasteve).

### Stereotipet


Sa u përket stereotipeve për gratë sipërmarrëse, përgjigjet tregojnë se **45% e grave sipërmarrëse ishin përballur me të njëjtin nivel stereotipesh të shprehura nga miqtë, familjarët; partnerët e biznesit, kolegë; investitorët potencialë dhe nga media.**

Në të njëjtën kohë, rreth 55% janë shprehur se nuk janë përballur me stereotipe si: *Gratë nuk janë sipërmarrëse të zonja, Gratë nuk kanë ide novatore, Gratë duhet t'u japin përparësi punëve të shtëpisë, si kujdesit për fëmijët, Gratë nuk janë të zonjat të menaxhojnë paratë, Gruaja nuk mund të bëjë edhe biznesin edhe nënën njëkohësisht, Gratë nuk kanë mendësi biznesi, Gratë nuk janë të vendosura sa duhet për të qenë sipërmarrëse të suksesshme, Burrat kanë më shumë ambicie se gratë, prandaj, si rezultat, bizneset e burrave janë më të suksesshme se bizneset e grave, Gratë janë të prirura ta shmangin rrezikun, Burrave nuk u pëlqejnë gratë që janë shumë të forta/që kanë aftësi për të bërë biznes/që janë të suksesshme.*

45% e përgjigjeve tregojnë se investitorët potencialë mendojnë se **“Menaxhimi i biznesit nuk përputhet me të qenit nënë”**. Me të njëjtin stereotip të grave sipërmarrëse janë përballur edhe në marrëdhënie me partnerët e biznesit, kolegët e punës apo me mediat. Të tjera shprehje relevante ishin: **“Gratë nuk kanë prirje për biznes”** ose **“Gratë nuk janë të vendosura sa duhet për të qenë sipërmarrëse të suksesshme”** etj.

## Koha kushtuar biznesit

Figura 12 . Numri i orëve të shpenzuara në javë në biznes




Një në tetë të anketuara shpenzon mesatarisht 70 orë në javë në administrimin e biznesit të vet ose duke punuar në biznesin e vet, 11% shpenzojnë mesatarisht 48 orë në javë në biznesin e tyre, ndërsa 10,4% shpenzojnë mesatarisht 60 orë. Siç pritej, ka përgjithësisht një angazhim më të lartë sesa orari i zakonshëm i punës prej 40 orësh në javë. Rezultate të ngjashme vërehen kur merren parasysh gratë sipërmarrëse me një fëmijë.

Megjithatë, ka dallime midis grave sipërmarrëse me fëmijë dhe atyre pa fëmijë. Gratë me familje dhe me fëmijë përgjithësisht angazhohen më shumë dhe i kushtojnë më shumë kohë biznesit të tyre.

**Numri mesatar i orëve të punës për një grua sipërmarrëse pa fëmijë është 44.7 orë/javë, ndërsa për ato me fëmijë mesatarja është 57 orë/javë.**


Figura 13 . Numri mesatar i orëve në javë shpenzuar për administrimin e biznesit ose për të punuar në biznes



## Ekilibri jetë-punë

Sipas të anketuarave, gratë sipërmarrëse janë shumë të zonjat në menaxhimin e ekulibrit midis punës dhe jetës. Dy ndër pesë gra (43,1%) raportojnë se është shumë e lehtë për të menaxhuar angazhimet e biznesit dhe atyre të familjes. Megjithatë, po i njëjti numër grash (43.9%) shprehen se e kanë të vështirë të mbajnë një ekulibër mes punës dhe jetës, por kanë mbështetjen e bashkëshortit dhe të familjes.


Figura 14 . Ekulibri jetë-punë



Ndërkohë, një ndër pesë gra sipërmarrëse shprehen se e shohin shumë të vështirë që të menaxhojnë përkushtimin ndaj biznesit dhe ndaj familjes, (ato raportojnë se nuk kanë asnjë ndihmë/mbështetje).

## Pavarësia në vendimmarrje

Figura 15. Përgjegjësia e menaxhimit të operacioneve të biznesit



Në 93.8% të rasteve, përgjegjësinë kryesore për menaxhimin e operacioneve të përditshme të biznesit e mbajnë vetë të anketuarat. Në raste të tjera, të anketuarat janë shprehur se këtë përgjegjësi e marrin partnerët e tyre në biznes ose bashkëshorti.

Ashtu si menaxhimi i operacioneve ditore, edhe kontrolli financiar, i cili përfshin kompetencën e firmosjes së kontratave të kredive, kontratave të qirave dhe kontratave të tjera, paraqitet në të njëjtat nivele përfaqësimi. Në 93.8% të rasteve, këto procese menaxhohen nga vetë të anketuarat.


Në raste të tjera, kontrolli financiar në përgjigjet e dhëna paraqitet si një proces i drejtuar kryesisht nga ekonomisti, nga vetë të anketuarat dhe nga bashkëshorti, ose vetëm nga ky i fundit. Në 2.2% të rasteve, gratë sipërmarrëse deklaruan se bashkëshorti i tyre ishte i përfshirë drejtpërdrejt në menaxhimin financiar të biznesit. Megjithatë, një numër më i madh grash, **rreth 40%, u shprehën se e konsiderojnë mbështetjen ose vlerësimet që u japin bashkëshortët si këshilla menaxheriale.**

Kur u pyetën për këshillat që marrin për menaxhimin e biznesit nga njerëz të ndryshëm, ato u përgjigjën se marrin rregullisht këshilla menaxheriale (më shumë se një herë në muaj), në 39,7% të rasteve nga bashkëshorti/partneri, në 29.9% të rasteve nga anëtarët e tjerë të familjes/të afërm dhe në 23.7% të rasteve nga miq dhe të njohur. etj.

## Profili i ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë që u përfshinë në anketë

### Themelimi i ndërmarrjeve


Figura 16. Regjistrimi i bizneseve të drejtuara nga gratë për dhjetëvjeçarë



Shumica e ndërmarrjeve të anketuara janë themeluar në periudhën 2010-2019, ndërsa vetëm 27% e ndërmarrjeve janë themeluar përpara vitit 2010. Në rishikimin e literaturës nuk kemi identifikuar asnjë analizë mbi jetëgjatësinë e sipërmarrjeve

të drejtuara nga gratë në Shqipëri. Megjithatë, literatura e njeh ndikimin pozitiv që kanë pasur drejtueset gra të bizneseve në uljen e mundësive për falimentim, siç përmendet gjatë gjithë këtyre analizave. Është e qartë se në kampionin tonë ka një tendencë pozitive në krijimin e sipërmarrjeve të grave, megjithëse sipas të dhënave zyrtare ka një lloj stagnacioni në shifra.


Figura 17. Viti i themelimit të ndërmarrjeve të anketuara



Viti me numrin më të madh të regjistrimit/krijimit të bizneseve nga të anketuarat e këtij studimi është viti 2021 (10.9%), pasuar nga viti 2020 me 10,1%, viti 2015 me 8%, viti 2014 me 7,1% dhe viti 2010 me 5,6%.

**Gratë sipërmarrëse shqiptare janë përgjithësisht rreth të tridhjetave në kohën e hapjes së biznesit të tyre.**

Figura 18. Periudha e regjistrimit të biznesit sipas moshës së të anketuarave



40% e bizneseve të drejtuara nga gra të moshës mbi 60 vjeç, janë regjistruar në periudhën 1990-1999. 44% e bizneseve të drejtuara nga gra të grupmoshës 50-59 vjeç janë regjistruar në periudhën 2000-2009.


43,7% e bizneseve të drejtuara nga gra të grupmoshës 40-49 vjeç dhe 59,3% e bizneseve të drejtuara nga gra të grupmoshës 30-39 vjeç janë regjistruar në periudhën 2010-2019. Të dhënat për grupmoshën e grave sipërmarrëse 20-29 vjeç janë interesante, pasi më shumë se gjysma e këtyre bizneseve janë regjistruar pas vitit 2019, kurse 41.4% janë regjistruar në periudhën 2010-2019.

**Nuk ka ndonjë tendencë të veçantë në ngritjen e sipërmarrjeve të grave bazuar tek aktiviteti ekonomik.** Ajo që vlen të përmendet është fakti se rezultatet nga të anketuarit ndjekin zhvillimet në treg, ku vitet e fundit shihet një rritje e sektorëve si komunikimi, arsimit, moda, sektori financiar dhe siguracionet, ndërkohë që shihet një ulje e fokusimit te tregtia, etj.

Të dhënat tregojnë se:

- 14,7% e bizneseve që operojnë në fushën e “Shërbimeve të Mirëqenies” (17 nga 116 gjithsej) e kanë regjistruar biznesin e tyre në vitin 2014.
- 9.5% e bizneseve që ushtrojnë aktivitetet në fushën e “Tregtisë me Pakicë” (17 nga 179 gjithsej) e kanë regjistruar biznesin e tyre në vitin 2015.
- 18.9% e bizneseve që operojnë në fushën e “Modës, Veshjeve” (20 nga 106 gjithsej) e kanë regjistruar biznesin e tyre në vitin 2020.
- 41% e bizneseve që operojnë në fushën e “Arsimit” (16 nga 39 gjithsej) e kanë regjistruar biznesin e tyre në vitin 2020 dhe në vitin 2021.
- 22,8% e bizneseve që operojnë në fushën e “Artizanatit” (13 nga 57 gjithsej) e kanë regjistruar biznesin e tyre në vitin 2021.


*Figura 19. Periudha e themelimit të ndërmarrjeve sipas aktivitetit ekonomik*



## Forma juridike

3 nga 4 gra sipërmarrëse (76.3%) janë të regjistruara zyrtarisht si person fizik. 13.8% janë drejtuese ekzekutive (CEO) në kompaninë e tyre dhe vetëm 4% dhe 2.4% e grave janë pozicionuar përkatësisht si bashkë-partnere/bashkëaksionere të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe aksionere të vetme të shoqërive aksionere.


Figura 20. Pozicioni i grave sipërmarrëse në kompani



Gratë e regjistruara si aksionere në shoqëri aksionere zotëronin kryesisht 50%-60% të aksioneve (72%). Nga 40 rastet ku të anketuarat ishin aksionere, vetëm 3 prej tyre zotëronin 100% të kuotave të shoqërisë. Për më tepër, 0.6% e të anketuarave kanë raportuar se nuk janë të regjistruara ligjërisht dhe se veprojnë në mënyrë informale.

## Industritë

Figura 21. Industritë ku operojnë ndërmarrjet e drejtura nga gratë



Nga të gjithë të anketuarat, vetëm 48 prej tyre, ose 4.8%, janë përgjigjur se biznesi i tyre është në fushën e bujqësisë, blegtorisë ose peshkimit. Pjesa tjetër e të anketuarave operonte në fushën e tregtisë me pakicë (19%), shërbimeve




të mirëqenies (12%) dhe modës (11%) etj. Nga këto kategori:

- Nga 179 biznese që operojnë në fushën e Tregtisë me Pakicë, 166 janë persona fizikë;
- Nga 116 biznese që operojnë në fushën e shërbimeve të mirëqenies, 113 janë zyrtarisht persona fizikë
- Nga 106 biznese që operojnë në sektorin e modës, 88 janë persona fizikë.
- Nga të gjitha gratë që mbajnë pozicionin e administratorës/CEO-s, 10,3% operojnë kryesisht në fushën e Shërbimeve Financiare dhe po aq gra (10.3%) në fushën e Tregtisë me Shumicë.

### Burimi i Pronësisë

Gratë sipërmarrëse u pyetën se si e kanë ngritur biznesin ose si e kanë marrë pronësinë e biznesit. Sipas përgjigjeve, 71.8% e subjekteve tregtare janë ngritur nga e para, 12.1% janë blerë, kurse 7.3% janë biznese që i kanë trashëguar. Ndërkohë që 5.5% të të anketuarave ua ka dhuruar biznesin familja e vet, pjesa tjetër prej 2.1% e kanë fituar pronësinë përmes dhurimit nga një person që nuk është anëtar i familjes, përmes dhurimit nga programe të mbështetura nga organizata jofitimprurëse ose nga Qeveria e Shqipërisë.

Figura 22. Si e kanë fituar të anketuarat pronësinë e biznesit?



### Kapitali për ngritjen e biznesit

Financimi fillestar për rreth 11.6% të bizneseve ishte 1 000 000 lekë, pasuar nga 9.7% e bizneseve që e kanë nisur aktivitetin fillimisht me 500 000 lekë dhe 8% me 200 000 lekë. Të anketuarat deklaruan se vlera më e ulët e financimit fillestar kishte qenë 400 lekë, ndërsa vlera më e lartë e financimit fillestar 450 000 000 lekë.



## Statusi i Regjistrimit

Figura 25. Statusi i regjistrimit të ndërmarrjeve




95.1% e të anketuarave deklaruan se biznesi i tyre është i regjistruar, 2.6% raportuan se janë në proces regjistrimi, ndërsa 1.9% u përgjigjën se nuk e kanë regjistruar biznesin, kurse 0.4% janë të regjistruara si biznese, por aktualisht e kanë pezulluar aktivitetin.

Literatura konstaton se sipërmarrja e grave mund të lidhet deri në një farë mase edhe me një nivel më të lartë informaliteti.

Megjithatë, nuk mund të bëhen krahasime sa i përket informalitetit dhe ky krahasim nuk është objekt i këtij studimi.

## Përmasat e biznesit

Figura 26. Përmasat e bizneseve të drejtuara nga gratë e anketuara



Numri i punonjësve të paguar shërben si bazë për të vlerësuar përmasat e një biznesi.


Siç vërehet në literaturë dhe falë burimeve dytësore të të dhënave, ndërmarrjet e grave janë me përmasa të vogla.

Ato tregojnë se përveç 16% të të anketuarave që nuk kanë punonjës afatgjatë, 58% e sipërmarrjeve kanë 1-4 punonjës, kurse 26% e sipërmarrjeve kanë më shumë se 5 punonjës.

Të anketuarat ofruan këto të dhëna për numrin e punonjësve që kanë në vazhdimësi.

- 22.5% u përgjigjën se kanë 1 punonjës me pagesë në biznesin e vet;
- 17.7% prej tyre kishin 2 punonjës;
- 10.7% kishin 3 punonjës etj.


Figura 27. Të punësuarit me lidhje familjare me pronarin



Të anketuarat kanë raportuar se kanë të paktën një të punësuar që është pjesë e familjes. Të anketuarat raportuan në 15% të rasteve se kanë të punësuar të paktën një person me të cilin/të cilën kanë lidhje familjare dhe në 5% të rasteve 2 të punësuar të tillë. Megjithatë, 77% e të anketuarave raportojnë se nuk e aplikojnë këtë praktikë.

Mesatarisht, bizneset e drejtura nga gratë e anketuara në këtë studim, kanë 3 gra të tjera të punësuar. Nëse marrim parasysh vetëm ndërmarrjet me më shumë se 1 punonjës, këto sipërmarrëse punësojnë mesatarisht 4 gra të tjera. Kompanitë e drejtura nga gratë e anketuara punësojnë 50% më shumë gra sesa burra.

Figura 28. Numri i kompanive bazuar në bazë të përbërjes gjinore të të punësuarve të tyre



Të dhënat e të anketuarave tregojnë:

- 691 ndërmarrje të drejtura nga gratë punësojnë 1-9 gra;
- 51 ndërmarrje të drejtura nga gratë punësojnë 10-49 gra;
- Vetëm 7 ndërmarrje të drejtura nga gratë punësojnë më shumë se 50 gra.


Në të njëjtën kohë:

- 379 ndërmarrje të drejtuara nga gratë punësojnë 1-9 burra;
- 44 ndërmarrje të drejtuara nga gratë punësojnë 10-49 burra;
- Vetëm 5 ndërmarrje të drejtuara nga gratë punësojnë më shumë se 50 burra.

## Politikat e Burimeve Njerëzore

Shumica e grave sipërmarrëse ose 64.5% e tyre raportuan se biznesi i tyre nuk ka një sistem të menaxhimit të burimeve njerëzore, ndërsa 35.5% iu përgjigjën pozitivisht pyetjes nëse e kanë një sistem të tillë. Nga këta të fundit, **65.9% deklaruan se nuk zbatojnë asnjë nga komponentët e mëposhtëm të burimeve njerëzore në operacionet e tyre të biznesit:** Rekrutimi, mbajtja e punonjësve në punë dhe promovimi i tyre; Mentorimi; Trajnimi i aftësive/ trajnimi për aftësi drejtuese; orari fleksibël i punës; orari i punës me kohë të pjesshme; punë në distancë ose online; leje lindjeje të paguar; leje lindjeje për baballarët; pushime për qëllime të rritjes në karrierë ose për ndryshim karriere; parandalimin e ngacmimeve seksuale; shpërblimet. **Një në tre ndërmarrje të drejtuara nga gratë raportuan se zbatonin në biznesin e tyre praktikatat e burimeve njerëzore.**

Figura 29. Përdorimi dhe mospërdorimi i praktikave të burimeve njerëzore në ndërmarrjet e drejtuara nga gratë



Komponenti më i zakonshëm, më i njohur dhe më i praktikuar i burimeve njerëzore është mentorimi. Praktika të tjera të raportuara në bizneset shqiptare të drejtuara nga gratë janë trajnimi i aftësive, trajnimi për aftësi drejtuese dhe orari fleksibël i punës.

## Mundësi të Barabarta Punësimi, Diversitet dhe Gjithëpërfshirja

Mundësitë e Barabarta të Punësimit (EEO) ndalojnë diskriminimin dhe hakmarrjen dhe përcaktojnë edhe procedurën e raportimit të ankesave. 44.6% e të anketuarave kanë raportuar se e kanë një politikë të mundësive të punësimit, diversitetit dhe gjithëpërfshirjes, ndërsa 55.4% iu përgjigjën negativisht pyetjes nëse kanë të tilla politika. Përkatësia etnike nuk përbën një faktor të veçantë sa u përket mundësive të barabarta të punësimit, diversitetit dhe gjithëpërfshirjes, pasi vetëm 2 nga 5 gra sipërmarrëse që raportuan se ishin egjiptiane, aplikojnë të tilla politika. 55% e grave që u vetë-identifikuan se i përkasin grupit etnik shqiptar u përgjigjën se biznesi i tyre nuk ka një politikë për mundësitë e punësimit, diversitetin dhe gjithëpërfshirjen.

Përveç kësaj, ndërkohë që vetëm 4.9% e të anketuarave raportuan në këtë anketë se kishin një aftësi të kufizuar, 3.2% u përgjigjën se biznesi i tyre nuk ka asnjë politikë lidhur me mundësitë e punësimit, diversitetit apo gjithëpërfshirjes.

## Zgjerimi i biznesit

Nga të gjitha të anketuarat, **52.9% u shprehën se do të dëshironin ta rrisnin biznesin e tyre por nuk kanë mundur ende ta bëjnë këtë**, ndërsa 47.1% u shprehën të kënaqura me madhësinë aktuale të biznesit që drejtojnë.

**Burimet më pak të përdorura për financimin e nevojave të bizneseve gjatë viteve 2019-2020 kanë qenë grantet nga programet qeveritare dhe nga institucionet financiare jo-banka të mikrofinancës.** 6.2% e tyre kanë marrë grante nga organizatat jofitimprurëse, 5% kanë marrë kredi nga bankat tregtare, 2.7% janë ndihmuar nga miqtë dhe të afërmit, ndërsa 2.2% kanë përdorur të ardhurat nga biznesi i vet.

Vetëm 54.4% e bizneseve u përgjigjën se mbajnë kapital rezervë në biznesin e tyre, ndërsa pjesa tjetër iu përgjigj negativisht kësaj pyetjeje.

**57,7% e personave që plotësuan pyetësorin refuzuan t'i përgjigjen pyetjes në lidhje me vlerën e xhiros së përafërt vjetore të biznesit të tyre në vitin 2019.** Nga pjesa tjetër që iu përgjigjën pyetësorit, 3,6% raportuan se në vitin 2019, vlera e përafërt e xhiros vjetore të biznesit të tyre kishte qenë 2,000,000 lekë, për 3,1% të tyre kjo vlerë kishte qenë 1,200,000 lekë, kurse xhiroja për 2,3% të tyre kishte qenë 1,500,000 lekë. 2.9% raportuan se kishin pasur një xhiro vjetore biznesi në vlerën zero lekë në vitin 2019.


**Në vitin 2020**, njësoj si një vit më parë, 57,4% e bizneseve nuk pranuan të përgjigjen. 2.9% raportuan se kishin xhiro vjetore në vlerën zero lekë, kurse

4.5% u përgjigjën se vlera e përafërt e xhiros vjetore të biznesit të tyre kishte qenë 1 000 000 lekë.

**Në vitin 2021**, 56,6% e bizneseve nuk dhanë përgjigje për vlerën e xhiros vjetore të biznesit. 2.8% raportoi se kishte pasur një xhiro vjetore në vlerën 1 200 000 lekë.

Sa i përket deklarimit të fitimit, vihet re e njëjta situatë si me xhiron vjetore të biznesit, ku shumica refuzuan të përgjigjen. Rreth 62% e bizneseve nuk kanë dhënë asnjë përgjigje për vlerën e fitimit të tyre në vitet 2019, 2020 dhe 2021. 4.5% e bizneseve deklaruan se kishin pasur 0 lekë fitim gjatë vitit 2020, ndërsa 3.6% deklaruan se kishin fituar 500 mijë lekë. **51% e bizneseve u përgjigjën se nuk e kishin zgjeruar biznesin dhe nuk e kishin rritur kapitalin gjatë viteve 2019 dhe 2020**, ndërsa **26% u shprehën se burimi kryesor i financimit në ndihmë të biznesit të tyre kishin qenë kursimet e veta personale ose ato familjare.**

Figura 30. Faktorët që ndikojnë në zgjerimin e biznesit



Në përgjithësi, dhe sipas mendimit të të anketuarave tona, faktorët që ndikojnë në zgjerimin ose moszgjerimin e një biznesi në nevojë janë: fuqia blerëse, taksat e larta, kostoja e punësimit të punonjësve të rinj dhe mungesa e stafit të trajnuar, përkatësisht:

- në 46.2% të rasteve mungesa e kërkesës/fuqisë blerëse;
- në 28.4% të rasteve taksat/taksat e larta;
- në 26.5% të rasteve mungesa e financimit;

- në 25.5% të rasteve kostoja e punësimit të punonjësve të rinj;
- në 19.7% të rasteve mungesa e punonjësve të trajnuar etj.
- Pasiguritë e politikave ekonomike, vështirësia për të gjetur lëndën e parë dhe mungesa e informacionit për tregun janë disa nga arsyet e tjera.

## Menaxhimi Financiar në Ndërmarrje

Figura 31. Qasja ndaj analizës periodike financiare



Më shumë se **një e treta (35.8%) e të anketuarave deklaruan se mbajnë llogari të detajuara zyrtare për biz-neset e tyre** dhe pothuajse në të njëjtin nivel (32.6%) ishin të anketuarat që deklaruan se e mbajnë kontabilitetin në një format të thjeshtuar. 3 ndër pesë të anketuara deklaruan se nuk kryejnë asnjë analizë periodike të financave të biznesit të tyre.


Rezultatet tregojnë se pothuajse një në çdo pesë (19%) biznese mbajnë të dhëna informale për përdorim personal dhe **një në çdo dhjetë biznese u përgjigjën se nuk mbajnë asnjë llogari të shkruar për biznesin e tyre**. Kjo e fundit është veçanërisht shqetësuese po të mendosh se edukimi financiar është një nga pengesat e aksesit në financa. Ky është shqetësim edhe për zgjerimin e biznesit, për menaxhimin e financave personale dhe për parashikueshmërinë e ecurisë së biznesit dhe kostove shtesë. Më shumë se gjysma e grave sipërmarrëse ose 55.5% janë përgjigjur se i bëjnë vetë deklaratat tatimore të biznesit, ndërsa 41.9% kanë punësuar një ekonomist(e) dhe **vetëm 2.6% janë përgjigjur se kanë kontraktuar kompani financiare për t'u kujdesur për llogaritë dhe për pagesat e tyre të biznesit**.

## Aksesi në financa

**7 nga 10 gra sipërmarrëse nuk kanë aplikuar asnjëherë për kredi bankare për biznesin e tyre**. Për 65.7% arsyeja e mosaplikimit ishte se nuk kishin nevojë për kredi bankare, për 14.4% se normat e interesit ishin të larta, 6.8% nuk kishin kolateral dhe 5.1% u përgjigjën se procedurat e aplikimit për kredi janë komplekse.




Figura 32. Të dhëna për aplikimet për kredi nga gratë sipërmarrëse



**29.4% e bizneseve kanë aplikuar për kredi.** Nga këto, 63.6% janë përgjigjur se kanë marrë kredi vetëm një herë, 24.6% kanë marrë dy herë, ndërsa 6.8% janë përgjigjur se kanë marrë kredi më shumë se 3 herë.

Bizneset që kanë marrë më shumë se një kredi janë përgjigjur se kredinë e fundit e kanë marrë nga bankat në 95.1% të rasteve. Vetëm 4.9% e bizneseve e kanë marrë kredinë e fundit nga një institucion financiar jo-bankë. **Si kolateral për kredinë, pjesa më e madhe e bizneseve kanë përdorur pasuritë e paluajtshme,** ku 41.2% kanë përdorur biznesin, 31.4% shtëpinë, ndërsa 9.8% janë përgjigjur se kanë marrë kredi pa kolateral.

Figura 33. Shkalla e kredive të marra nga të anketuarit



94.3% e bizneseve që kanë aplikuar për kredi, u është miratuar kredia. Kreditë e miratuara në 45.5% të rasteve kanë qenë deri në 1 milion lekë, në 29.5% të rasteve në masën 1-5 milion lekë, në 17.8% të rasteve në masën 5-20 milion lekë dhe vetëm në 7.2% të rasteve mbi 20 milion lekë. 5.7% e bizneseve që u është refuzuar kredia janë


përgjigjur se e kanë zgjidhur nevojën për financim në biznesin e tyre duke përdorur kursimet e tyre apo kursimet familjare në 56.3% të rasteve, borxhet r marra në tregun informal në 25% të rasteve dhe borxhet nga të afërmit në 18.8% të rasteve.

Arsyet e refuzimit të kreditë përfshijnë të pasurit e një biznesi të paqëndrueshëm në 56.3% të rasteve, mungesën e kolateralit në 37.5% të rasteve dhe një plan

jobindës biznesi në 6.3% të rasteve. Në marrjen e kredive, **44.1% e bizneseve janë shprehur se nuk ka luajtur fakti i të qenit grua**, 23.5% janë përgjigjur se nuk janë të sigurta nëse ka ndikuar gjinia, ndërsa 32.4% janë përgjigjur pozitivisht dhe mendojnë se gjinia ka ndikuar në marrjen e kredisë. Për më shumë se gjysmën e të anketuarve (58.7%), mungesa e financimit nuk ka qenë pengesë për planet e tyre të biznesit. **Vetëm 28.5% kanë pranuar se mungesa e financimit i ka penguar në planet e tyre të biznesit.**

Për të ardhmen, 48,1% e bizneseve janë shprehur se planifikojnë ta rrisin biznesin aktual, 25,3% janë shprehur se do të ruajnë të njëjtin nivel që kanë aktualisht, ndërsa 17,5% kanë ide të reja për ta shtuar ose për ta diversifikuar biznesin.

Figura 34. Planet për të ardhshmen dhe mungesa e financimit




Sa i përket konsulencës në biznes, shumica e të anketuarve ose 39.6% e bizneseve janë shprehur se nevojat e tyre për konsulencë i klasifikojnë si të vogla, 28.9% i klasifikojnë si të mëdha, ndërsa 20% janë shprehur se nuk kanë nevojë për konsulencë në biznese. 11.5% i janë përgjigjur pyetjes me “nuk e di”.

68,7% e bizneseve janë shprehur se e marrin informacionin e nevojshëm për zhvillimet e reja nga shtypi, 16,8% nga shoqatat e biznesit ku bëjnë pjesë, 21,5% nga organizatat me të cilat bashkëpunojnë, ndërsa pjesa tjetër janë përgjigjur se kanë mungesë të madhe informacioni. **Më shumë se 87% e bizneseve të anketuara thanë se aktualisht nuk punojnë me asnjë këshillues biznesi.**

## Ndërtimi i kapaciteteve


Figura 35. Njohuritë mbi edukimin formal ose informal për ngritjen e një biznesi



Tre nga pesë të anketuara deklaruan se nuk kanë dëgjuar për asnjë kurs formal ose informal se si ngrihet një biznes, si për shembull për trajnime mbi mënyrën se si zhvillohet një plan biznesi, për vlerësimin e mundësive të tregut, për identifikimin e mundësive për kapital fillestar dhe për aksesin në to, për zhvillimin e rrjeteve të biznesit, etj. Më shumë se gjysma e këtyre bizneseve, 67% e tyre, janë përgjigjur se do të donin të merrnin pjesë në trajnime të tilla, ndërsa pjesa tjetër prej 33% u përgjigjën negativisht. Pjesa tjetër e bizneseve që kanë deklaruar se kanë dëgjuar për kurse dhe trajnime biznesi, mbeten në nivele të ulëta dhe fokusohen kryesisht në përgjigje të tilla si:

- Kurse dhe trajnime si pjesë e arsimimit shkollor në 13.9% të rasteve;
- Trajnime nga OJQ-të në 12.9% të rasteve;
- Iniciativa personale në 8.8% të rasteve.

Figura 36. Nevojat për trajnim



Në rastet kur ishin në dijeni të organizimit të aktiviteteve dhe trajnimeve në të cilat dëshironin të merrnin pjesë, vetëm 4% deklaruan se nuk kishin marrë pjesë për shkak të kostos. Arsyeja kryesore e mospjesëmarrjes kishte qenë pamundësia për t'u shkëputur prej biznesit në 19.9% të rasteve.

Nevojat për trajnim lidhen kryesisht me:

- Mënyrat e përdorimit të marketingut dixhital në 43.3% të përgjigjeve pozitive;
- Planifikimin për të ardhura më të larta në 38.3% të përgjigjeve;
- Si ta bëjmë biznesin të qëndrueshëm në 32% të përgjigjeve;
- Mbështetjen personale si mirëqenia mendore, stresin në 24.4% të përgjigjeve;
- Menaxhimin e operacioneve të krizës dhe planin e biznesit në 23.7% të përgjigjeve;
- Menaxhimin financiar në 19.5% të përgjigjeve etj.

Nevojat për trajnim që u renditën më ulët janë ato që lidhen me aftësitë e menaxhimit dhe administrimit në 10.6% të përgjigjeve, menaxhimin e burimeve njerëzore në 9.2% të përgjigjeve, kurset e informimit juridik për llojet


e biznesit në 8.8% të përgjigjeve dhe me nevoja të tjera në 3.9% të përgjigjeve, të cilat lidhen specifikiisht me mungesën e kohës ose me mungesën e nevojës për trajnim.

Vetëm 2 nga 5 të anketuara kanë marrë pjesë në trajnime për përdorimin e kompjuterit, për teknologjitë e informacionit dhe komunikimit në aktivitetin e tyre të biznesit (40.7%).

## Aksesi në tregje

### Tregu Lokal

Figura 37. Perceptimi i aksesit në tregje bazuar në aktivitetin ekonomik



**Nëntë nga dhjetë (91.5%) gra sipërmarrëse besojnë se kanë akses të mirë në tregun shqiptar.** Pjesa tjetër prej 8.5% përmendin disa pengesa kryesore për aksesin në treg, si mungesën e fuqisë blerëse, mungesën e informacionit dhe të reklamave, kërkesën më të ulët në treg, konkurrencën etj. Këto të fundit i përkisnin kryesisht aktivitetëve si moda (22%), tregtia me pakicë (22%), zejtaria (11%). Ndërmarrjet në sektorin e tregtisë me pakicë dhe shërbimet e mirëqenies besojnë se aksesin është mjaft i mirë.

### Tregjet e huaja

Pothuajse **katër nga pesë gra sipërmarrëse raportuan se kishin informacion për tregun shqiptar**, ndërsa **vetëm tre në dhjetë u shprehën se kishin informacion të mjaftueshëm për tregjet e huaja.** Nga këto, vetëm 10.6% e të gjitha të anketuarave kishin akses të drejtpërdrejtë në tregjet ndërkombëtare, kryesisht në Itali, Greqi dhe Turqi. Burimi kryesor i informacionit që përdoret

për njohjen e tregut është interneti, media dhe rrjetet sociale, dhe në masë më të vogël kontaktet e drejtpërdrejta, furnitorët ose miqtë dhe kolegët.

### Panairt Kombëtare dhe Ndërkombëtare


Të pyetura për pjesëmarrjen në panaire, 20.3% e bizneseve u përgjigjën se kanë marrë pjesë në panaire kombëtare. Nga këto, 14,8% u shprehën se pas pjesëmarrjes në panair, kontratat e tyre me klientët potencialë janë rritur, ndërsa për 5,5% ka qenë e kundërta. Numri i bizneseve që kanë marrë pjesë në panairt ndërkombëtare është dy herë më i ulët se pjesëmarrja në ato kombëtare. Një në dhjetë gra sipërmarrëse ka marrë pjesë në panaire ndërkombëtare, dhe për 7.6% përvoja kishte qenë shumë pozitive, pasi kontratat e tyre me klientët potencialë ishin rritur. 2.9% nuk e kishin konstatuar të njëjtin fenomen.

### Aksesi në Shërbimet IT dhe përdorimi i tyre

#### Perceptimet e përfitimeve

Perceptimi i shërbimeve dixhitale dhe IT brendapërbrenda kompanive është mjaft pozitiv tek gratë sipërmarrëse. **Pothuajse shtatë në dhjetë prej tyre (67.4%) mendojnë se dixhitalizimi dhe IT e rritin efikasitetin dhe produktivitetin e biznesit.**


Figura 38. Perceptimi i rëndësisë së shërbimeve dixhitale dhe IT



Megjithatë, më shumë se tre në çdo pesë gra sipërmarrëse ose mendojnë se shërbimet dixhitale dhe IT nuk i shërbejnë efikasitetit të biznesit (18.7%), ose të paktën shprehen skeptike (14%).

## Përdorimi i platformave dixhitale

Figura 39. Përdorimi i mediave sociale dhe platformave për praktikatat mësimore



**Ndërmarrjet e drejtuara nga gratë duket se janë të angazhuara në mediat sociale ose në shërbimet dixhitale** për qëllime marketingu/informimi, duke përdorur kështu **platformat dixhitale**.

Më shumë se gjysma e këtyre bizneseve kishin një faqe interneti ose profil në platformat sociale për biznesin e tyre, si 59.9% në Facebook, 57.9% në Instagram, 33.1% një faqe interneti për biznesin dhe vetëm 10.9% përdornin Twitter.

## Përdorimi i Shërbimeve të tjera Dixhitale për Bizneset


Përveç platformave sociale, të anketuarat u pyetën për përdorimin e pajisjeve dixhitale. Ato deklaruan se i përdornin këto pajisje në 70.4% të rasteve për komunikim me klientët; në 51.2% të rasteve për komunikim me furnitorët; në 42.6% të rasteve për promovimin e produkteve/shërbimeve të tyre; në 35.5% të rasteve për gjetjen e klientëve të rinj dhe në 28.3% të rasteve për gjetjen e furnitorëve të rinj etj. Përveç kësaj, ka **një nivel të ulët të përdorimit të softuereve ose teknologjive për qëllime biznesi**. Gratë sipërmarrëse përdorin shumë pak platforma për menaxhimin e projekteve, EIFI nga shtëpia dhe Cloud-in për biznes për të siguruar të punuarin me orare fleksibël ose online.

Ekziston një nevojë urgjente për mbështetjen e grave në biznes me njohuri dixhitale, pasi vetëm 34.9% e të anketuarave raportuan se e përdorin teknologjinë. Kështu, ulen shumë pritshmëritë për depërtimin e e-banking për qëllime biznesi apo për përdorimin e platformave të e-commerce si strategji për zgjerimin e biznesit nga gratë sipërmarrëse.

## Tregtia dhe pagesa online

Vetëm 27.2% e bizneseve shesin produkte/shërbime online brenda Shqipërisë, kurse 71.5% të tjera nuk shesin asgjë online. Është e nevojshme të theksohet se për qëllimet e këtij studimi, procesi i shitjes së produkteve/shërbimeve online nuk kufizohet vetëm në aktivitetet e tregtisë elektronike, por përfshin edhe thjesht porositjet online. Vetëm 1.4% raportuan se kanë pasur kërkesa për të shitur online, por se ato nuk i kanë njohuritë për ta ofruar një shërbim të tillë.

Figura 40. Pagesat online në ndërmarrjet e drejtuara nga gratë



Vetëm 14.7% e sipërmarrjeve të drejtuara nga gratë ofronin opsionin e blerjes online jashtë Shqipërisë.

**50.4% e bizneseve kanë akses në aplikacionet bankare** (online banking) nëpërmjet telefonit/kompjuterit. Ndërkohë, **vetëm tre nga dhjetë biznese ofrojnë mundësinë e pagesave online** për


produktet/shërbimet që ofron biznesi i tyre.

## Përdorimi i Portaleve Qeveritare

### Platforma e-Albania

Më shumë se gjysma e të anketuarave (55.3%) e kanë pranuar ndikimin pozitiv të portalit qeveritar e-Albania dhe të shërbimeve online të ofruara brenda kësaj platforme. Ndërkohë, 18.7% raportuan se ofrimi i shërbimeve të tilla online përmes platformës ka krijuar vështirësi, pasi nuk mund t'i përdorin ato, pjesa tjetër raportoi se këto ndryshime nuk përbëjnë asnjë problem. Nga ana tjetër, 55.3% besojnë se aksesin në shërbimet publike nëpërmjet e-Albania ua ka lehtësuar procedurat e kreditimit.

Figura 41. Perceptimi për shërbimet dixhitale të ofruara nga qeveria (e-Albania, e-filing, Taksat e mia)






67.6% e sipërmarrjeve të drejtuara nga gratë janë përgjigjur se shërbimet dixhitale dhe shërbimet online si e-Albania, e-filing, Taksat e Mia, ua kanë lehtësuar procedurat e dorëzimit të dokumenteve tatimore, kurse 19.7% e të anketuarave raportuan se nuk janë prekur nga këto ndryshime. Megjithatë, për 12.7% të të anketuarave, këto shërbime online ua kanë vështirësuar aktivitetin e biznesit.

*Procesi i fiskalizimit*

Për zbatimin e procesit të *fiskalizimit*, 38.8% e bizneseve janë përgjigjur se nuk kanë hasur vështirësi. Pothuajse i njëjti numër ndërmarrjesh të drejtuara nga gratë mbështeteshin tek një palë e tretë (një ekspert) për zbatimin e këtij sistemi. Një ndër pesë gra sipërmarrëse (21.5%) pranoi se kishte hasur shumë vështirësi, ndërsa 7.6% nuk e kanë zbatuar ende.

*Figura 42. Përvoja e të anketuarave me procesin e fiskalizimit*



Më shumë se gjysma e të anketuarave (51.4%) e perceptojnë informacionin publik mbi *fiskalizimin* që ofrohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si shumë të dobishëm dhe të qartë. Një e katërta e të anketuarave mendojnë se ky informacion është i mirë, por ato ende kanë nevojë për më shumë ndihmë, dhe pothuajse e njëjta përqindje e të anketuarave (23.6%) e konsiderojnë informacionin në faqen e taksave më shumë si konfuz.

**Rrjetet**

Nga 953 biznese që morën pjesë në këtë sondazh, vetëm 6% (57 biznese) u përgjigjën se janë pjesë e një rrjeti biznesesh në Shqipëri dhe vetëm **3.9% ishin pjesë e një rrjeti të dedikuar grave në biznes**. *Rrjetet e raportuara të grave përfshijnë Dhomën Ekonomike të Grave, Rrjetin e Grave Parukiere, Shoqatën Kombëtare të Grave Profesioniste, Biznesmene dhe Artizane të Shqipërisë. Rrjete të tjera të përgjithshme përfshinin Shoqatën e Bukurisë Shqiptare, Rrjetin e Farmacistëve Shqiptare, Dhomën Shqiptare të Diasporës dhe Dhomën Shqiptare të Avokatisë.*

49.9% u përgjigjën se do të donin të merrnin pjesë në një rrjet të tillë, kurse 42.5% ose nuk kishin kohë të merrnin pjesë, ose nuk shihnin ndonjë përfitim nga rrjetet e biznesit. Pjesëmarrja në rrjetet e ndryshme të biznesit është

përgjithësisht e ulët (më pak se një ndër dhjetë gra sipërmarrëse). E ulët është edhe pjesëmarrja në rrejet rajonale (7.2%) dhe në rrejet ndërkombëtare (2.8%).

## Ndikimi i COVID-19


Gjatë gjithë pyetësorit, ndërmarrjet e drejtuara nga gratë u pyetën nëse kishte ndikuar pandemia në biznesin e tyre dhe, nëse po, si kishte ndikuar.

- 38.6% e bizneseve u përgjigjën se pandemia Covid-19 kishte ndikuar tek aksesin e tyre te klientët, tregjet ishin mbyllur ose ishin reduktuar plotësisht; 28.3% u përgjigjën se e kishin ndërprerë përkohësisht furnizimin; për 25.1% të bizneseve, prodhimi ose shërbimet ishin ulur/ ndaluar, ndërsa për 18.8% kishte pasur ulje të stafit dhe shkurtim të orarit të punës.
- Vetëm 1.8% u përgjigjën se pandemia COVID-19 kishte ndikuar te biznesi i tyre, duke i çuar në falimentim.

Rreth **gjysma e ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë (46.5%) raportuan se kishin vështirësi për të mbijetuar në biznes** për shkak të ndikimit që kishte pasur mbyllja/reduktimi i aktiviteteve. **Dy ndër pesë sipërmarrëse (19.5%) pranuan se ishte stafi ai që i vuante pasojat.** Mbështetja e preferuar pas pandemisë përfshin mbështetjen financiare për 55.4% të bizneseve, trajnimet për 14.5% të bizneseve dhe mentorimin/këshillimin nga një profesionist/ ekspert për 12.6% të bizneseve, etj.

Ndërkohë, **nga masat e marra nga qeveria shqiptare, vetëm 28.2% raportuan se kishin marrë drejtpërdrejt pagesa për punonjësit.** Shumica, rreth 64% e bizneseve, u përgjigjën se për bizneset e tyre nuk ishte marrë asnjë masë e tillë dhe se biznesi i tyre nuk kualifikohej për asnjë shpërblim. Ndërkohë, **vetëm 1.8% e bizneseve kishin marrë kredi me garanci sovrane.**

Figura 43. Përqindja e përfituesve të masave të marra nga qeveria shqiptare




Nga bizneset që kanë përfituar njëfarë mbështetjeje, 21% kanë përfituar pagë pune për tre muaj (në nivelin e pagës minimale të parashikuar me ligj, 26 000 lekë/muaj).

Vetëm 1.8% kanë marrë mbështetje përmes Politikave Aktive të Tregut të Punës, për ripunësimin e stafit të tyre (paga dhe subvencione për sigurimet shoqërore në varësi të programeve specifike). Kategoritë e tjera që kanë marrë një pagesë për vetëm një herë, ofruar si ndihmë financiare për të gjithë punonjësit, përbëjnë një pjesë shumë të vogël të totalit.

## Financat e biznesit përkundrejt financave personale

Figura 44. Ndarja e financave të biznesit nga ato personale




Rreth gjysma e grave sipërmarrëse (46.5) duan t'i ndajnë financat e biznesit nga ato personale, 16.8% duan që t'i ndajnë, por e kanë të vështirë ta bëjnë këtë. Më shumë se 3 ndër 10 gra sipërmarrëse (36.7%) i mbajnë bashkë financat e biznesit me buxhetin e tyre personal.

54.5% e bizneseve hartojnë një buxhet për financat e tyre personale, ndërsa pjesa tjetër jo. 29% e bizneseve i kanë analizuar financat e tyre personale për herë të fundit muajin paraardhës, ndërsa

21.3% e tyre në fillim të vitit. 47.8% zgjedhin të mos e bëjnë këtë si praktikë.


## Njohuritë financiare dhe sipërmarrëse

Figura 45. Njohuritë mbi treguesit financiarë të biznesit të tyre



Vetëm 21.7% e grave sipërmarrëse pjesë e këtij studimi deklarojnë se i kuptojnë plotësisht treguesit financiarë të biznesit të tyre. Kështu, vetëm një ndër pesë gra sipërmarrëse i “përdorin” ato plotësisht në biznesin e tyre, ndërsa dy në pesë gra nuk kanë asnjë njohuri për treguesit financiarë. Ndërkohë, siç u përmend më herët, rreth 60% e bizneseve nuk kanë kryer analiza periodike të treguesve financiarë të biznesit të tyre. Kjo përputhet me faktin se 40.1% e tyre nuk ishin të njohura me treguesit kryesorë financiarë të biznesit, kurse 38.2% kuptonin vetëm termat bazë.

Figura 46. Pjesëmarrja në trajnimet për financat personale dhe të biznesit



Nga përgjigjet duket lehtësisht se sa të rëndësishme janë trajnimet për biznesin e tyre. Megjithatë, **të anketuarat nuk marrin trajnime në lidhje me financat edhe pse kjo duket aq e rëndësishme. Tre ndër pesë të anketuara (63.8%) raportojnë se nuk kanë marrë kurrë mësim/trajnime në lidhje me financat e biznesit.** Vetëm 27.6% kanë marrë kurse trajnimi falas. Rezultate të ngjashme vërehen edhe për mësimet/trajnimet lidhur me financat personale, ku pothuajse shtatë nga dhjetë (68.4%) të anketuara nuk kanë marrë asnjëherë trajnime të tilla, ndërsa 24.3% kanë zgjedhur t’i marrin këto trajnime falas.

Rreth katër ndër pesë gra sipërmarrëse e konsiderojnë pjesëmarrjen në trajnime për zhvillimin e tyre personal dhe/ose të biznesit një investim shumë të mirë, pavarësisht pjesëmarrjes ose jo në to. Ekziston qartë

një mospërputhje mes perceptimit të rëndësisë së këtyre trajnimeve dhe përqindjes së sipërmarrësve që marrin pjesë në to. Mes pjesëmarrësve në këto trajnime, raporti i pjesëmarrjes në trajnime me pagesë dhe në trajnime falas është 1:7.5 (për pjesëmarrjen e një gruaje sipërmarrëse në trajnime me pagesë janë më shumë se 7 sipërmarrëse që marrin pjesë në një trajnim falas) për trajnime për financat personale dhe 1:6 për trajnime lidhur me financat e biznesit. Ka një angazhim më të madh në trajnimet për financat e biznesit, por pjesëmarrja në trajnime falas e tejkalon opsionin e trajnimit me pagesë. Kështu, nëse politikëbërësit synojnë të përmirësojnë njohuritë mbi menaxhimin financiar, financat e biznesit dhe mbi të gjitha financat personale, ato duhet të rrisin aksesin në mundësitë për trajnime dhe në kurset e ngritjes së kapaciteteve.

Figura 47. Planet e Biznesit dhe Krijimi i Biznesit



E njëjta nevojë vlen edhe kur diskutohen planet e biznesit, operacionet e biznesit. Një e katërta e të anketuarave raportojnë se nuk kanë pasur ndonjë plan biznesi përpara se ta krijojnë biznesin e tyre. Rreth gjysma (46%) kanë përgatitur një plan të thjeshtë biznesi, ndërsa vetëm 23.6% kanë pasur një plan të detajuar të cilin vazhdojnë ta zbatojnë.

Këto të dhëna janë një thirrje urgjente për ndërhyrje në aspektin e edukimit financiar dhe aftësive sipërmarrëse. Kjo mund të nxisë diskutime mbi nevojën për disa komponentë shumë themelore të edukimit si sipërmarrës. Edhe pse raportohet se ka pasur progres në raportet ndërkombëtare (OECD, 2022), ndikimi afatgjatë i kurrikulave të fokusuara tek sipërmarrja duhet të vazhdojë të shfrytëzohet. Kështu, për momentin, kurset trajnuese “tradicionale” për gratë sipërmarrëse, apo për gratë sipërmarrëse potenciale vazhdojnë të jenë shumë relevante.

# Raste studimi aktuale nga rajoni i Ballkanit Perëndimor: Aksesi në Financa

Një rishikim i literaturës dhe i të dhënave tregon se ndër faktorët më të rëndësishëm, por më kompleksë në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor është aksesit në financa.<sup>95</sup> Për këtë qëllim, në këtë kapitull bëhet një përpjekje për të sjellë disa raste studimore të mënyrave të suksesshme për rritjen e aksesit në financa në disa vende të rajonit.

## *Kutia 2. Rast Studimi #1:*

### *Fuqizimi i Grave dhe Promovimi i Sipërmarrjes në Shqipëri*

Bashkia e Tiranës zbaton që nga viti 2021 një program të ri në mbështetje të sipërmarrjeve të grave në fushën e turizmit, TIK-ut, industrisë tekstile, shërbimeve dhe artizanatit. Fondi për Gratë Sipërmarrëse krijohet nëpërmjet Komitetit Kombëtar të Ndihmës Shtetërore, nën kujdesin e Aleancës së Grave të Këshillit Bashkiak.

Kjo nismë synon gratë sipërmarrëse nga mosha 18 deri në 60 vjeç, me fokus të veçantë tek gratë në zonat rurale, kryefamiljaret dhe gratë me aftësi të kufizuara, gratë nga komunitetet rome dhe egjiptiane dhe nga grupe të tjera vulnerabel. Fondi i fundit përfshin një buxhet vjetor prej të paktën 10 milionë lekësh, në dispozicion të bizneseve ekzistuese dhe bizneseve të reja në shumën 500 000 lekë. Nuk ka ende asnjë provë mbi ndikimin që ka pasur kjo mundësi.

## *Kutia 3. Rast Studimi #2:*

### *Programi për Inkurajimin e Zhvillimit të Sipërmarrjes në Serbi*

Qeveria e Serbisë prezantoi në vitin 2021 një program në mbështetje të grave sipërmarrëse. Programi mundëson një kuadër financiar që përfshin financim të përzier, me një kombinim të granteve (deri në 35% të vlerës së investimit, ose deri në 45% të vlerës së investimit) dhe një kredie të favorshme nga Fondi i Zhvillimit (deri në 65% të vlerës së investimit).

<sup>95</sup> Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC). 2023. Rishikim Krahasues: Sipërmarrja e grave në Ballkanin Perëndimor.

Kushtet për kreditë e përfshira në program janë të favorshme dhe variojnë nga 1%-2% në vit. Buxheti total i planifikuar për vitin e parë ishte 850 000 euro. Nuk ka evidenca publike mbi ndikimin e granteve.

*Kutia 4. Rast Studimi #3: Mbështetja përmes Njërive të Qeverisjes Vendore në Mal të Zi*

Mali i Zi prezantoi në vitin 2018 një iniciativë të re me mbështetjen e partnerëve të zhvillimit si UNDP, me mbështetjen e një grupi informal të grave përfaqësuese në Parlament dhe këshillat lokale, të njohur si Rrjeti Politik i Grave. Kjo iniciativë synonte të trajtonte në nivel lokal disa nga çështjet më të ngutshme sa i përket aksesit në financa, siç është mungesa e instrumenteve të larmishme financiare.<sup>96</sup> Komunitatet kanë përfshirë financimin përmes granteve në buxhetet e tyre vendore. Aktualisht nuk ka asnjë evidencë për ndikimin e granteve të tilla.

*Kutia 5. Programi i BERZH-it Gratë në Biznes në Ballkanin Perëndimor*

BERZH-i themeloi në vitin 2014 Programin Gratë në Biznes, me mbështetjen e donatorëve, duke synuar të ndihmojë gratë sipërmarrëse në rajon që të rrisin bizneset e tyre dhe të bëhen më konkurruese. Ky program zbatohet me bashkëpunimin e 13 institucioneve financiare në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ndërmarrjet mund të kualifikohen për të marrë pjesë në këtë program vetëm nëse përgjegjësia e përgjithshme e menaxhimit operacional të kompanisë mbahet nga një grua, duke siguruar kështu akses në linjat e kreditit të bankave lokale dhe të institucioneve financiare jo-bankare dedikuar bizneseve të vogla dhe të mesme që drejtohen nga gratë. Në një raport të vitit 2022, BERZH-i deklaroi se sipërmarrjet e drejtuara nga gratë kishin përfituar mbi 65 milionë euro ose financime nga ky program. 96% e bizneseve i rritën të ardhurat e tyre, kurse 94% e përfituesve rritën numrin e punonjësve, duke krijuar afro 3000 vende pune në rajon. BERZH-i raporton se 60% e këtyre kredive janë marrë nga gratë në zonat rurale dhe më pak të zhvilluara<sup>9798</sup>.

<sup>96</sup> Federata Malazeze e Punëdhënësve. 2013. Vlerësimi i mjedisit për sipërmarrjen e grave në Mal të Zi

<sup>97</sup> BERZH. 2022. Programi Gratë në Biznes. Gjendet në: <https://ebrdwomeninbusiness.com/about.xhtml>

<sup>98</sup> BERZH. 2022. BERZH-i dhe donatorët mbështesin 5000 biznese të drejtuara nga gratë në Ballkanin Perëndimor. Gjendet në: <https://www.ebrd.com/news/2022/ebrd-and-donors-support-5000-women-led-businesses-in-western-balkans-.html>

# Përfundimet kryesore

Në këtë kapitull shtjellohen disa nga diskutimet në këtë raport dhe punën e vazhdueshme të Qendrës së Aleancës Gjimore për Zhvillim për sipërmarrjen e grave, për punësimin e grave dhe për barazinë gjimore.

## *Kutia 6. Sugjerimet për veprim*

### **Sugjerimet që vlejné për secilën fushë**

- Ruajtja e ritmit të zhvillimit dhe rivitalizimi i platformave ekzistuese të dialogut publik-privat.
- Sigurimi i anketave periodike dhe të krahasueshme për të vlerësuar sipërmarrjen e grave dhe për të zhvilluar tendencat dhe politikat.

### **Sugjerimet në nivel politikash**

- Marrja e masave që sipërmarrja e grave të jetë në vëmendje të të gjitha dokumenteve strategjike, duke përfshirë edhe Strategjinë e ardhshme Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
- Angazhimi përmes planeve konkrete të veprimit për sipërmarrjen, me masa të barabarta për gratë sipërmarrëse.
- Angazhimi për të siguruar një konsultim të plotë publik të Programit të Reformës Ekonomike. Rritja e pjesëmarrjes së organizatave të shoqërisë civile.
- Angazhimi për mbështetjen e grave në biznes për të pasur akses në financa, në marketing dhe akses në tregti si barrierat kryesore për rritjen e biznesit.
- Ngritja e programeve të posaçme për grupet e bizneseve dhe për bizneset e reja të drejtuara nga gratë, për të mbështetur dhe për të nxitur shpërndarjen e grave sipërmarrëse në të gjithë sektorët e ekonomisë, veçanërisht në sektorët strategjikë;
- Marrja e masave të reja pilot për të mbështetur kalimin e grave drejt vetëpunësimit.
- Sigurimi i investimeve në kapitalin njerëzor për gratë gjatë gjithë ciklit jetësor, nga zhvillimi në fëmijëri deri te rritja e aftësive dhe inkurajimi i sipërmarrjes.



– Mbështetje për bizneset e drejtuara nga gratë për akses në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare. Strategjia e ardhshme e eksportit që do të zhvillohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet të ketë një qasje me ndjeshmëri gjinore.

### **Sugjerime për Të Dhënat Gjinore dhe Vizibilitetin e tyre**

– Angazhimi i drejtpërdrejtë i akademisë në përpjekjet për të rritur disponueshmërinë e të dhënave gjinore.

– Krijimi i një aleance për më shumë të dhëna të ndara sipas gjinisë, statistika të forta gjinore dhe analiza të të dhënave me ndjeshmëri gjinore.

– Instituti i Statistikave duhet të zhvillojë dhe të paraqesë një seksion dedikuar sipërmarrjes së grave ose një Kartë Vlerësimi gjinor.

– Qeveria duhet të iniciojë një qasje të automatizuar të përpunimit të të dhënave me ndjeshmëri gjinore brenda çdo sistemi që mbledh të dhëna në sektorin publik. Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit duhet të zhvillojë një qasje horizontale që duhet të zbatohet nga institucionet publike.

### **Sugjerimet për ndërmarrjet e drejtuara nga gratë**

– Duhet të shihet ndërgjegjësimi i grave sipërmarrëse si një mjet për mentorimin, rrjetëzimin dhe për rritjen e angazhimit të grave sipërmarrëse në politikat pozitive gjinore brenda dhe jashtë biznesit të tyre. Duhet të shfrytëzohen mundësitë që jep fuqia e rrjetëzimit, duke u bërë një palë e fortë interesi për publikun.

– Duhet të promovohen parimet e Fuqizimit të Grave që kompanitë të regjistrohen dhe të iniciojnë një proces për ta pasur barazinë gjinore ndër parimet e tyre më të forta drejtuese.

### **Sugjerimet për ngritjen e kapaciteteve dhe nevoja për trajnim**

– Duhet të vazhdojnë iniciativat që mbështesin trajnimin e grave në biznes. Duhet të zhvillohen edhe trajnime të tjera pa pagesë për t'i prezantuar gratë sipërmarrëse ose gratë që aspirojnë të bëhen sipërmarrëse me njohuritë bazë për politikat e burimeve njerëzore, menaxhimit financiar të biznesit dhe financave personale.

– Ndërgjegjësimi për ndikimin pozitiv të shërbimeve dixhitale, së bashku me trajnimet janë thelbësore për t'u siguruar që bizneset e drejtuara nga gratë, veçanërisht ato të voglat, të mos preken fuqishëm nga ndryshimet teknologjike.

### **Sugjerimet për mbështetjen jo-financiare**

– Rritja dhe forcimi i shërbimeve mbështetëse për gratë, duke filluar me kujdesin ndaj fëmijëve, duke lehtësuar barrën e atyre grave që duan të angazhohen në sipërmarrje dhe të mbështesin gratë sipërmarrëse për një ekuilibër më të mirë mes punës dhe jetës.

### **Sugjerime për aksesin në financa**

– Rritja e aksesit në financa përmes kombinimit të disa instrumenteve financiare.

– Eksplorimi i mundësive për zbatimin e disa programeve të ngjashme me programin e zbatuar në Serbi.

– Vazhdimi i përvojës pozitive duke mbështetur edhe bizneset e drejtuara nga gratë në nivel lokal. Marrja e masave që kjo iniciativë të zgjerohet edhe në bashki të tjera.

– Kombinimi i mbështetjes financiare për rritjen e njohurive dhe për edukimin e bizneseve: zbatimi i modeleve të financimit që synojnë ndërmarrjet e drejtuara nga gratë dhe forcimi i të mësuarit të aftësive sipërmarrëse dhe edukimit financiar, veçanërisht në zonat rurale.

### **Sugjerime për edukimin me aftësi financiare dhe sipërmarrëse**


– Rritja e edukimit për sipërmarrjen dhe zbatimi i rekomandimeve të Aktit të Biznesit të Vogël për Shqipërinë. Ky mund të jetë një nga faktorët e paktë përcaktues në formësimin e strukturës së sipërmarrjeve të grave, duke kaluar nga persona fizikë pa punonjës, në kompani më të strukturuar dhe më të mëdha.

# Anekset

## Aneksi 1. Informacion shtesë për të anketuarat


Pyetësorit iu përgjigjën 1002 persona, nga të cilët vetëm 1 prej tyre jetonte jashtë vendit, ndërsa 99.9% ose 1001 të anketuara janë përgjigjur se jetonin në Shqipëri.

*Figura 48. Mosha e të anketuarve*




- Të anketuarat kanë lindur nga viti 1951 deri në vitin 2004, pra janë të moshës 18 deri 71 vjeç. 2 nga 1001 gra sipërmarrëse ishin 18 vjeç. 4 kanë lindur në fillim të vitit 1951 dhe janë 71 vjeç.
- Shumica e grave të pyetura, 44 prej tyre, i përkasin kategorisë së moshës 48-vjeçare dhe kanë lindur në vitin 1974.
- Po kështu, 44 të tjera kanë lindur në vitin 1990, pra janë 32 vjeç, ndërsa 43 nga të anketuarat kanë lindur në vitin 1987 dhe janë 35 vjeç.

Figura 49. Përkatësia etnike e të anketuarave në bazë të vetëdeklarimit



- 95.7% e grave sipërmarrëse që iu përgjigjën pyetësorit janë identifikuar si shqiptare.
- 2.9% e të anketuarave kanë raportuar se i përkasin grupit etnik egjiptian.
- Secili nga grupet e mbetura përfaqëson më pak se 1% të kampionit të studimit.


Figura 50. Mosha e grave sipërmarrëse kur nisin një biznes



Nga të gjitha të anketuarat, vetëm 5 gra e kanë themeluar biznesin e tyre në vitin 1990, duke pasur sot një jetëgjatësi biznesi prej 33 vjetësh. Prej tyre, 3 ishin **31 vjeç** kur kanë krijuar firmën e tyre.

- Në vitin 2000 e kanë themeluar biznesin e tyre 36 gra, 6 prej të cilave (16.7%) ishin **34 vjeç** në atë kohë, ndërsa 5 gra (13.9%) ishin 26 vjeç.
- Në vitin 2010 e kanë filluar biznesin 56 gra, 6 prej të cilave (10.7%) kanë lindur në vitin 1990 dhe kanë qenë 20 vjeç kur e kanë regjistruar biznesin e tyre për herë të parë.
- Në vitin 2015 e kanë nisur biznesin 80 gra, 13 prej të cilave (16.3%) kanë lindur në vitin 1976 dhe kanë qenë 39 vjeç kur kanë regjistruar biznesin e tyre për herë të parë.
- Në vitin 2021 e kanë nisur biznesin e tyre 109 gra, 14 prej të cilave (12.8%) kanë lindur në vitin 1993 dhe kanë qenë 28 vjeç kur kanë regjistruar biznesin e tyre për herë të parë.

*Figura 51. Numri total i punonjësve me pagesë që punësojnë bizneset në mënyrë të vazhdueshme*



Një përqindje e lartë biznesesh prej 16.1% janë përgjigjur se nuk kanë aktualisht asnjë punonjës me rrogë në biznesin e tyre.

# Referenca dhe Bibliografi

- A. Demirguc-Kunt et al. 2018. Databaza Globale Findex 2017: Matja e Përfshirjes Financiare dhe Revolucionit të Teknologjisë Financiare. Uashington, D.C., Grupi i Bankës Botërore AFD. Si ndikon fertiliteti në punësimin e grave? Të dhëna nga Shqipëria. Dokumente Kërkimore. 2022
- AFI, 2017. Raport i sondazhit mbi politikat e financimit të NVM-ve për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në pronësi të grave dhe për gratë sipërmarrëse.
- Aliyeva, Y., dhe Zeynalova, B., 2016. Vlerësim i politikave për sipërmarrjen e grave dhe sondazh mbi gratë sipërmarrëse.
- Allen, I.E., Elam, N., Langowitz, N. dhe Dean, M. (2007), Raporti i Monitoruesit Global të Sipërmarrjes mbi Gratë dhe Sipërmarrjen, Babson College, Babson Park, MA dhe London Business School, Londër
- Banka Botërore 2014. Mbështetja e grave sipërmarrëse me potencial të lartë rritjeje. Dokument mbi politikat e inovacionit, teknologjisë dhe sipërmarrjes; nr. 5. Uashington, DC: Grupi i Bankës Botërore
- Banka Botërore. 2019. Shqipëria do të Rrisë Barazinë Gjimore në Aksesin ndaj Mundësive Ekonomike me Mbështetjen e Bankës Botërore. Washington DC.
- Banka Botërore. 2022. Burime për Sipërmarrjen Femërore.
- BERZH. 2022. BERZH-i dhe donatorët mbështesin 5000 biznese të drejtuara nga gratë në
- Ballkanin Perëndimor. Gjendet në: <https://www.ebrd.com/news/2022/ebrd-and-donors-support-5000-womenled-businesses-in-western-balkans-.html>
- BERZH. 2022. Programi Gratë në Biznes. Gjendet në: <https://ebrdwomeninbusiness.com/about.xhtml>
- Bezhani. M. 2001. Gratë Sipërmarrëse në Shqipëri, Gjenevë, Organizata Ndërkombëtare e Punës.

- Bhogaita M, New Model Advisor, 2011. ‘Kompanitë me një historik më të mirë të promovimit të grave kanë performancë më të mirë në investime’
- Brown, D., Brown, D. dhe Anastasopoulos, V. (2002) Gratë në Borde: Jo Thjesht Gjëja e Duhur . . . Por Gjëja “e Shkëlqyer”, Raport, 341-02: Bordi i Konferencave i Kanadasë, Otava.
- Chakava, A. L., Mworira, M., Moshe, M., Mbinya, J., Magaga, S., Gachoki, L., 2017. Sondazh për të eksploruar barrierat ndaj rritjes me të cilat përballen sipërmarrëset femra në Afrikën Lindore, Rrjeti i Trustit Graça Machel.
- Deloitte Albania. 2022. Të Bërit Biznes në Shqipëri: Një Udhërrëfyes Krahasues.
- Deloitte. 2014. SheXO: Gratë në Biznes – Duke Fituar Pushtet. Tiranë. Shqipëri
- Drumea I. 2013. Vlerësim i mjedisit për sipërmarrjen e grave në Republikën e Moldavisë. Confederația Națională a Patronatului din Rep. Moldova. Chișinău; S. n., 2013 (Tipogr. „Sofart Studio”).48 p
- Federata Malazeze e Punëdhënësve. 2013. Vlerësimi i mjedisit për sipërmarrjen e grave në Mal të Zi
- Fondas, N. dhe S. Sasselos (2000). “Një Zë Ndryshe në Sallën e Bordit: Si Ndikon Prania e Drejtoreve Gra në Influencën e Bordit mbi Menaxhimin.” Fokus Global, 12: 13-22.
- Forumi Ekonomik Botëror. Raporti Global i Hendekut Gjiner 2022. 13 korrik 2022
- Gratë në Borde, 2011. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. [https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/31480/11-745-women-on-boards.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/31480/11-745-women-on-boards.pdf)
- Gratë në sallën e bordit i ndihmojnë kompanitë të kenë sukses – artikull i Times, 19 mars 2009 – Profesor Nick Wilson LUBS
- Gratë Sipërmarrëse në Shqipëri, Bezhani. M. Gjenevë, Organizata Ndërkombëtare e Punës, 2001
- Grupi i Bankës Botërore. 2019. Anketat e Sipërmarrjes. Profili i Shqipërisë 2019. Uashington DC.
- Hashi, I., & Krasniqi, B. A. (2011). Sipërmarrja dhe rritja e NVM-ve: Të dhëna nga ekonomi të përparuara dhe ato në tranzicion. Revista Ndërkombëtare e Kërkimit & Sjelljes Sipërmarrëse, 17, 456-487.10.1108/13552551111158817



Hoobler, J. M., Grace, L., Wayne, S. J. Nënperfaqësimi i grave në postet e menaxhimit të lartë: Ide të reja për të kuptuar një problem të vazhdueshëm. *Dinamikat Organizative* (2011) 40, 151–156

Hyrja e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030

ILO (2016). Vlerësim i Zhvillimit të Sipërmarrjes së Grave. Egjipt

ILO. 2020. Sondazh mbi Gratë që Drejtojnë Biznese Mikro, të Vogla dhe të Mesme lidhur me Sfidat Kryesore që Hasin si Rezultat i Krizës së Koronavirusit

ILO. 2020. Vlerësim i Zhvillimit të Sipërmarrjes së Grave. Mjanmar

INSTAT. 2020. Statistikat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: OZhQ 5 – Barazia Gjinore.

INSTAT. 2021. Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2021. Tiranë. Shqipëri

INSTAT. 2022. Seti Minimal i Treguesve Gjinorë. Tiranë, Shqipëri.

INSTAT. Anketa e Forcave të Punës: Tremujori i Tretë 2022, Njoftim për Shtyp. 2022

Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE), 2016. Gjinia në Sipërmarrje.

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC). 2023. Analizë Krahasuese: Sipërmarrja e Grave në Ballkanin Perëndimor. (e papublikuar)

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC). 2023. Sipërmarrja e Grave në Shqipëri. (e papublikuar)

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. 2021, Përfitimet ekonomike të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. 2022. Punësimi i Grave në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor.

Komisioni Evropian. (2014). Një Rol më i Fortë i Sektorit Privat në Rritjen Përfshirëse dhe të Qëndrueshme të Vendeve në Zhvillim, Komunikim nga Komisioni drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetit të Rajoneve.

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52014DC0263&qid=1400681732387&from=EN>

Komisioni Evropian. 2022. Raporti për Shqipërinë 2022. Bruksel. Belgjikë

Ligji 25/2022 “PËR MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E STARTUP-EVE”, Neni 1.

Ligji 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, Neni 14.

Ligji nr. 1769, datë 9.11.1993

Ligji nr. 8137, datë 31.07.1996

Ligji nr. 9052, datë 17.04.2003

Marcotte, C. (2014). Sipërmarrja dhe inovacioni në ekonomitë në zhvillim: Çështje konceptuale, metodologjike dhe kontekstuale. Revista Ndërkombëtare e Kërkimit & Sjelljes Sipërmarrëse, 20, 42–65.10.1108/IJEBR-09-2012-0089

McKinsey & Company, 2007. “Gratë Kanë Rëndësi: diversiteti gjinor, një faktor nxitës i performancës së korporatës”.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. 2019. Raporti Kombëtar për Zbatimin e Platformës për Veprim Pekin+25. Tiranë. Shqipëri

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. 2022. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian. Gjendet në: <https://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/en/anetaresimi-ne-be/plani-kombetar-i-integrimit-pkie/>

Monitoruesi Global i Sipërmarrjes

N. Wellalage and S. Locke: “Qasja në kredi nga NVM-të në Azinë Jugore: a përballen gratë sipërmarrëse me diskriminim?” në Organizata Ndërkombëtare e Punës. 2020. Dokument Politikash. Përgjigjja ndaj COVID-19: Të kuptojmë saktë barazinë gjinore për një të ardhme më të mirë për gratë në punë. Maj 2020

Neni 18 i Kushtetutës së Shqipërisë

Neni 4. Ligji 9970, datë 24.7.2008 “Për Barazinë Gjinore në shoqëri”

Neni 54 i Kushtetutës së Shqipërisë

OECD (2013). *Perspektiva dhe Situata e Shkencës, Teknologjisë dhe Industrisë*.

OECD et al. 2019, Indeksi i Politikave të NVM-ve: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2022: Vlerësim i Zbatimit të Aktit të Biznesit të Vogël për Evropën, Indeksi i Politikave të NVM-ve, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/g2g9fa9a-en>.

OECD. 2022. “Shqipëria: Profili i Ekonomisë”, në Indeksi i Politikave të NVM-ve: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2022: Vlerësim i Zbatimit të Aktit të Biznesit të Vogël për Evropën, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/d22fdb37-en>.

- Organizata e Kombeve të Bashkuara, 2018. Matja e Sipërmarrjes nga Perspektiva Gjinore: Mësimet e Nxjerra nga Projekti EDGE
- Organizata e Kombeve të Bashkuara. 1985. Strategjitë e Ardhshme të Nairobiit për Përparimin e Grave. Gjendet në: <https://www.un.org/womenwatch/confer/nfls/Nairobi1985report.txt>
- Organizata Ndërkombëtare e Punës, Gratë Sipërmarrëse në Shqipëri, Bezhani. M. Gjenevë, Organizata Ndërkombëtare e Punës, 2001
- Parimet e Fuqizimit të Grave (WEP). Uebfaqja. Harta Interaktive e Nënshkruesve të WEP. Shqipëria. Aksesuar më 12 dhjetor 2022
- Parimet e Fuqizimit të Grave. Faqja ueb: <https://www.WEPs.org/>
- Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim. (Topi E.). 2021. Ri-lançimi i Sipërmarrjes së Grave në Shqipëri – Vlerësim i Shpejtë i Zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Sipërmarrjen e Grave. Tiranë. Shqipëri
- Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim. 2008. Barazia Gjinore, kusht për integrimin europian. Tiranë. Shqipëri
- Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim. 2021. Analizë e Legjislacionit Shqiptar në mbështetje të fuqizimit ekonomik të grave përmes përfshirjes në nisma ekonomike private. Av. A. Kalo. Tiranë. Shqipëri
- Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim. 2021. Analizë e Legjislacionit Shqiptar në mbështetje të fuqizimit ekonomik të grave përmes përfshirjes në nisma ekonomike private. Av. A. Kalo. Tiranë. Shqipëri
- Qeveria e Shqipërisë, Vendim i Këshillit të Ministrave, 20.10.2021, “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”
- Qeveria e Shqipërisë. 2014. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020.
- Qeveria e Shqipërisë. 2021. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030. Tiranë. Shqipëri
- Qeveria e Shqipërisë. 2022. Programi i Reformës Ekonomike 2022-2024. Tiranë. Shqipëri
- R.M. Prasad. 2009. “Pengesat e Kredive: A Diskriminojnë Bankat ndaj Grave Sipërmarrëse?”, në *Akademia e Perspektivave të Menaxhimit* (2009, Vol. 23, Nr. 4, Nëntor), fq. 91–93
- Ramadani V. 2015. Gruaja Sipërmarrëse në Shqipëri: Një Studim Eksplorues

- mbi Motivimin, Problemet dhe Faktorët e Suksesit. Revista e Studimeve mbi Ballkanin dhe Lindjen e Afërt.
- Raportet e Zhvillimit Njerëzor. 2022. Të Dhënat mbi Shqipërinë – Indeksi i Zhvillimit Gjinor.
- Raportet e Zhvillimit Njerëzor. 2022. Të Dhënat mbi Shqipërinë – Indeksi i Pabarazisë Gjinore.
- Rica R. 2021. Kuadri i sipërmarrjes së grave në Shqipëri. Revista e Ekonomisë dhe Biznesit. Universiteti i Mostar
- Riinvest, 2017. Sipërmarrja e grave. Një analizë mbi të bërit biznes në Kosovë. [https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2017/November/10/Womens\\_Entrepreneurship1510307815.pdf](https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2017/November/10/Womens_Entrepreneurship1510307815.pdf)
- Rrjeti Evropian i Ekspertëve Ligjorë për Barazinë Gjinore dhe Mos-diskriminimin. 2023. Direktivat kyçe të BE për barazinë gjinore dhe mos-diskriminimin
- Sachs et al. 2022: Nga Kriza në Zhvillimin e Qëndrueshëm: OZhQ-të si Udhërrëfyes drejt 2030-ës dhe më tej. Raporti i Zhvillimit të Qëndrueshëm 2022. Cambridge: Cambridge University Press.
- Together for Life. 2020. Klima e përgjithshme e biznesit dhe ndikimi i tërmeteve të vjeshtës 2019 e pandemisë COVID-19 te gratë sipërmarrëse. Tiranë. Shqipëri.
- UNCTAD, 2014. Një sondazh mbi sipërmarrjen e grave dhe inovacionin.
- Van Stel, A., Carree, M., & Thurik, R. (2005). Ndikimi i veprimtarisë sipërmarrëse në rritjen ekonomike kombëtare. *Ekonomia e Biznesit të Vogël*, 24, 311–321.10.1007/s11187-005-1996-6
- Wong, P. K., Ho, Y. P., & Autio, E. (2005). Sipërmarrja, inovacioni dhe rritja ekonomike: Prova nga të dhënat e GEM. *Ekonomia e Biznesit të Vogël*, 24, 335–350.10.1007/s11187-005-2000-1
- Zelechowski, D. dhe Bilimoria, D. (2004). Karakteristikat e grave dhe burrave drejtorë të brendshëm të korporatave në SHBA, Qeverisja e Korporatave: Një Analizë Ndërkombëtare, 12(3): 337–42